



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

RAPORT
MBI PUNËN E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2025

- KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ky Raport në format elektronik, konsultohet duke skanuar quick response code-n e mëposhtëm



HYRJE	6
REZOLUTA E KUVENDIT ZBATIMI	7
PJESA I	12
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025	12
KREU I	12
PËRGATITJA E ZGJEDHJEVE.....	12
Kapitulli 1	12
AKTET RREGULLATORE.....	12
Kapitulli 2	17
BUXHETI	17
Kapitulli 3	20
PERSONELI.....	20
Kapitulli 4	22
LOGJISTIKA DHE INFRASTRUKTURA ZGJEDHORE	22
Kapitulli 5	34
DOKUMENTACIONI DHE MODELET	34
Kapitulli 6	37
EDUKIMI DHE INFORMIMI I ZGJEDHËSVE	37
Kapitulli 7	44
REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE.....	44
Kapitulli 8	48
KOMISIONET ZGJEDHORE	48
Kapitulli 9	55
LISTA E ZGJEDHËSVE	55
Kapitulli 10	57
FUSHATA ZGJEDHORE	57
Kapitulli 11	59
VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE.....	59

Kapitulli 12	61
VOTIMI NGA JASHTË VENDIT	61
KREU II	75
DITA E ZGJEDHJEVE	75
Kapitulli 1	75
HAPJA E VOTIMIT	75
Kapitulli 2	75
ZHVILLIMI I VOTIMIT	75
Kapitulli 3	78
MBYLLJA E VOTIMIT	78
Kreu III.....	79
NXJERRJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR	79
Kapitulli 1	79
GRUPET E NUMËRIMIT	79
Kapitulli 2	80
NUMËRIMI, VLERËSIMI I VOTAVE DHE TABULIMI I REZULTATIT	80
Kapitulli 3	82
ANKIMET ZGJEDHORE.....	82
Kapitulli 4	87
SHPLLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR	87
PJESA II.....	88
ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, 9 NËNTOR.....	88
KREU I	88
PËRGATITJA E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME	88
Kapitulli 1	88
Aktet rregullatore.....	88
Kapitulli 2	90
BUXHETI	90
Kapitulli 3	92
PERSONELI.....	91
Kapitulli 4	93
LOGJISTIKA DHE INFRASTRUKTURA ZGJEDHORE	93

Kapitulli 5	98
DOKUMENTACIONI DHE MODELET	98
Kapitulli 6	100
EDUKIMI DHE INFORMIMI I ZGJEDHËSVE	100
Kapitulli 7	102
REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE.....	102
Kapitulli 8	104
KOMISIONET ZGJEDHORE	104
Kapitulli 9	106
LISTA E ZGJEDHËSVE	106
Kapitulli 10	108
FUSHATA ZGJEDHORE	108
Kapitulli 11	110
VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE.....	110
KREU II	111
DITA E ZGJEDHJEVE	111
Kapitulli 1	111
HAPJA E VOTIMIT	111
Kapitulli 2	111
ZHVILLIMI I VOTIMIT	111
Kapitulli 3	112
MBYLLJA E VOTIMIT	112
Kreu III.....	115
NXJERRJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR	116
Kapitulli 1	116
GRUPET E NUMËRIMIT	116
Kapitulli 2	117
NUMËRIMI, VLERËSIMI I VOTAVE DHE TABELIMI I REZULTATIT	117
Kapitulli 3	118
EKSPERIMENTI ME PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE.....	118
Kapitulli 4	119
ANKIMET ZGJEDHORE.....	119

Kapitulli 5	120
SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR	120
PJESA III.....	122
REKOMANDIME	122
PJESA IV	126
ANEKSE.....	126
ANEKS 1: VOTIMI NGA JASHTË	126
1.1. PËRMBLEDHJE E AKTEVE NËNLIGJORE TË VOTIMIT NGA JASHTË.....	126
1.2 ZGJEDHËS NGA JASHTË TË REGJISTRUAR, SIPAS QARQEVE	131
1.3 ZGJEDHËS NGA JASHTË TË REGJISTRUAR, SIPAS SHTETEVE	132
1.4 FLETE VOTIMI NGA JASHTË TË PRODHUARA	134
1.5 ZARFE TË DËRGUAR NGA KQZ DREJT ZGJEDHËSVE NGA JASHTË, SIPAS QARQEVE ...	135
1.6 ZARFE TË MBËRRITURA NË KQZ NGA ZGJEDHËSIT NGA JASHTË, SIPAS QARQEVE	136
ANEKS 2: PARTI POLITIKE TË REGJISTRUARA NË ZGJEDHJET PËR KUVEND	137
ANEKS 3: KOALICIONET QË JANË REGJISTRUAR NË ZGJEDHJET PËR KUVEND	149
ANEKS 4: REZULTATI PËRFUNDIMTAR I ZGJEDHJEVE NË RANG VENDI.....	140
ANEKS 5: LISTA E KANDIDATËVE FITUES NË ZGJEDHJET PËR KUVEND	141
ANEKS 6: LISTA E AKTEVE TË MIRATUARA PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND.....	151
ANEKS 7: LISTA E AKTEVE TË MIRATUARA PËR ZGJEDHJET E PJESSHME	155
ANEKS 8: RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2025	157

HYRJE

Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025 dhe zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025 u administruan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në përputhje me kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi, duke u mbështetur në parimet e ligjshmërisë, transparencës, barazisë së subjekteve zgjedhore dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Në ushtrim të kompetencave të tij, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmori një sërë masash organizative, procedurale dhe teknike, të cilat synuan sigurimin e një procesi zgjedhor të rregullt, funksional dhe të besueshëm në të gjitha fazat e tij. Këto masa përfshinë planifikimin dhe përgatitjen paraprake të procesit, administrimin e ditës së votimit, si dhe menaxhimin e elementeve paszgjedhore, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe strukturat përgjegjëse.

Raporti pasqyron në mënyrë analitike veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me organizimin dhe zhvillimin e dy proceseve zgjedhore të sipër përmendura, duke trajtuar çështje që lidhen me përgatitjen institucionale dhe teknike, përdorimin e teknologjisë në procesin zgjedhor, rekrutimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, organizimin logjistik, mbështetjen teknike dhe monitorimin e procesit zgjedhor.

Në fokus të veçantë të raportit është përshkrimi i masave të ndërmarra për garantimin e korrektësisë së procesit të votimit dhe numërimit të votave, përfshirë përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve elektronike, si dhe zbatimin e mekanizmave të kontrollit dhe transparencës. Raporti trajton gjithashtu mënyrën e adresimit të problematikave të evidentuara gjatë procesit, duke reflektuar qasjen institucionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në menaxhimin e situatave operative dhe teknike.

Ky dokument synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme dhe të konsoliduar të administrimit të zgjedhjeve gjatë vitit 2025, duke shërbyer njëkohësisht si instrument informues për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe si bazë për vlerësimin e mëtejshëm të proceseve zgjedhore dhe për identifikimin e nevojave për përmirësime në të ardhmen.

REZOLUTA E KUVENDIT | ZBATIMI

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është njohur me rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të formuluar me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë institucionale dhe të administrimit të proceseve zgjedhore.

Në përgjigje të shkresës së Kuvendit me nr. 3980 prot., datë 11.12.2025, KQZ ka përcjellë qëndrimin zyrtar lidhur me rekomandimet e përfshira në rezolutë. Në këtë kuadër, është sqaruar se rekomandimi për hartimin e Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) konsiderohet i përmbushur, pasi KQZ zbaton aktualisht Planin Strategjik 2022–2026, i cili adreson në mënyrë të integruar zhvillimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemeve digjitale të institucionit.

KQZ i ka bërë me dije Kuvendit se, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, po kryhet vlerësimi i nivelit të realizimit të këtij plani strategjik si dhe do të hartohet brenda qershorit 2026 plani vijues strategjik. Për rekomandimet e tjera të Kuvendit shpjegimet dhe të dhënat gjenden më poshtë:

Përmirësimi i zbatimit të Programit të Transparencës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e konsideron transparencën institucionale si një prioritet thelbësor të veprimtarisë së tij dhe ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që aktiviteti i institucionit të jetë publik, i aksesueshëm dhe i verifikueshëm nga media, publiku dhe të gjithë subjektet e interesuara.

Programi i Transparencës zbatohet dhe përditësohet në mënyrë dinamike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat më të mira të qeverisjes së hapur. Në zbatim të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, KQZ publikon dhe ofron në mënyrë të vazhdueshme informacione mbi veprimtarinë e saj.

Në këtë kuadër, faqja zyrtare e internetit e KQZ-së është konceptuar si një platformë gjithëpërfshirëse transparence dhe përmban, ndër të tjera, informacione mbi:

- vendimmarrjen e organeve të KQZ-së;
- raportet e institucionit dhe raportet e institucioneve të tjera që lidhen me KQZ-në;
- raportet e vëzhguesve të zgjedhjeve;
- raportet financiare dhe të auditimit të partive politike;
- raportet e mbikëqyrjes financiare mbi buxhetin e KQZ-së;
- listat e kontratave, parashikimet dhe realizimet buxhetore, programet buxhetore afatmesme dhe afatgjata, si dhe procedurat e prokurimit;
- të dhëna mbi kandidatët për deputetë, këshilltarë bashkiakë dhe kryetarë bashkie;
- partitë politike dhe subjektet zgjedhore;

- rezultatet e zgjedhjeve, nga niveli kombëtar deri në nivelin e qendrës së votimit;
- rezultatet e verifikimeve pazgjedhore;
- formularët e vetëdeklarimit;
- dokumentacionin dhe modelet e dokumentacionit zgjedhor;
- raportimet e institucioneve publike gjatë periudhës zgjedhore;
- njoftimet për rekrutime dhe vende të lira pune;
- denoncimet dhe ankimet administrative.

Gjatë vitit 2025, KQZ ka vënë në dispozicion në faqen e saj zyrtare të internetit (kqz.gov.al) edhe shërbimin “Protokolli Online”, i cili mundëson konsultimin elektronik të dokumenteve hyrëse dhe dalëse në dhe nga KQZ, të regjistruara në Librin e Korrespondencës (Protokollin).

Aktualisht, KQZ po punon për përmirësimin e formatit dhe strukturës së disa të dhënave dhe informacioneve të publikuara në faqen elektronike, në zbatim të Ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Faqja zyrtare e internetit të KQZ, është gjithashtu e disponueshme dhe e lexueshme edhe për personat me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit.

Rishikimi i strukturës dhe përmbajtjes së raportit vjetor të KQZ-së

KQZ ka marrë në konsideratë rekomandimin e Kuvendit për rishikimin e strukturës dhe përmbajtjes së raportit vjetor, në përputhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik të Kuvendit. Ky proces reflektohet në raportimin aktual dhe do të jetë i tillë edhe në raportimet pasuese institucionale, me qëllim rritjen e qartësisë, përmirësimin e analizës përmbajtësore dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e monitorimit parlamentar.

Raportimi i detajuar mbi zgjedhjet e datës 11 maj 2025

Në përmbushje të këtij rekomandimi, raportimi për vitin 2025 përfshin një pasqyrë të zgjeruar dhe të strukturuar mbi organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, konkretisht Kreu II i këtij Raporti, duke reflektuar në mënyrë analitike administrimin e procesit zgjedhor në të gjitha fazat e tij.

Funksionalizimi i mekanizmit të auditimit të financave

KQZ administron një regjistër të auditimit të raporteve financiare, i cili përmban të dhëna mbi:

- *identifikimin e partive politike dhe subjekteve zgjedhore;*
- *datat e kryerjes së auditimeve;*
- *gjetjet e konstatuara gjatë auditimeve të fushatës zgjedhore dhe të vitit kalendarik;*
- *rekomandimet dhe masat korrigjuese të adresuara subjekteve zgjedhore dhe partive politike*

Ky regjistër përditësohet periodikisht në bazë të të dhënave të përfituara nga raportet e auditimit. SMFM planifikon përzgjedhjen e audituesve nëpërmjet shortit, si për auditimin e raporteve financiare të partive politike për vitin kalendarik, ashtu edhe për auditimin e raporteve financiare të subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore, me qëllim garantimin e transparencës, paanshmërisë dhe integritetit të proceseve të auditimit.

Qartësimi i veprimtarive publike gjatë fushatës zgjedhore

Në zbatim të këtij rekomandimi, KQZ ka vlerësuar nevojën për qartësimin e kategorive të veprimtarive publike gjatë fushatës zgjedhore përmes akteve nënligjore, me qëllim përcaktimin e qartë të veprimtarive të ndaluara dhe atyre që përjashtohen nga kufizimet ligjore. Në këtë kuadër, janë analizuar praktikat e zbatuara në proceset zgjedhore të mëparshme, si dhe kuadri rregullator ekzistues dhe ka nisur puna për evidentimin e nevojave për ndërhyrje rregullatore të cilat do t'i propozohen gjatë vitit 2026 Komisionit Rregullator, në funksion të rritjes së sigurisë juridike, garantimit të barazisë së subjekteve zgjedhore dhe parandalimit të shkeljeve gjatë fushatës zgjedhore.

Garantimi i aksesit të pavarur për personat me aftësi të kufizuara (PAK)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ndërmarrë masa për verifikimin e kushteve të aksesit në qendrat e votimit, përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi infrastrukturë ekzistuese, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësime dhe garantimin e ushtrimit të pavarur të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara. Takime të koordinuara me bashki të ndryshme në vend do të zhvillohen gjatë vitit 2026 me qëllim që këto nevoja të plotësohen në zgjedhjet e radhës.

Zgjerimi i programeve edukuese dhe trajnimeve

Programi për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve ka luajtur një rol kyç në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025. Ky program synoi ofrimin e informacionit të plotë mbi të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe forcimin e besimit të qytetarëve në rëndësinë dhe vlerën e votës si element themelor i demokracisë.

Në këtë kuadër, KQZ miratoi tre programe të veçanta, të cilat adresuan në mënyrë të targetuar të gjitha grupet e synuara:

- Vendimi nr. 207, datë 11.12.2024, “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”;

- Vendimi nr. 208, datë 11.12.2024, “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të pakicave kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”;
- Vendimi nr. 206, datë 11.12.2024, “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025”.

Gjithashtu, për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Berat, Cërrik, Mat, Tepelenë dhe Vlorë, të zhvilluara më datë 9 nëntor 2025, u miratua një program i posaçëm:

- Vendimi nr. 1402, datë 09.10.2025, “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”.

PJESA I

ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

KREU I

PËRGATITJA E ZGJEDHJEVE

Kapitulli 1

AKTET RREGULLATORE

Në ushtrim të kompetencave të parashikuara nga legjislacioni zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme procesin e hartimit, përditësimit dhe koordinimit të akteve nënligjore, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse iniciuese dhe duke garantuar vlerësim të gjithanshëm ligjor për çdo projekt akt përpara shqyrtimit dhe miratimit nga organet kompetente: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Rregullator.

Në funksion të respektimit të parimeve të transparencës dhe përfshirjes, procesi i përgatitjes së akteve nënligjore është shoqëruar me konsultime publike, përfshirë përfaqësues të partive politike, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë institucionalë. Të gjitha sugjerimet dhe propozimet e paraqitura gjatë kësaj faze janë administruar, analizuar dhe vlerësuar ligjërisht, duke u reflektuar në përmbajtjen përfundimtare të projekt akteve dhe relacionet shpjeguese shoqëruese.

Shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore është zhvilluar në seanca publike, të transmetuara në kohë reale nëpërmjet platformës elektronike të KQZ, ku përfaqësuesit e grupeve të interesit kanë pasur mundësinë të shprehin qëndrimet dhe komentet e tyre. Të gjitha aktet e miratuara janë publikuar brenda afatit ligjor prej 24 orësh në faqen zyrtare të internetit të institucionit, duke garantuar transparencë institucionale dhe qasje të barabartë të publikut.

Statistikat e Veprimtarisë Normative

Gjatë periudhës përgatitore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, janë miratuar gjithësej **1 173 akte** nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të cilat **13 vendime** janë nënshkruar bashkërisht me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Komisioni Rregullator ka shqyrtuar **34 projekt vendime**, prej të cilave **28 janë miratuar**, duke kontribuar në konsolidimin e kuadrit rregullator zgjedhor.

Çështjet kryesore të mbuluara nga aktet e miratuara nga Komisioneri përfshijnë:

- Miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore;
- Organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve dhe KQV-ve;

- Rregullat për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe miratimin e modeleve përkatëse;
- Caktimin e kohës së transmetimit të fushatës në RTSH për partitë politike;
- Trajtimin e raportimeve për veprimtari publike dhe denoncime;
- Kriteret teknike për ngritjen e QV-ve për persona me aftësi të kufizuar;
- Programin e trajnimit të administratës zgjedhore;
- Modelet e dokumenteve për numërimin dhe nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve;
- Udhëzuesin e punës për të gjitha proceset zgjedhore;
- Caktimin e njësive administrative për selitë e KZAZ-ve;
- Përcaktimin e partive që propozojnë anëtarë në KZAZ dhe në grupet e numërimit;
- Emërimin e anëtarëve dhe drejtuesve të KZAZ-ve dhe shpërblimet përkatëse;
- Rregullat për emërimin dhe shpërblimin e auditëve teknikienë;
- Regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe listave shumëmemërore;
- Shqyrtimin e raporteve të AMA-s;
- Shpërndarjen e fondeve publike për partitë politike;
- Specifikimet teknike dhe renditja në fletët e votimit;
- Formatet dhe specifikimet e vulave zyrtare për KZAZ/KQV;
- Programet e edukimit, ndërgjegjësimit dhe përfshirjes së grupeve në nevojë;
- Numrin e monitoruesve dhe akreditimin e tyre;
- Tabelat përmbledhëse të rezultateve dhe shpërndarjen e mandateve;
- Auditimin e fondeve zgjedhore dhe kompensimin financiar paszgjedhor;
- Shpërblimet për suportet teknikë dhe operatorët e PEI/PEVN.

Vendimet e përbashkëta me Nënkomisionerin kanë trajtuar:

- Emërimin e auditëve teknikienë dhe ndihmësve për listat zgjedhore dhe diasporën;
- Përcaktimin e shpërblimeve për operatorët teknikë dhe helpdesk në përdorimin e PEI;
- Ngritjen e modulit të integritetit të listës zgjedhore për identifikimin elektronik;
- Verifikimin e të dhënave daktiloskopike të mbledhura përmes pajisjeve PEI për zgjedhjet e 11 majit 2025.

Në tërësi, kjo veprimtari intensive ka shërbyer për të garantuar një bazë të plotë ligjore, të unifikuar dhe të zbatueshme në të gjitha hallkat e administrimit zgjedhor, në përputhje me standardet kushtetuese, ligjin zgjedhor dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Monitorimi i fushatës dhe përdorimit të burimeve publike

Një nga komponentët thelbësorë të administrimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025 ishte monitorimi i fushatës zgjedhore dhe përdorimi i burimeve publike nga subjektet zgjedhore dhe institucionet shtetërore. Në zbatim të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për detyrë të sigurojë zhvillimin e fushatës zgjedhore mbi baza të barabarta, duke garantuar respektimin e parimeve të konkurrencës së ndershme, transparencës dhe ndalimit të përdorimit apo abuzimit me asetet shtetërore në funksion të fushatës.

Në këtë kuadër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmori një sërë masash institucionale për monitorimin dhe mbikëqyrjen e fushatës zgjedhore, të cilat përfshinë, ndër të tjera:

- përcaktimin e rregullave dhe kufizimeve për përdorimin e fondeve publike, objekteve shtetërore dhe burimeve njerëzore të administratës publike gjatë periudhës zgjedhore;
- kërkesën për raportim periodik nga institucionet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi aktivitetet e tyre, me qëllim parandalimin e çdo rasti të mundshëm të përdorimit të burimeve publike në favor të subjekteve zgjedhore;
- monitorimin në terren nga strukturat përgjegjëse të KQZ-së, për evidentimin dhe dokumentimin e rasteve të dyshuara të shfrytëzimit të burimeve shtetërore në mbështetje të subjekteve politike;
- mekanizmin e ankesave, i cili u mundësoi subjekteve zgjedhore, kandidatëve të pavarur dhe qytetarëve të paraqesin denoncime për shkelje të mundshme të parimit të barazisë në garë.

Paralelisht me këto masa, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvilloi veprimtari informuese dhe ndërgjegjësuere publike, me qëllim informimin e aktorëve politikë dhe të opinionit publik mbi detyrimin ligjor për ndarjen e qartë të funksioneve shtetërore nga aktivitetet elektorale. Përmes deklaratave publike dhe publikimit të raporteve ndërmjetëse, KQZ synoi të rrisë transparencën e procesit dhe të forcojë besimin e publikut në administrimin e zgjedhjeve.

Ndërfaqja Elektronike e Raportimit për Institucionet Publike

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së grantit me Këshillin e Evropës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) zhvilloi dhe vuri në funksion Ndërfaqen Elektronike të Raportimit për Institucionet Publike, një platformë digjitale raportimi në kohë reale, e konceptuar për të mbështetur institucionet publike në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore për raportimin

paraparak të veprimtarive publike, si dhe për të mundësuar KQZ-në të ndjekë, verifikojë dhe finalizojë këtë proces në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi kryesor i grantit ka qenë forcimi i instrumenteve dhe mekanizmave mbikëqyrës të KQZ-së për monitorimin efektiv të veprimtarive publike të institucioneve shtetërore, përmes krijimit të një platforme online që mundëson raportimin në kohë reale të këtyre veprimtarive. Krijimi dhe funksionalizimi i kësaj platforme ka mundësuar publikimin e menjëhershëm të informacionit në faqen zyrtare të KQZ-së, ndjekjen dhe kontrollin administrativ të kërkesave për miratim, si dhe grumbullimin e të dhënave për qëllime monitorimi dhe analize. Ndërfaqja Elektronike e Raportimit (NRI) është zhvilluar në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025 dhe është në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10019, datë 28.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nga vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Rregullat për raportimin e veprimtarive publike të institucioneve, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e aktiviteteve të ndaluara, si dhe monitorimi i sjelljes në aktivitete dhe përdorimi i burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Platforma u bë operacionale më datë 11 janar 2025 dhe është e aksesueshme në adresën zyrtare: <https://aktivitete.kqz.gov.al/#/activities/home>. Për periudhën nga data 11 janar deri më 11 maj 2025, të gjitha institucionet publike, përfshirë edhe entitetet nën kontrollin e shtetit, kanë qenë të detyruara ligjërisht të raportojnë paraprakisht pranë KQZ-së veprimtaritë e tyre publike. Ky detyrim ka për qëllim garantimin e paanshmërisë në përdorimin e burimeve publike dhe mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor. KQZ, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ka ushtruar mbikëqyrjen, shqyrtimin dhe, kur është konstatuar shkelje, ndalimin e veprimtarive të raportuara. Të dhënat mbi veprimtaritë e ndaluara publikohen në kohë reale në faqen zyrtare të internetit të KQZ, në linkun:

<https://aktivitete.kqz.gov.al/#/activities/reports>

Gjatë periudhës së raportimit, KQZ ka arritur këto rezultate kryesore:

- Ka lançuar platformën brenda afateve ligjore;
- Raportimin e menjëhershëm të veprimtarive nga institucionet publike, me 336 raporte të kryera brenda javës së parë të operimit;
- Automatizimin e procesit të verifikimit të përputhshmërisë nga ana e KQZ-së, duke reduktuar gabimet manuale dhe duke përmirësuar mbikëqyrjen rregullatore;
- Rritjen e aksesit në të dhëna të hapura për institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe publikun e gjerë;
- Krijimin e një baze të strukturuar të dhënash për veprimtaritë e raportuara dhe të ndaluara, duke mundësuar analiza të avancuara dhe rritje të llogaridhënies,

Për njohjen dhe përdorimin e platformës NRI, KQZ ndërmoi një sërë veprimtarish informuese dhe ndërgjegjësuese, me qëllim kuptimin e funksionaliteteve të saj nga përdoruesit dhe palët e interesuara. Këto veprimtari përfshinë, ndër të tjera, zhvillimin e fushatave informuese dhe edukative, organizimin e trajnimeve për përdoruesit e NRI-së, ofrimin e mbështetjes teknike përmes kanaleve të dedikuara (helpdesk telefonik dhe elektronik), si dhe hartimin dhe shpërndarjen e udhëzuesve dhe materialeve informuese. KQZ organizoi një trajnim online dy-ditor me temën “Raportimi nga Institucionet Publike në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit për Institucionet (NRI) dhe Veprimtaritë Publike të Ndaluara”, me qëllim sqarimin e procedurave të raportimit dhe trajtimin e problematikave të hasura në zbatimin praktik të vendimit nr. 9/2020, të ndryshuar, të Komisionit Rregullator. Në trajnim morën pjesë mbi 100 përfaqësues të institucioneve publike, të cilët patën mundësi të adresojnë drejtpërdrejt çështjet dhe paqartësitë pranë stafit të KQZ.

Në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, KQZ organizoi trajnime tre-ditore për përfaqësues të institucioneve publike në 8 qarqe të vendit: Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër dhe Vlorë. Këto trajnime kishin për qëllim njohjen e pjesëmarrësve me dispozitat e Kodit Zgjedhor, aktet nënligjore të KQZ dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre, mbi raportimin e veprimtarive publike në periudhën katërmujore para ditës së zgjedhjeve.

Në lidhje me raportimet e kryera në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit për Institucionet, për periudhën 11 janar – 11 maj 2025, konstatohet se:

- 305 institucione publike janë regjistruar në platformë, nga të cilat 180 institucione kanë kryer raportime aktive;
- Janë realizuar gjithsej 4 650 raportime të veprimtarive publike;
- Numri më i lartë i raportimeve është regjistruar nga Kryeministria (203 raportime), Bashkia Roskovec (309 raportime) dhe Bashkia Maliq (196 raportime);
- 163 veprimtari janë ndaluar, për të cilat është nisur dhe shqyrtuar hetimi administrativ, me vendimmarrje për pushimin e tij.

Gjatë periudhës së raportimit janë evidentuar edhe disa praktika të mira, ndër të cilat përmirësimi i respektimit të afateve ligjore për raportim përmes funksionaliteteve online, rritja e cilësisë së analizës përmes përdorimit të të dhënave të automatizuara, si dhe rritja e përgjithshme e transparencës së procesit.

Kapitulli 2

BUXHETI

Procesi i planifikimit, miratimit dhe administrimit të buxhetit për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025, të caktuara me Dekretin nr. 399, datë 05.12.2024, është realizuar në përputhje me ligjin e buxhetit për vitin 2025, si dhe udhëzimet dhe aktet nënligjore përkatëse të Ministrisë së Financave.

Administrimi i fondeve është kryer duke respektuar parimet e ligjshmërisë, eficiencës, transparencës dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike, në funksion të garantimit të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi buxhetor

Në fazën përgatitore u zhvillua një vlerësim i plotë dhe i detajuar i nevojave financiare, bazuar në analizën e kërkesave funksionale, operative dhe teknike të procesit zgjedhor. Ky vlerësim shërbeu për hartimin e preventivit financiar dhe për përditësimin e tavaneve buxhetore, në përputhje me nevojat reale të administrimit zgjedhor.

Kërkesat buxhetore dhe preventivi total, në vlerën 3,561,212,000 (tre miliardë pesëqind e gjashtedhjetë e një milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekë, iu paraqitën titullarit të institucionit dhe u miratuan sipas procedurave ligjore në fuqi.

Struktura e buxhetit

Buxheti i miratuar për zgjedhjet e vitit 2025 u shpërnda sipas zërave kryesorë si më poshtë:

- paga dhe sigurime për punonjësit mbështetës;
- mallra dhe shërbime;
- investime.

Ekzekutimi i buxhetit

Gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor, u kryen shpenzime dhe transferime financiare për njësitë e qeverisjes vendore, kryesisht për transportin e materialeve zgjedhore, qiranë e ambienteve, shpërblimin e komisionerëve dhe shpenzime të tjera operationale të domosdoshme për funksionimin e strukturave zgjedhore.

Ekzekutimi i buxhetit është realizuar në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, në përputhje me ecurinë e procesit zgjedhor dhe afatet ligjore.

Analiza e realizimit financiar

Realizimi financiar total i buxhetit për vitin 2025 rezulton në nivelin 83%. Investimet janë realizuar në nivelin 95%, pagat dhe sigurimet për punonjësit mbështetës në 94%, ndërsa mallrat dhe shërbimet në 82%.

Plani i rishikuar vjetor programi i zgjedhjeve = 3,561,212,000 lekë

Realizimi buxhetor për 12 M 2025 = 2,964,898,560 lekë

Realizimi buxhetor në % = 83%

Nga të cilat planifikuar dhe realizuar në % ndaj fondeve të planifikuara sipas natyrës së shpenzimeve:

- Shpenzime korrente planifikuar 3,387,212,000 lekë dhe realizuar në masën 83 % ose 2,799,055,760 lekë
- Shpenzime kapitale me financim të brendshëm planifikuar në shumën 162,100,000 lekë dhe realizuar në masën 95 % ose 153,942,800 lekë.
- Shpenzime kapitale me financim të huaj planifikuar dhe realizuar në shumën 11,900,000 lekë dhe realizuar në masën 100 %

Shpenzime mallra dhe shërbime 602 për vitin 2025:

Aktiviteti i i KQZ-së për realizimin dhe administrimin e gjithë procesit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, si dhe të zgjedhjeve të pjesshme për 5 Bashki të datës 9 Nëntor, është mbështetur nga buxheti i shtetit në llogarinë e shpenzimeve për mallra e shërbimeve ku plani i rishikuar për këtë zë është në shumën 3,087,212,000 lekë ose 90% e buxhetit të KQZ-së 2025, dhe 95% të fondeve buxhetore të programit 01620.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri përpjekjet maksimale për të siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Këto zgjedhje jetësuan për herë të parë në këto 35 vite demokraci, votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe banojnë jashtë vendit tonë, direkt nga vëndet ju jetojnë, proces i njohur ndryshe si vota e diasporës.

Ky proces u përmbush nëpërmjet shërbimit postar i cili zuri 36% të fondeve të planifikuara në zërin 602 – mallra e shërbime të këtij programi.

Për zërin “Shërbimi Postar për zgjedhësit nga jashtë vendit”:

Buxheti i planifikuar: 1,210,000,000 lekë

Vlera e kontratës së lidhur: 912,679,991 lekë

Realizimi faktik për vitin 2025: 699,516,320 lekë

a) Diferenca midis planifikimit dhe kontraktimit

Diferenca:

$$1,210,000,000 - 912,679,991 = 297,320,009 \text{ lekë}$$

Diferenca prej 297,320,009 lekë ndërmjet planifikimit dhe kontraktimit tregon një kursim buxhetor të krijuar si rezultat i procedurës së prokurimit dhe ofertës më të ulët se fondi limit.

b) Diferenca midis kontratës dhe realizimit faktik

$$912,679,991 - 699,516,320 = 213,163,671 \text{ lekë}$$

Ndërkohë, diferenca prej 213,163,671 lekë ndërmjet kontratës dhe realizimit faktik lidhet me realizimin jo të plotë të volumit të parashikuar të shërbimit postar gjatë vitit 2025, duke qenë se pagesat janë kryer mbi bazën e shërbimit realisht të ofruar.

Si rrjedhojë, fondet e papërdorura në total ndaj planifikimit fillestar rezultojnë në shumën 510,483,680 lekë, situatë e cila ka ardhur si pasojë e kombinimit të kursimit nga prokurimi dhe realizimit më të ulët të volumit faktik të shërbimit krahasuar me parashikimet fillestare.

Kapitulli 3

PERSONELI

Angazhimi i stafit me kohë jo të plotë

Për të garantuar administrimin e rregullt të procesit zgjedhor, u angazhua staf me kohë jo të plotë pune. Ky staf ofroi mbështetje teknike dhe administrative për njësitë përkatëse, duke lehtësuar përballimin e ngarkesës së shtuar dhe duke siguruar mbarëvajtjen e detyrave institucionale.

Struktura organike e administratës me kohë jo të plotë pune u përgatit pas një procesi konsultativ me të gjitha drejtoritë e institucionit.

- Me vendimin nr. 103/2024 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për realizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e vitit 2025”, u miratua punësimi i 395 punonjësve me afate punësimi nga 1 deri në 6 muaj.
- Me vendimin nr. 23/2025 të Kuvendit të Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe strukturës së pagave të punonjësve me kohë jo të plotë pune, në mbështetje të procesit të votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet e vitit 2025”, u miratua punësimi i 80 punonjësve me afat punësimi 3 muaj.

Shpallja e vendeve të lira të punës (Moduli i Punësimit)

Për herë të parë, ky proces u krye përmes modulit të punësimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën zyrtare: <https://punesimi.kqz.gov.al>

Vendet e lira të punës u publikun në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të institucionit. Në njoftimet përkatëse ishin të përcaktuara qartë:

- pozicionet e punës;
- afati kohor i punësimit;
- kategoria e pagës;
- kriteret e punësimit;
- detyrat kryesore për çdo pozicion.

Aplikimi u mundësua përmes modulit të punësimit të KQZ-së, si edhe pranë zyrës së protokollit të institucionit.

Numri total i aplikimeve të regjistruara në portalin e punësimit ishte 14,404 aplikime, nga të cilat 8,206 aplikime ishin të përfunduara, të ndara si më poshtë:

- 261 aplikime për kontrata shërbimi;
- 1,039 aplikime për kontrata me afat të caktuar;
- 6,906 aplikime për operatorë teknikë.

Referuar të dhënave statistikore të portalit të punësimit, nëpërmjet këtij procesi janë rekrutuar gjithsej:

- 5,312 operatorë PEI/PEVN;
- 225 operatorë rezervë;
- 504 punonjës me kohë jo të plotë pune.

Trajnimi i punonjësve me kohë jo të plotë pune

- Trajnimi i punonjësve me kohë jo të plotë pune u konsiderua si faza përfundimtare dhe një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të rekrutimit. Trajnimi u zhvillua në dy komponentë: trajnim i përgjithshëm, i realizuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore; trajnim specifik, i realizuar nga drejtoritë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë.

Metodologjia e ndjekur ishte interaktive, në grupe të vogla prej rreth 25 punonjësish. Në total, u zhvilluan 7 (shtatë) sesione trajnimi. Materialet trajnuese iu shpërndanë paraprakisht punonjësve përmes postës elektronike.

Sesione trajnimi u zhvilluan sipas këtij kalendari:

- 23.01.2025 – Drejtoria për Votimin nga Jashtë (30 punonjës);
- 05.02.2025 – Drejtoria e Ligjshmërisë (21 punonjës);
- 06.02.2025 – Sektori i Administrimit të të Dhënave Digjitale (20 punonjës);
- 07.02.2025 – Sektori i Zhvillimeve Digjitale (31 punonjës);
- 07.02.2025 – Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit (10 punonjës);
- 23.01.2025 – Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (30 punonjës);
- 05.02.2025 – Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit (21 punonjës);
- 07.02.2025 – Sektori i Materialeve Zgjedhore (10 punonjës).

Programi i trajnimit përfshiu, ndër të tjera:

- njohjen me bazën ligjore që rregullon veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- prezantimin e strukturës organizative dhe organeve drejtuese të KQZ-së;
- njohjen me detyrat konkrete të sektorit apo drejtorisë ku punonjësit ishin angazhuar;
- etikën dhe disiplinën në punë.

Kapitulli 4

LOGJISTIKA DHE INFRASTRUKTURA ZGJEDHORE

Logjistika

Materialet dhe dokumentacioni bazë për organizimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor përgatiten në përputhje të plotë me përcaktimet e Kodit Zgjedhore dhe aktet nënligjore përkatëse. Baza materiale zgjedhore përfshin të gjithë elementët logjistikë dhe dokumentarë të nevojshëm për funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Qendrave të Votimit (QV), si dhe strukturave të tjera të administratës zgjedhore.

Për garantimin e një procesi të organizuar dhe të kontrolluar në çdo fazë, u hartua një plan i detajuar shpërndarjeje, i cili përfshinte fazat, etapat, afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale përkatëse. Faza I – Ngritja dhe Pajisja e KZAZ-ve

Faza e parë lidhet me ngritjen dhe funksionalizimin e 93 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) në të gjithë territorin e vendit. Në këtë kuadër u përgatit dhe u shpërnda baza materiale e nevojshme për konstituimin dhe fillimin e veprimtarisë së tyre.

Etapa 1: Përgatitja e bazës materiale për KZAZ-të

- U realizua përgatitja e plotë e dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore për ngritjen dhe funksionimin e KZAZ-ve;
- Çdo KZAZ u pajis me dokumentacionin administrativ, formularët tip, regjistrat, procesverbalet dhe materialet ndihmëse të domosdoshme për ushtrimin e detyrave ligjore. U siguroa inventarizimi dhe regjistrimi i çdo materiali të shpërndarë, në mënyrë që të garantohej gjurmueshmëria dhe kontrolli i plotë logjistik.

–

Nr.	Qarku	ZAZ	Nr. QV -ve
1	Berat	64-69	275
2	Diber	16-19	222
3	Durres	20-26	493
4	Elbasan	45-54	508
5	Fier	55-63	587
6	Korce	70-76	422
7	Gjirokaster	77-83	198
8	Kukes	9-11	139
9	Lezhe	12-15	245
10	Shkoder	1-8	405
11	Tirane	27-44	1282
12	Vlore	84-93	449
	TOTAL	93 ZAZ	5225 QV

Faza II – Dërgimi paraprak i materialeve për procesin zgjedhor

Faza e dytë lidhet me dërgimin paraprak dhe të organizuar të materialeve zgjedhore në KZAZ, të cilat shërbejnë për procesin zgjedhor dhe për administrimin e procesit të numërimit. Kjo fazë synon sigurimin në kohë të të gjithë infrastrukturës logjistike të nevojshme, në mënyrë që procesi zgjedhor dhe ai i numërimit të zhvillohet pa vonesa dhe në përputhje me standardet ligjore dhe procedurale.

Etapa 2: Furnizimi i KZAZ-ve me materiale paraprake

Në këtë fazë u realizua:

- Dërgimi i materialeve logjistike drejt VNV-ve;
- Pajisja me dhoma të fshehta për procesin zgjedhor;
- Dërgimi i elementëve ndarës, dhe komponentëve të tjerë ndihmës;
- Sigurimi i dokumentacionit shoqërues për administrimin korrekt të procesit të numërimit.

Kjo etapë është thelbësore për garantimin e transparencës, standardizimit dhe sigurisë së procesit të numërimit të votave.

Faza III – Shpërndarja në KZAZ e materialeve për votim.

Faza e tretë lidhet me shpërndarjen përfundimtare të materialeve zgjedhore në KZAZ, të cilat më pas i administruan dhe i dorëzuan ato në Qendrat e Votimit (QV) sipas planit të miratuar të shpërndarjes. Kjo fazë përfaqëson hallkën më kritike të zinxhirit logjistik, pasi garanton që çdo QV të pajiset në kohë, në mënyrë të plotë dhe të sigurt me të gjitha materialet e nevojshme për zhvillimin e procesit të votimit.

Etapa 3: Pajisja e Qendrave të Votimit

Kjo fazë përfshiu:

- Shpërndarjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore sipas QV-ve;
- Fletët e votimit sipas çdo qendre votimi;
- Pajisjet e Identifikimit Elektronik (PEI);
- Vulat me kode sigurie dhe elementët e tjerë të sigurisë;
- Materialet ndihmëse zgjedhore dhe dokumentacionin përkatës.

Ky proces u realizua në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Policinë e Shtetit, për të garantuar transport të sigurt, ruajtje të kontrolluar dhe shpërndarje brenda afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor

KQZ në bazë të afateve kohore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, realizoi me sukses shpërndarjen e materialeve zgjedhore dhe fletët e votimit në 93 Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Për personat me aftësi të kufizuar u morën masa për pajisjen e qendrave të votimit me dhomat e fshehtësisë si dhe me shabllonët (fletë votimi) për votuesit e verbër, për të gjitha QV-të. Përdorimi i modulit të Materialeve Zgjedhore për menaxhimin e materialeve

Në këto zgjedhje, sistemi i Materialeve Zgjedhore u implementua për herë të parë në shkallë kombëtare, duke mundësuar gjurmimin dhe monitorimin në kohë reale të materialeve zgjedhore dhe procesverbaleve, si nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ashtu edhe nga strukturat e administratës zgjedhore në nivel ZAZ dhe QV.

Për të garantuar përdorimin e saktë dhe efikas të aplikacionit, u hartua një kurrikulë e posaçme trajnimi për personelin part-time, si dhe u zhvilluan sesione trajnimi të dedikuara me sekretarët e KZAZ-ve, me fokus në funksionalitetet, procedurat e regjistrimit dhe procesin e raportimit në sistem.

Procesi i përgatitjes së materialeve zgjedhore në magazinat e KQZ-së u krye përmes një procesi të digjitalizuar, i cili përfshinte hapat kryesorë:

- Përgatitjen e etiketave të kutive të votimit, materialeve zgjedhore dhe ambalazhit përkatës;
- Ndarjen dhe regjistrimin e vulave dhe kodeve të sigurisë në sistem për çdo KZAZ;
- Skanimin e fletëve të votimit dhe vendosjen e tyre në kutitë përkatëse të qendrave të votimit.

Në përputhje me udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çdo kuti të qendrës së votimit u vendos një listë e plotë e materialeve logjistike, e cila shërbeu si:

- Udhëzues për anëtarët e administratës zgjedhore;
- Mjet kontrolli për të siguruar pajisjen e plotë të kutive me materialet e nevojshme.

Kjo praktikë thjeshtësoi punën në terren dhe kontribuoi në një menaxhim më të sigurt, më të saktë dhe më efikas të bazës materiale për procesin zgjedhor

Përdorimi i modulit Materialeve Zgjedhore lehtësoi procesin e shpërndarjes dhe të kthimit të bazës materiale. Nga ana e KZAZ-ve, aplikacioni është përdorur për:

- Skanimin e kutive të ambalazhit në 4861 QV;
- Skanimin e vulave/kodeve të sigurimit drejt KQV-ve për 5225 QV.

Pas kthimit të materialeve në magazinat e KQZ:

- Skanimi i kutive të votimit u krye për 4666 QV;

Logjistika për periudhën pas zgjedhore- Rinumërimi

Në periudhën mbas mbylljes së procesit të votimit nga ana e KZAZ-ve janë dorëzuar 15 639 kuti votimi dhe kuti materialesh zgjedhore.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.102, datë 07.07.2025 vendosi rinumërimin kutive të votimit, kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit nga jashtë për qarqet si më poshtë:

- Në Qarkun Tiranë u krye rinumërimi i plotë i kutive te votimit.
- Në Qarkun Fier u realizua rinumërimi i plotë i kutive te votimit.
- Në Qarkun Elbasan u rinumëruan ZAZ 45 dhe ZAZ 52, konkretisht kutitë e materialeve zgjedhore.
- Në Qarkun Dibër u rinumërua ZAZ 14, me gjithsej 44 kuti.
- Në Qarkun Durrës, për ZAZ 21 dhe ZAZ 22 u rinumëruan si kutitë e votimit ashtu edhe kutitë e materialeve.
- Në Qarkun Durrës, për ZAZ 20, ZAZ 23, ZAZ 24, ZAZ 25 dhe ZAZ 26 u krye hapja e kutive.
- Në Qarkun Durrës u rinumëruan kutitë e votimit nga jashtë.

Identifikimi elektronik

Në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës **11 maj 2025**, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) organizoi dhe zbatoi procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve, përmes përdorimit të **Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI)** dhe sistemeve mbështetëse përkatëse.

Identifikimi elektronik përbën një nga instrumentet kryesore të modernizimit të administrimit zgjedhor në Republikën e Shqipërisë dhe synon, në veçanti:

- garantimin e identifikimit të saktë, të sigurt dhe të verifikueshëm të zgjedhësve;
- parandalimin e rasteve të votimit të shumëfishtë;
- rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së procesit të votimit;
- forcimin e besimit të publikut dhe të subjekteve zgjedhore në integritetin e procesit zgjedhor.

Zbatimi i këtij sistemi u mbështet në përvojën e fituar nga proceset e mëparshme zgjedhore, si dhe në rekomandimet teknike dhe institucionale të dala nga monitorime, auditime dhe analiza paszgjedhore, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të administrimit zgjedhor.

Kuadri vendimmarrës institucional për përdorimin e identifikimit elektronik

Procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025 u formalizua me **Vendimin nr. 10, datë 17.03.2025, të Komisionit Rregullator të KQZ-së**, “Për përdorimin e Pajisjes Elektronike të Identifikimit të Zgjedhësve (PEI) në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Ky vendim përbën aktin themelor institucional mbi të cilin u ndërtua i gjithë procesi pasues, përfshirë planifikimin operacional, përgatitjen teknike të pajisjeve, rekrutimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore, organizimin logjistik dhe zbatimin praktik të identifikimit elektronik në ditën e votimit.

Testimi i sistemit dhe vendimmarrja institucionale (ang. UAT)

Në funksion të përgatitjes për zgjedhjet e 11 majit 2025, KQZ ndërmori procedura për përditësime dhe përmirësime softuerike të Sistemit Elektronik të Identifikimit të Zgjedhësve dhe të Pajisjeve Elektronike të Identifikimit, me qëllim rritjen e performancës, sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit.

Në këtë kuadër, më **28 prill 2025** u zhvillua **Testimi i Pranimit të Përdoruesit (User Acceptance Test – UAT)**, gjatë të cilit u testuan **157 pajisje PEI**, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Testimi u realizua në kushte të simuluar, të afërta me ato të ditës së votimit, dhe kishte për objekt vlerësimin e stabilitetit dhe funksionalitetit operacional të sistemit.

Rezultatet e UAT-it, si dhe testimet shtesë pasuese, evidentuan problematika në qëndrueshmërinë operative të versionit të përditësuar të vitit 2025. Analiza teknike dhe përvoja nga zgjedhjet e mëparshme treguan se konfigurimi i konsoliduar i vitit 2023 ofronte një nivel më të lartë stabiliteti dhe sigurie.

Në këto kushte, dhe në zbatim të parimit të parandalimit të riskut dhe garantimit të vijueshmërisë së procesit zgjedhor, KQZ vendosi që për zgjedhjet e 11 majit 2025 të mos aplikohet përditësimi softuerik i vitit 2025, por të përdorej konfigurimi i provuar dhe funksional i vitit 2023, me qëllim shmangien e çdo rreziku që mund të cenonte zhvillimin normal të procesit të votimit.

Burimet njerëzore: rekrutimi, trajnimi dhe organizimi

Rekrutimi dhe trajnimi i operatorëve PEI

Zbatimi i identifikimit elektronik kërkoi angazhimin e një numri të konsiderueshëm burimesh njerëzore të trajnuara dhe të certifikuara. Për këtë qëllim, KQZ realizoi procesin e rekrutimit dhe trajnimit të **5,500 operatorëve PEI**, të cilët u angazhuan në qendrat e votimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Trajnimet u zhvilluan gjatë periudhës **25 prill – 4 maj 2025**, në të gjitha qarqet e vendit, Programi i trajnimit përfshiu:

- njohjen me pajisjet PEI dhe komponentët përkatës;
- procedurat standarde të identifikimit elektronik;

- menaxhimin e situatave të veçanta dhe rasteve problematike;
- komunikimin me strukturat mbështetëse dhe procedurat e raportimit të incidenteve.

Trajnimi u orientua drejt standardizimit të praktikave dhe garantimit të një niveli të njëjtë profesionalizmi në të gjitha qendrat e votimit.

Strukturat mbështetëse dhe koordinimi

Në ditën e zgjedhjeve, KQZ aktivizoi një strukturë të integruar mbështetjeje, e përbërë nga:

- **22 mbikëqyrës**, përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të identifikimit elektronik në nivel qarku;
- **200 staf suporti teknik në terren**, të shpërndarë në të gjithë territorin e vendit;
- **50 operatorë HelpDesk**, të organizuar në linja mbështetëse funksionale gjatë gjithë ditës së votimit.

Këto struktura siguruan asistencë të menjëhershme për operatorët PEI, veçanërisht në rastet që lidhen me instalimin, konfigurimin dhe funksionimin e pajisjeve.

Përgatitja teknike dhe menaxhimi i pajisjeve të identifikimit elektronik (PEI)

Përgatitja teknike dhe menaxhimi i pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025 u realizua përmes një procesi të planifikuar dhe të kontrolluar, me qëllim garantimin e funksionalitetit të pajisjeve dhe vijueshmërisë së procesit të identifikimit elektronik në të gjitha qendrat e votimit.

Procesi u bazua në përvojën e akumuluar nga përdorimi i identifikimit elektronik në zgjedhje të mëparshme, si dhe në analizat teknike dhe organizative të kryera nga KQZ pas çdo procesi zgjedhor.

Organizimi i përgatitjes teknike

Përgatitja e pajisjeve PEI përfshiuë verifikimin e pajisjeve, përgatitjen e tyre për përdorim, si dhe kontrollin përfundimtar përpara shpërndarjes në terren. Ky organizim synoi të sigurojë që pajisjet të ishin të gatshme për përdorim dhe të minimizojë mundësinë e problematikave teknike gjatë ditës së votimit.

Kontrolli funksional dhe gatishmëria operative

Pajisjet PEI iu nënshtruan verifikimeve funksionale për të siguruar gatishmërinë e tyre operative. Kontrolli synoi të konfirmojë funksionimin e përgjithshëm të pajisjeve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat operative të procesit zgjedhor.

Vetëm pajisjet që përmbushën kriteret e gatishmërisë u përfshinë në procesin e shpërndarjes, ndërkohë që u siguruan edhe pajisje rezervë për përballimin e situatave të paparashikuara.

Menaxhimi dhe përgatitja për përdorim në qendrat e votimit

Përgatitja e pajisjeve PEI u realizua në përputhje me procedurat e miratuara nga KQZ, duke synuar që çdo pajisje të ishte e gatshme për përdorim në momentin e hapjes së qendrave të votimit.

Ky proces kontribuoi në shmangien e ndërprerjeve gjatë identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe në sigurimin e një rrjedhe të qëndrueshme të procesit të votimit.

Qasja parandaluese dhe menaxhimi i riskut

KQZ aplikoi një qasje parandaluese në menaxhimin teknik të pajisjeve PEI, duke marrë masa për të identifikuar dhe adresuar në kohë çdo rrezik potencial që mund të ndikonte në procesin zgjedhor.

Kjo qasje u mbështet nga koordinimi i vazhdueshëm me strukturat e suportit teknik, si dhe nga krijimi i kapaciteteve rezervë për ndërhyrje të menjëhershme në rast nevojë.

Vlerësim përfundimtar i përgatitjes teknike

Në përfundim, përgatitja teknike dhe menaxhimi i pajisjeve PEI për zgjedhjet e 11 majit 2025 u realizuan në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me standardet e përcaktuara nga KQZ.

Ky proces krijoi kushtet e nevojshme për zbatimin e identifikimit elektronik në të gjitha qendrat e votimit dhe kontribuoi në zhvillimin e rregullt dhe të qëndrueshëm të procesit zgjedhor.

Shpërndarja logjistike e pajisjeve PEI

Shpërndarja e pajisjeve PEI u realizua në periudhën **7–9 maj 2025**, në bashkëpunim me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e një grafiku të koordinuar.

Në total, u shpërndanë:

- 5,274 pajisje PEI operative;
- 133 pajisje PEI rezervë.

Shpërndarja u krye në bazë të numrit të qendrave të votimit për çdo Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), duke garantuar rezerva funksionale për përballimin e situatave të paparashikuara dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit territorial.

Problematika të evidentuara dhe menaxhimi i tyre

Gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të identifikimit elektronik u evidentuan problematika të natyrës teknike dhe infrastrukturore, veçanërisht në zona me mbulim të kufizuar të internetit.

Këto situata u adresuan përmes:

- ndërhyrjeve të menjëhershme të stafit të suportit teknik në terren;
- asistencës në kohë reale përmes strukturave HelpDesk;
- koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet strukturave lokale dhe qendrore të KQZ-së.

Falë këtij organizimi, problematikat e hasura nuk patën ndikim thelbësor në vijueshmërinë e procesit të identifikimit elektronik.

Vëzhgimi dhe regjistrimi i procesit zgjedhor përmes kamerave në QV dhe VNV

Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025, KQZ zbatoi regjistrimin video të procesit zgjedhor përmes vendosjes së kamerave në të gjitha qendrat e votimit (QV) dhe në të gjitha vendet e numërimit të votave (VNV), me qëllim rritjen e transparencës, kontrollit dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor.

Sistemi i regjistrimit video u përdor për dokumentimin e procesit të votimit dhe të numërimit të votave, si dhe për forcimin e llogaridhënies së administrimit zgjedhor. Gjatë zbatimit të këtij sistemi, u tregua kujdes i veçantë për garantimin e fshehtësisë së votës, duke vendosur kamerat në pozicione që nuk lejonin regjistrimin e pamjeve brenda dhomave të fshehta të votimit apo identifikimin e zgjedhësve në momentin e shprehjes së vullnetit të tyre.

Sistemi funksionoi në mënyrë të qëndrueshme dhe pa problematika teknike, duke përmbushur rolin e tij si mekanizëm shtesë për garantimin e integritetit dhe transparencës së procesit zgjedhor.

Vlerësim përfundimtar dhe rekomandime

Në përfundim, KQZ vlerëson se procesi i identifikimit elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet e 11 majit 2025 u realizua në mënyrë të kontrolluar, funksionale dhe në përputhje me standardet ligjore dhe teknike të përcaktuara.

Identifikimi elektronik kontribuoi ndjeshëm në rritjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe përbën një bazë të rëndësishme për vijimin e modernizimit të administrimit zgjedhor.

Rekomandohet:

- vijimi i përdorimit të konfigurimeve të konsoliduara dhe të testuara;
- zhvillimi i testeve softuerike në faza më të hershme;
- forcimi i mirëmbajtjes parandaluese të pajisjeve;
- institucionalizimi i strukturave të suportit teknik;
- përmirësimi i udhëzimeve operative për përdorim në zona me kufizime infrastrukture;
- marrja e vendimit nga Komisioni Rregullator për përdorimin e pajisjeve të identifikimit elektronik në një fazë më të hershme të procesit zgjedhor, me qëllim krijimin e më shumë kohe për teste dhe për zhvillimin në kohë të procedurave përkatëse.

Votimi dhe numërimi elektronik

Në përputhje me nenin 22, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka kompetencën të eksperimentojë dhe të vendosë mbi përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve teknologjike në proceset zgjedhore, nëpërmjet projekteve pilot që mbulojnë jo më pak se 10% të zgjedhësve.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 04, datë 13.11.2020, të ndryshuar, ka përcaktuar llojin, karakteristikat dhe standardet teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) që përdoren në Republikën e Shqipërisë.

Në vijim, me vendimin nr. 13, datë 28.04.2025, Komisioni Rregullator vendosi përdorimin e pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025, konkretisht në Bashkinë Vorë dhe në Njësinë Administrative nr. 10 të Bashkisë Tiranë.

Ky raport synon të paraqesë në mënyrë të strukturuar dhe analitike procesin përgatitor, zbatimin praktik në ditën e zgjedhjeve, si dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik.

Procesi përgatitor i votimit elektronik

Përmirësimet teknike të sistemit

Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet e 11 majit 2025, u realizuan një sërë përmirësimesh dhe personalizimesh në sistemin e votimit elektronik, me qëllim rritjen e sigurisë, transparencës dhe lehtësisë së përdorimit. Këto përmirësime përfshinë:

- a) përditësimin e modulit të raporteve, duke mundësuar gjenerimin e raporteve në format PDF sipas pajisjes, qendrës së votimit (QV) dhe zonës së administrimit zgjedhor (ZAZ);
- b) aktivizimin e funksionalitetit **VVPAT (Voter Verified Paper Audit Trail)**, i cili i mundëson zgjedhësit verifikimin fizik të zgjedhjes së tij në fletën e printuar përpara përfundimit të procesit të votimit;
- c) përmirësimin e panelit të kontrollit (Control Panel), të përdorur gjatë përgatitjes së pajisjeve në magazinë, me qëllim reduktimin e kohës së konfigurimit dhe testimit të komponentëve harduerikë;
- d) përmirësime në ndërfaqen e përdoruesit, përfshirë mesazhet udhëzuese, ikonografinë dhe instruksionet vizuale, me qëllim sigurimin e një përdorimi sa më intuitiv dhe të standardizuar të pajisjeve.

Konfigurimi i sistemit EVRMS dhe ngarkimi i të dhënave

Sistemi **EVRMS** u konfigurua në përputhje me parametrat e miratuar nga KQZ. Në këtë sistem u ngarkuan të gjitha të dhënat që lidhen me qendrat e votimit, subjektet zgjedhore, kandidatët dhe partitë politike.

Për zgjedhjet e 11 majit 2025 u programuan **dy pajisje PEVN për çdo qendër votimi**, për gjithsej **75 qendra votimi**, çka përkthehet në **150 pajisje PEVN** të konfiguruar dhe të integruara në sistemin EVRMS.

Konfigurimi dhe përgatitja e pajisjeve PEVN

Procesi i përgatitjes dhe konfigurimit të pajisjeve PEVN u realizua nga personeli teknik dhe operatorët e magazinës, duke përfshirë ciklin e plotë të konfigurimit, testimit dhe kontrollit të cilësisë.

Afati kohor i përgatitjes:

- Fillimi: 1 maj 2025
- Përfundimi: 2 maj 2025

Pajisje të konfiguruar:

- Gjithsej: 150 PEVN
- Bashkia Vorë: 88 pajisje (44 QV)
- Njësia Administrative nr. 10, Tiranë: 62 pajisje (31 QV)

Pajisje rezervë: gjithsej: 10 PEVN (5 për Bashkinë Vorë dhe 5 për Njësinë Administrative nr. 10, Tiranë).

Çdo set PEVN u pajis me të gjithë aksesorët përbërës, u etiketua dhe u vulos sipas procedurave të miratuara. U krye diagnostikimi i komponentëve kryesorë (ekran, printer, audio, lexues karte smart, buton aktivizimi), si dhe kontrolli përfundimtar i cilësisë përpara shpërndarjes.

Monitorimi i përgatitjes – Sistemi WPMS

Gjatë gjithë procesit të përgatitjes teknike u përdor **Sistemi i Monitorimit të Prodhimit të Magazinës (WPMS)**, i cili mundësoi gjurmimin në kohë reale të statusit të përgatitjes së çdo pajisjeje PEVN.

Çdo pajisje u konfigurua në mënyrë specifike për qendrën përkatëse të votimit, duke garantuar gjurmueshmëri të plotë, kontroll të vazhdueshëm dhe minimizim të rrezikut të gabimeve logjistike apo teknike.

Trajnimi i operatorëve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi një proces të strukturuar trajnimi për operatorët e PEVN, i zhvilluar në ambientet e KQZ-së. Trajnimet u realizuan në katër grupe dhe përfshinë:

- njohuri teorike mbi funksionimin e pajisjeve;
- ushtrime praktike dhe simulime të situatave reale;
- trajtimin e problematikave të mundshme gjatë procesit të votimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.

Ky proces trajnimi synoi përgatitjen e plotë të operatorëve për garantimin e një procesi zgjedhor të sigurt, të qetë dhe të administruar në përputhje me procedurat e miratuara.

Testimi i pajisjeve

Më datë **29 prill 2023** u realizua **Testimi Publik Operacional i PEVN**, i njohur gjithashtu si **Testimi i Pranimit nga Përdoruesit (User Acceptance Testing – UAT)**. Ky testim kishte për

qëllim verifikimin e funksionalitetit dhe besueshmërisë së sistemit në kushte reale, përpara përdorimit të tij në procesin zgjedhor.

Në testim morën pjesë përfaqësues të partive politike, medias, si dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare. Aktiviteti u organizua nga KQZ në ambientet e saj.

Për testimin operacional u përdorën gjithsej **4 pajisje PEVN**, konkretisht:

- 2 (dy) pajisje për Bashkinë Vorë;
- 2 (dy) pajisje për Njësinë Administrative nr. 10, Tiranë.

Gjatë testimit u ekzekutuan të gjitha proceset kryesore operative, përfshirë hapjen e votimit, simulimin e votimit me 50 vota për çdo pajisje dhe mbylljen e votimit. Pas përfundimit të votimit u printuan raportet individuale nga pajisjet PEVN, u realizua transmetimi elektronik i rezultateve dhe u gjeneruan raporte përmbledhëse për çdo ZAZ nga sistemi qendror.

Testimi publik operacional konfirmoi funksionimin korrekt të pajisjeve dhe të sistemit, si dhe gatishmërinë e tyre për përdorim në zgjedhjet reale. Ky proces kontribuoi në rritjen e besimit të publikut dhe të aktorëve të përfshirë në përdorimin e teknologjisë elektronike të votimit.

Mbështetja teknike për mbarëvajtjen e procesit në ditën e zgjedhjeve

Duke qenë se shpërndarja dhe instalimi i pajisjeve PEVN u realizua një ditë përpara ditës së votimit, mbështetja teknike për këtë proces nisi më **10 maj 2025**. Kjo mbështetje synoi trajtimin e çdo problematike që mund të lindte gjatë instalimit të pajisjeve, duke përfshirë çështje logjistike, operative dhe teknike në terren.

Gjatë këtij procesi u evidentuan dhe u trajtuan disa problematika të kufizuara, të lidhura kryesisht me mungesën ose dëmtimin e disa aksesoreve, si dhe një rast i vetëm ku u zëvendësua pajisja për shkak të një problemi fizik me një nga portat USB.

Mbështetja teknike vijoi edhe në ditën e zgjedhjeve, më **11 maj 2025**. Linja e parë e suportit ishte qendra HelpDesk e ngritur pranë KQZ-së, e cila pranoi raportime direkte nga operatorët e PEVN në çdo qendër votimi.

Komunikimi i vazhdueshëm, verifikimi përmes provave fotografike, udhëzimet e menjëhershme përmes grupeve WhatsApp, telefonatave të drejtpërdrejta, si dhe koordinimi me ekipet e mbështetjes në terren, mundësuan zgjidhjen efektive të shumicës së rasteve në vend, duke minimizuar ndërprerjet e procesit të votimit. Në rastet kur zgjidhja në distancë rezultoi e pamjaftueshme, u realizuan ndërhyrje fizike në qendrat e votimit, duke reduktuar vonesat dhe ndikimin në proces.

Përfundimi i votimit, numërimi dhe vlerësimi i votave

Pajisjet elektronike regjistruan të gjitha votat me saktësi të plotë. Në orën **19:00** të datës **11 maj 2025** nisi procesi i transmetimit të rezultateve nga vendet e votimit.

Stafi i Qendrës Kombëtare të Mbështetjes asistoi dhe udhëzoi operatorët e PEVN për lidhjen e modemeve dhe realizimin e transmetimit të rezultateve. Krahas transmetimit përmes



modemit, u përdor edhe transmetimi përmes **QR code**, i realizuar nëpërmjet **aplikacionit KQZ APP**, i cili mundësoi marrjen e informacionit edhe nga zonat me mbulim të kufizuar të rrjetit celular.

Kapitulli 5

DOKUMENTACIONI DHE MODELET

Dokumentacioni zgjedhor dhe materialet e votimit përbëjnë dy shtylla thelbësore të miradministrimit të procesit zgjedhor. Në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka ndërmarrë një proces të gjerë rishikimi, përmirësimi dhe standardizimi të dokumentacionit zgjedhor, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe praktikave më të mira administrative.

Modelet e vendimeve dhe dokumentacionit të punës së Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) janë hartuar duke pasqyruar në mënyrë të plotë të gjithë elementët, faktet dhe rubrikat që Kodi Zgjedhor përcakton si detyrim për t'u dokumentuar gjatë administrimit të procesit të votimit. Në këtë kuadër, KQZ identifikoi nevojën për rikonceptimin e dokumentacionit ekzistues, si për KZAZ-të ashtu edhe për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), si dhe hartoi dokumentacion shtesë me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Ndërhyrjet në dokumentacionin zgjedhor synuan standardizimin e praktikave administrative dhe reduktimin e gabimeve, përmes miratimit të modeleve të reja për librat e protokollit, regjistrat e posaçëm, procesverbalet e votimit dhe numërimit, si dhe për vendimet standarde të emërimit dhe konstituimit të organeve të administrimit zgjedhor.

Megjithëse këto përmirësime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt rritjes së profesionalizmit të administratës zgjedhore, praktika eidentoi se dokumentacioni i përmirësuar nuk mund të kompensojë mungesën e stabilitetit të burimeve njerëzore dhe nivelin e pabarabartë të trajnimit të anëtarëve të administratës zgjedhore.

Dokumentacioni i punës së KZAZ

Me vendimin nr. 22 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u miratua dokumentacioni i punës së KZAZ-ve. Ndryshe nga vitet e kaluara, dhe me synim lehtësimin e punës së këtyre strukturave, u konceptuan modele të unifikuara vendimesh, konkretisht:

1. modeli i vetëm i vendimit për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së;
2. modeli i vetëm i vendimit për emërimin e kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së;
3. modeli i vetëm i vendimit për emërimin e anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave (GNV).

Gjithashtu, u rikonceptua Libri i Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë në mënyrë të integruar edhe vendimet e marra nga KZAZ-ja. Në këtë libër u pasqyruan të gjitha

fazat e procesit zgjedhor, që nga konstituimi i KZAZ-së deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, përfshirë vendimmarrjet, informacionet, pretendimet e vëzhguesve, verifikimet dhe elementë të tjerë proceduralë. Pjesë përbërëse e këtij dokumentacioni u bë edhe modeli i listëprezencës së anëtarëve të KZAZ-së, për evidentimin e pjesëmarrjes së tyre gjatë ushtrimit të detyrës.

Si dokumentacion shtesë për anëtarët e KZAZ-ve të propozuar nga partitë politike, u miratuan edhe dy modele formularësh:

1. vetëdeklarim për mosekzistencën e kushteve të papajtueshmërisë dhe përmbushjen e kushteve ligjore për emërimin si anëtar/sekretar i KZAZ-së;
2. deklaratë vetëdeklarimi për mosekzistencën e konfliktit të interesit.

Plotësimi i këtyre formularëve ishte detyrim ligjor për të gjithë anëtarët e propozuar nga partitë politike.

Dokumentacioni i punës së KQV

Me vendimin nr. 26 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u miratua dokumentacioni i punës së Komisioneve të Qendrave të Votimit. Në këtë kuadër u miratua modeli i listëprezencës së anëtarëve të KQV-së, i cili shërben si për mbarëvajtjen e punës dhe evidentimin e pjesëmarrjes gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe për efekt të pagesës së anëtarëve.

Në Librin e Protokollit të KQV-së u shtuan dy rubrika të reja: rubrika për vërejtjet e vëzhguesve dhe rubrika për vërtetimin e identifikimit të zgjedhësit me nënshkrim, pa shenja gishtërinjsh. Ndryshime u reflektuan edhe në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve, duke evidentuar administratën zgjedhore dhe operatorët e pajisjeve PEI dhe PEVN që ushtronin detyrën në qendra votimi ku nuk figuronin në listën e zgjedhësve, si dhe zgjedhësit që ushtronin të drejtën e votës me vendim gjykatë.

Me vendimin nr. 480 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u miratuan shtesa të rëndësishme në dokumentacionin e punës, ndër të cilat:

- modeli i vetëm i vendimit për lirimin e anëtarit dhe sekretarit të KQV-së;
- modeli i vetëm i vendimit për emërimin e anëtarit/sekretarit të KQV-së për shkak vakance;
- modeli i vendimit për caktimin e koordinatorëve të sigurisë;
- shenjat dalluese (badge) dhe specifikimet e banderolës së koordinatorëve të sigurisë;
- procesverbali për evidentimin e parregullsive dhe njoftimin e Policisë së Shtetit.

Koordinatorët e sigurisë u rregulluan në mënyrë të posaçme me vendimin nr. 24, datë 21.03.2025, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu, u miratuan dy vërtetime standarde për vulosjen e kutisë së votimit përpara fillimit të votimit dhe për mbylljen e kutisë së votimit, të cilat shërbejnë për njësimin e kopjeve të procesverbaleve me të dhënat e procesverbalit origjinal.

Dokumentacioni për sigurinë dhe kutinë rezervë të votimit

Me vendimin nr. 25, datë 27.03.2025, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 12, datë 30.12.2020, ‘Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve’”, u bënë ndryshime në modelet e identifikimit të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe në identifikimin e automjeteve të angazhuara në shërbim të zgjedhjeve.

Për shkak të madhësisë së fletës së votimit, me vendimin nr. 29 të Komisionit Rregullator u miratua përdorimi i kutisë rezervë të votimit. Më tej, me vendimin nr. 655 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve u miratua modeli i procesverbalit dhe modeli i etiketës së kutisë rezervë. Procesverbali për kutinë rezervë parashikon në mënyrë të detajuar pasqyrimin e datës dhe orës, numrit të zgjedhësve të identifikuar nga pajisja PEI, numrit të fletëve të gjetura në kutinë e mbushur, kodit të pestë të sigurisë, sasisë së fletëve të papërdorura dhe të dëmtuara, si dhe kodeve të vulave të sigurisë të vendosura në kutinë rezervë. Të gjitha këto të dhëna regjistrohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

Kapitulli 6

EDUKIMI DHE INFORMIMI I ZGJEDHËSVE

Programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, është konceptuar dhe zbatuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me synim kryesor rritjen e njohurive të zgjedhësve mbi procesin zgjedhor, fuqizimin e besimit në integritetin e tij si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së gjerë dhe të informuar në votim.

Ky program ka synuar të sigurojë informim të plotë dhe të paanshëm për zgjedhësit mbi të gjithë hapat e procesit zgjedhor, mënyrën e ushtrimit të së drejtës së votës, si dhe të forcojë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e votës dhe ndikimin e saj në vendimmarrjen demokratike.

Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve përbëjnë një komponent thelbësor të përgatitjes së procesit zgjedhor dhe janë konsideruar nga KQZ si një nga shtyllat kryesore për garantimin e standardeve demokratike dhe rritjen e transparencës.

Baza programore dhe normative

Procesi i informimit dhe ndërgjegjësimit publik për zgjedhjet e datës 11 maj 2025 është mbështetur në miratimin e tre programeve specifike:

- Vendimi nr. 207, datë 11.12.2024**
“Për Programin e Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.
- Vendimi nr. 208, datë 11.12.2024**
“Për Programin e Edukimit për Zgjedhësit e Pakicave Kombëtare”.
- Vendimi nr. 206, datë 11.12.2024**
“Për Programin e Edukimit për Zgjedhësit me Aftësi të Kufizuara”.

Këto akte programore kanë orientuar të gjithë veprimtarinë informuese dhe edukuese të KQZ-së, duke përcaktuar objektivat, grupet e synuara, mjetet e komunikimit dhe formatet përkatëse.

Përshkrimi i përgjithshëm i programit

Programi është zbatuar përmes një sërë fushatash të ndërlidhura komunikimi, të orientuara sipas tematikave dhe grupeve specifike të zgjedhësve, duke përdorur:

- Spote televizive dhe radiofonike;
- Spote dhe video informuese në rrjetet sociale;

- Posterë, fletëpalosje dhe materiale të tjera të shtypura;
- Reklama të ndriçuara (City Lights), banera, billboard-e;
- Transmetime në Ledwall;
- Aplikacionin për smartphone “KQZ”;
- Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) për votuesit nga jashtë;
- Takime të drejtpërdrejta me grupe të synuara (target-grupe);
- Konferenca për shtyp dhe dalje publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Qasja e ndjekur ka synuar kombinimin e mjeteve tradicionale të komunikimit me platformat dixhitale dhe mjetet interaktive, për të siguruar mbulim sa më të gjerë gjeografik dhe demografik, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe për zgjedhësit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Fushata tematike dhe aktivitetet përkatëse

Fushata “Krimet zgjedhore / Shitblerja e votës”

Qëllimi:

Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore mbi veprat penale dhe shkeljet ligjore që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, me fokus të veçantë në fenomenin e shitblerjes së votës, si dhe pasojat dhe sanksionet përkatëse.

Mjetet kryesore të përdorura:

- Spote televizive (42 sekonda), të transmetuara në 22 televizione (3 kombëtare dhe 19 rajonale), me mijëra transmetime gjatë gjithë periudhës zgjedhore;
- Spot radiofonik (30 sekonda), i transmetuar në 3 stacione radiofonike kombëtare;
- Posterë në çdo Qendër Votimi (rreth 10 500 postera në 5 225 QV);
- Video (20 sekonda) në 32 Ledwall në qytete kryesore të vendit, me transmetime të shpeshta periodike;
- Transmetime dhe publikime në rrjetet sociale zyrtare të KQZ (“KQZShqiperi”) në Facebook, Instagram, X dhe YouTube, edhe në 8 gjuhët e pakicave kombëtare dhe në gjuhën e shenjave;
- Banera në 22 faqe web të televizioneve me të cilat KQZ ka marrëdhënie kontraktuale;
- Reklama të ndriçuara (City Lights) dhe postera në stacionet e autobusëve në të gjithë vendin;
- Konferenca periodike për shtyp, me apel për denoncimin e rasteve të shitblerjes së votës në organet ligjzbatuese dhe në portalin e dedikuar në faqen zyrtare të KQZ;
- Aktivitetet me target-grupe në të gjithë vendin;
- Përdorimi i aplikacionit për smartphone “KQZ” si mjet informimi dhe denoncimi.

Spot i përbashkët KQZ–SPAK–Prokuroria e Përgjithshme:

U realizua një spot i përbashkët me thirrje për denoncimin e krimeve zgjedhore, i transmetuar në 22 televizione (kombëtare dhe rajonale).

Fushata “Kontrollo emrin në listën e zgjedhësve”

Qëllimi:

Informimi i zgjedhësve për listën e zgjedhësve dhe qendrën e tyre të votimit, si dhe nxitja e verifikimit paraprak të të dhënave.

Mjetet:

- Spot televiziv (40 sekonda), i transmetuar në 22 televizione, me një numër shumë të lartë transmetimesh;
- Spot radiofonik (30 sekonda), i transmetuar 5 000 herë në 3 radio kombëtare;
- Dy video të dedikuara në 32 Ledwall në qytete kryesore;
- Banera në 10 autobusë urbanë në qarkun e Tiranës;
- Postera në 30 stacione autobusësh me fluks të lartë qytetarësh;
- Reklama të ndriçuara (City Lights) në qytete kryesore;
- Publikime të vazhdueshme në rrjetet sociale të KQZ;
- Banera në media online;
- Promovimi i rubrikës “Qendra e Votimit” në aplikacionin “KQZ” për verifikimin elektronik të qendrës së votimit;
- Aktivitetet me target-grupe, ku mesazhi kryesor ka qenë verifikimi paraprak i emrit në listë.

Fushata “Hapat për të votuar”

Qëllimi:

Informimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ditën e zgjedhjeve, dokumentet e nevojshme, si dhe procedurat e identifikimit elektronik.

Mjetet:

- Spot televiziv (50 sekonda), i transmetuar mbi 30 mijë herë në 22 televizione;
- Rreth 10 500 postera “Hapat për të Votuar” të vendosur në çdo QV;
- Reklama të ndriçuara (ang. city lights) në qytetet kryesore;
- Postera në 20 stacione autobusësh me fluks të lartë;
- Publikime në rrjetet sociale, edhe në gjuhët e pakicave dhe në gjuhën e shenjave;
- Baner në media online;
- Takime informuese në të gjithë vendin me zgjedhës dhe target-grupe të ndryshme.

Fushata “Thirrja për pjesëmarrje në zgjedhje”

Qëllimi:

Ndërgjegjësimi i zgjedhësve për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhjet e datës 11 maj 2025.

Mjetet:

- Fushatë e gjerë në rrjetet sociale të KQZ;
- Spot “Thirrje për pjesëmarrje” (15 sekonda), i transmetuar në Ledwall-e në të gjithë vendin, me një numër shumë të lartë shfaqjesh;
- Vendosja e 5 billboard-eve në pikat kufitare dhe në qytete kryesore;
- Banera në autobusë urbanë;
- Takime ndërgjegjësuere me target-grupe në të gjithë vendin.

Votimi dhe numërimi elektronik (PEVN)

Në zgjedhjet e datës 11 maj 2025, votimi dhe numërimi elektronik (PEVN) u realizua në njësinë administrative nr. 10 në Tiranë dhe në Bashkinë Vorë.

Qëllimi:

Informimi, edukimi dhe familjarizimi i zgjedhësve me pajisjen dhe procedurat e votimit dhe numërimit elektronik.

Mjetet:

- 550 postera të vendosur në çdo qendër votimi ku u zbatua projekti pilot PEVN;
- Video (15 sekonda) për “Plotësimin e Fletës së Votimit” me pajisjen PEVN, e transmetuar në Ledwall me frekuencë të lartë;
- Spot-tutorial i publikuar në rrjetet sociale të KQZ, edhe në gjuhët e pakicave dhe në gjuhën e shenjave;
- 6 City Lights në qarkun e Tiranës;
- Ngritja e 5 pikave të lëvizshme testimi me makineri PEVN, ku qytetarët patën mundësi të testonin pajisjen;
- Deklarata publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke garantuar sigurinë e procesit dhe sekretin e votës.

Fushata “Informimi dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore”

Qëllimi:

Ndërgjegjësimi i punonjësve të administratës publike për ndalimet ligjore gjatë fushatës zgjedhore, parandalimi i shkeljeve dhe raportimi i tyre.

Mjetet:

- 5 spote informuese (rreth 1 min e 20 sekonda) të publikuara në rrjetet sociale;
- 150 postera sensibilizues të shpërndarë në institucionet publike qendrore dhe vendore;
- 70 udhëzues të posaçëm për administratën publike mbi veprimtaritë e ndaluara gjatë periudhës zgjedhore.

Të rinjtë/votues për herë të parë**Qëllimi:**

Edukimi dhe motivimi i të rinjve, veçanërisht votuesve për herë të parë, për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për ta ushtruar në mënyrë të përgjegjshme të drejtën e votës.

Mjetet:

- 5 spote sensibilizuese (30 sekonda) në rrjetet sociale, me pjesëmarrjen e të rinjve nga profesione të ndryshme;
- Publikime të vazhdueshme në rrjetet sociale të KQZ, edhe në gjuhët e pakicave dhe në gjuhën e shenjave;
- Takime ndërgjegjësuere me të rinj në të gjithë vendin.

Fushata “Pakicat kombëtare”**Qëllimi:**

Sensibilizimi dhe informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtare, në gjuhën e tyre, për të gjitha hapat e procesit zgjedhor, me synim rritjen e pjesëmarrjes.

Mjetet:

- Spote televizive (“Kontrollo emrin në listë”, “Krimet zgjedhore”, “Hapat për të votuar”, “Plotësimi i fletës së votimit”) të përshtatura me titra në gjuhët e 8 pakicave kombëtare dhe të transmetuara në median lokale;
- 1 000 postera në gjuhët greke, maqedonase, arumune, rome, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare;
- 1 600 fletëpalosje në 8 gjuhët e pakicave, të shpërndara me mbështetjen e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve;
- Publikime në rrjetet sociale të KQZ në gjuhët e pakicave;
- 5 reklama të ndriçuara (City Lights) në zonat me përqendrim të pakicave;
- Billboard në pikën kufitare të Kakavijës (për pakicën greke) dhe në Muriqan (për pakicën malazeze);
- Takime ndërgjegjësuere me të rinj dhe gra të pakicave kombëtare.

Fushata “Gratë në procesin zgjedhor”

Qëllimi:

Edukimi dhe ndërgjegjësimi për pjesëmarrjen aktive të grave në zgjedhje, parandalimi i votimit familjar dhe garantimi i ushtrimit të lirë dhe të pavarur të të drejtës së votës.

Mjetet:

- Spote sensibilizuese me gra nga profesione të ndryshme, të publikuara në rrjetet sociale;
- Video dhe postera me fokus rolin e grave në proceset zgjedhore, të publikuara në platformat e KQZ;
- Takime me gra në një sërë qytetesh (Dibër, Gjirokastër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër, Lezhë, Sarandë), me fokus përfaqësimin dhe fuqizimin e tyre;
- Takime me gra kandidate, për t’i informuar mbi procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kandidim.

Personat me aftësi të kufizuar (PAK)

Qëllimi:

Informimi dhe ndërgjegjësimi për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara dhe rritjen e aksesueshmërisë.

Mjetet:

- Përshtatja e të gjithë spotëve të fushatës edukuese në gjuhën e shenjave;
- Prodhimi i 4 spotëve televizive (80 sekonda), me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në shikim dhe tetraplegjik;
- Video dhe postera me fokus PAK, të publikuara në rrjetet sociale të KQZ;
- 5 500 postera sensibilizues për aksesueshmërinë, të vendosur në çdo QV;
- 15 takime ndërgjegjësuere në të gjithë vendin me persona me aftësi të kufizuara;
- Përdorimi i fletës së votimit në alfabetin Braille për personat me aftësi të kufizuar në shikim.

Fushata “Plotësimi i fletës së votimit”

Qëllimi:

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e saktë të plotësimit të fletës së votimit, me qëllim minimizimin e pavlefshmërisë së votave.

Mjetet:

- Spot televiziv (60 sekonda) për “Plotësimin e fletës së votimit”, i transmetuar rreth 10 000 herë;

- 12 000 postera me emrat e kandidatëve për deputetë, të vendosur në çdo QV;
- Video 30-sekondëshe në 32 Ledwall në qytetet kryesore;
- Postera dhe video në rrjetet sociale me mesazhe për plotësimin korrekt;
- Baner në median online;
- Transmetimi i mesazheve promovionale në 12 emisione prime time gjatë 15 ditëve të fundit para zgjedhjeve.

Kapitulli 7

REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndër të tjera, kryen funksionin e veprimtarisë së tij në përputhje me Kodin Zgjedhor, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Vendimin nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015” të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ligjeve të tjera si dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim, në funksion të realizimit të zgjedhjeve sipas starndarteve.

Faza përgatitore për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, miratoi:

- Udhëzimin nr. 2, datë 22.01.2025 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”;
- Vendim nr. 46, datë 22.01.2025 “Për caktimin e numrit të kandidatëve për deputet në listat shumemërore të paraqitura nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë”;
- Vendimi nr. 734, datë 25.08.2023 “Për përdorimi e Portalit Elektronik për Partitë Politike (PEPP) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore”.

Në kuadër të zhvillimit të procesit zgjedhor u ndërmorën hapat si më poshtë:

Koordinimi me DPGJC dhe DPB për të realizuar në kohë sa më të shpejtë verifikimin e gjendjes gjyqësore dhe gjendjes civile të kandidatëve garues;

Përgatitja e personelit part-time, trajnimi i tyre për përdorimin e modulit PEPP (Portali Elektronik i Partive Politike) në lidhje me verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve.

Procesi i regjistrimit të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, mori në shqyrtim dhe vendosi si më poshtë:

- Regjistrimin e partive politike si subjekt zgjedhor;
- Regjistrimin e koalicioneve si subjekt zgjedhor;
- Regjistrimin e komiteteve nismëtare;
- Regjistrimi i kandidatëve për Deputet të propozuar nga zgjedhësit;
- Regjistrimi i listave shumemërore të kandidatëve për Deputet të propozuar nga subjektet zgjedhore;

Në kuadër të procesit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore, miratimi i listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet të propozuar nga subjektet zgjedhore, të përgatitjes së fletëve të votimit veçanërisht në përmbajtje, Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Mandatet ka kryer detyrat si më poshtë:

- Administrimi i dokumentacionit të subjekteve zgjedhore;
- Hartimin e shkresave për informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme (verifikim më të thelluar);
- Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit;
- Hartimi i projektaktit për regjistrim/refuzim të subjekteve zgjedhore;
- Hartimi i projektaktit për regjistrim/refuzim të listave shumëmemërore;
- Hartimi i projektatit për hedhjen e shortit për renditjen e kandidatëve në fletën e votimit;
- Hartimi i projektaktit për përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Deputet;
- Përgatitja e Fletës së votimit;
- Miratimi i Tabelave Përmbledhëse të rezultatit sipas qarkut (TPR);
- Shpërndarja e mandateve sipas qarkut.

Procesi i verifikimit të dokumentacionit të kandidimit nëpërmjet Portalit Elektronik për Partitë Politike (PEPP)

Në kuadër të verifikimit të dokumentacionit të kandidimit, formularëve të vetëdeklarimit si dhe përgatitjes së fletës së votimit është implementuar Portali Elektronik për Partitë Politike (PEPP) me anë të së cilit është bërë i mundur si më poshtë:

Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Partitë Politike/Koalicionet lidhur me kërkesën për t'u regjistruar;

Verifikimi i kuotës gjinore;

Verifikimi i numrit të kandidatëve në listë sipas numrit të mandateve për zonën zgjedhore, të vendosur me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

Administrimi dhe Verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit;

Të dhëna statistikore

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në zbatim të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit administrativ dhe dokumentacionit përkatës ka vendosur si vijon:

- Regjistrimin si subjekte zgjedhore 53 partive politike;
- Regjistrimin e 3 koalicioneve zgjedhore;

Në përfundim të procesit vetëm 11 subjekte zgjedhore kanë depozituar lista shumëmemërore:

- 8 (tetë) parti politike që kanë depozituar lista shumëmemërore me lista të mëvetme;

- 30 (tridhjetë) parti politike që janë pjesë e 3 koalicioneve, kanë depozituar lista shumemërore me kandidat të përbashkët;

Në përfundim, u miratuan 132 (njëqind e tridhjetë e dy) lista shumemërore.

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, janë regjistruar në total 2046 kandidatë për Deputet. Pas përfundimit të procesit zgjedhor rezultojnë se Kandidatët fitues janë 140 (njëqind e dyzet).

Të dhënat në format elektronik mbi subjektet zgjedhore të regjistruara për Zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



Kandidatët dërguar për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për kandidatët për Deputet.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat, të cilit i takon të marrë mandatin e Deputetit, sipas ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.

Përsa i përket ndalimeve të parashikuara në nenin 2, pika 2, të ligjit nr.138/2015, për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra nga kandidatët. Në referim të sa më sipër janë dërguar për verifikim të mëtejshëm si më poshtë:

Kandidatë në total të dërguar për verifikim të thelluar janë 16;

Përgjigje për verifikimin e kandidatëve për Deputet nga Prokuroria e Përgjithshme deri tani janë 4.

Periudha pas ditës së zgjedhjeve

Pas përfundimit të procesit zgjedhor të datës 11 Maj 2025, në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe brenda afateve ligjore u ndërmorën hapat si më poshtë:

- Hartim i projektakteve për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve për çdo qark
- Hartim projektakteve për shpërndarjen e mandateve për kandidatët për Deputet për çdo qark;
- Hartim i projekt aktit për shpalljen e rezultatit përfundimtar;

Problematika të hasura gjatë verifikimit të dokumentacionit të kandidimit dhe regjistrimit të tyre

Procesi i verifikimit të dokumentacioni u realizua brenda afateve ligjore dhe në mënyrë të plotë dhe tërësore. Problematikat e vërejtura lidhen me:

Problematika kryesore lidhet me afatet e dorëzimit të dokumentacionit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore duke përfshirë edhe formularët e vetëdeklarimit;

Nga partitë politike dokumentacioni i kandidimit bashkë me formularët e vetëdeklarimit (FVD) janë dorëzuar në orët e fundit të afatit të përcaktuar. Për këto arsye, dokumentacioni u dorëzua i paplotë, me mangësi të cilat u plotësuan më vonë;

Me anë të Portalit Elektronik të Partitë Politike (PEPP) u konstatuan rastet ku nuk ishte respektuar kuota gjinore, pas konstatimit/verifikimit u kthyen listat për korrigjim po nëpërmjet PEPP;

Disa subjekte zgjedhore në disa zona zgjedhore kanë propozuar kandidatë të njëjtë në listat shumëmemërore. Me anë të modulit të PEPP u arrit evidentimi i rasteve dhe u kthyen për korrigjim;

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025 kanë kandiduar 2046 kandidatë, verifikimi i formulareve të vetëdeklarimit është bërë brenda një afati shumë të ngutshëm duke vështirësuar përmbushjen e detyrimit që buron nga ligji nr.138/2015 dhe Kodi Zgjedhor;

Janë hasur vështirësi në verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të kandidimit pas ridepozitimit të listave të korrigjuara për shkak të afateve ligjore strikte.

Ndërveprimi DPGJC ka pasur vonesa pasi përgjigjja për verifikimin e kandidatëve ka ardhur pas kalimit të çdo afati;

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, kemi pasur problematika që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji. Vështirësia lidhet me detyrimin që ka subjekti vetëdeklarues për të deklaruar vepra që nuk e vendosin në kushtet e ndalimit apo vepra të cilat janë parashkruar, etj.

Kapitulli 8

KOMISIONET ZGJEDHORE

Puna përgatitore për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 nisi me rishikimin, përditësimin dhe konsolidimin e kuadrit nënligjor që rregullon administrimin zgjedhor. Qasja e ndjekur u orientua drejt standardizimit të procedurave, harmonizimit me dispozitat e Kodit Zgjedhor, si dhe adresimit të problematikave të evidentuara në terren gjatë proceseve të mëparshme zgjedhore.

Gjatë kësaj faze janë hartuar dhe miratuar udhëzime, procedura teknike dhe amendime apo akte normative që rregullojnë funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV), Grupeve të Numërimit të Votave (GNV), procesin e trajnimit, si dhe administrimin e dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore.

Kjo fazë paraprake ka pasur rëndësi thelbësore, pasi para nisjes së trajnimit të administratës zgjedhore dhe ditës së votimit, u konsolidua një paketë e unifikuar aktesh, e cila shërbeu si bazë e qëndrueshme dhe referencë e unifikuar për të gjithë zinxhirin administrativ zgjedhor.

Qendrat e votimit dhe harta zgjedhore

Në funksion të garantimit të stabilitetit dhe transparencës në caktimin e qendrave të votimit, si dhe të shmangies së vendimeve arbitrare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me Vendimin nr. 1, datë 15.01.2025, u miratuan shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës zgjedhore”.

Ky akt përcaktoi kritere të qarta dhe objektive për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit, duke saktësuar periudhat e marrjes së vendimeve, detyrimin për dokumentim dhe arsyetim, si dhe detyrimin për raportim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Çdo ndryshim i vendndodhjes është lejuar vetëm për arsye madhore, të dokumentuara dhe të arsyetuara nga kryetarët e bashkive, ndërkohë që u parashikua një mekanizëm i qartë monitorimi dhe ndërhyrjeje nga KQZ.

Në 13 raste, autorizimet për ndryshim të vendndodhjes së qendrave të votimit u dhanë si rezultat i aktivizimit të këtij mekanizmi të përmirësuar, pas ndërhyrjeve të subjekteve zgjedhore.

Organizimi dhe funksionimi i KZAZ dhe KQV

Me Vendimin nr. 2, datë 17.01.2025, u miratuan ndryshime në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-ve dhe KQV-ve, me fokus rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së anëtarëve të administratës zgjedhore. Ndryshimet vendosën detyrimin

për pjesëmarrje në trajnimet e organizuara nga KQZ, si dhe masa të shtuara për ruajtjen e fshehtësisë së votës dhe garantimin e qetësisë në qendrat e votimit.

Gjithashtu, u kufizuan ndërhyrjet e vëzhguesve dhe prania e personave të paautorizuar në qendrat e votimit, si dhe u përmirësua komponenti i sigurisë përmes përcaktimit më të qartë të rolit dhe detyrave të Koordinatorëve të Sigurisë, për monitorimin dhe raportimin e incidenteve.

Koordinimi i administratës zgjedhore me Policinë e Shtetit

Në funksion të garantimit të një mjedisi zgjedhor të sigurtme Vendimin nr. 25, datë 27.03.2025, u miratuan shtesa dhe ndryshime në rregullat për veprimtarinë e Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve. Ndryshimet synuan përmirësimin e mekanizmave të reagimit të menjëhershëm të Policisë së Shtetit pas sinjalizimit nga autoritetet zgjedhore, si dhe forcimin e masave parandaluese ndaj pranisë së paautorizuar dhe sjelljeve kërcënuese në një perimetër prej 150 metrash rreth qendrave të votimit.

Këto masa kontribuuan në rritjen e sigurisë së administratës zgjedhore dhe të zgjedhësve, si dhe në parandalimin e incidenteve që cenojnë integritetin e procesit.

Logjistika dhe administrimi i materialeve zgjedhore

Me Vendimin nr. 29, datë 25.04.2025, u miratuan procedura të posaçme për përdorimin e kutive rezervë të votimit. Nevoja për këtë ndërhyrje u vlerësua nga rreziku për pamjaftueshmëri të kapacitetit mbajtës të kutive ekzistuese, për shkak të dimensioneve të mëdha të fletëve të votimit (format A3+).

Akti përcaktoi rregulla të qarta për dërgimin, administrimin, hapjen, mbylljen dhe numërimin e kutive rezervë, duke garantuar vijueshmërinë e procesit, dokumentimin e plotë dhe transparencën në çdo fazë.

Konstituimi dhe funksionimi i KZAZ

Administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e datës 11 maj 2025 u mbështet në funksionimin e 93 Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të cilat përbëjnë nivelin kryesor të drejtimit administrativ të procesit zgjedhor në territor. Për shkak të rolit kyç të këtyre strukturave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u angazhua drejtpërdrejt në të gjitha fazat e emërimit, konstituimit dhe funksionimit të tyre.

Pas finalizimit të paketës nënligjore, sfida kryesore operative mbeti konstituimi i KZAZ-ve si hallka vendimmarrëse e zinxhirit administrativ. Procesi evidentoi dy problematika strukturore të përsëritura:

- (i) vonesa në dorëzimin e listave të anëtarëve nga subjektet politike; dhe
- (ii) ndryshime të shpeshta në përbërje, veçanërisht në bashki të mëdha.

Ky moment është kritik, pasi çdo vonesë dhe çdo lëvizje në përbërje prodhon efekt zinxhir, duke ndikuar në trajnimin, pjesëmarrjen në mbledhje, përgatitjen logjistike dhe rritur rrezikun e gabimeve në ditën e votimit.

Me Vendimin nr. 41, datë 28.01.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcaktoi subjektet politike me të drejtë propozimi për anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, si dhe mekanizmin e caktimit të anëtarit të shtatë sipas shortit. Shumica parlamentare, e përbërë nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Socialdemokrate, kishte të drejtën e propozimit të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve nga radhët e saj.

Pakica parlamentare, e përbërë nga Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë, ushtronte të njëjtën e drejtë për përfaqësuesit e saj në KZAZ.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi, anëtari i shtatë i KZAZ-ve u caktua mbi bazën e ndarjes së balancuar politike, sipas numrit rendor të KZAZ-së, si vijon:

- në KZAZ-të me numër rendor tek, anëtari i shtatë u propozua nga Partia Demokratike;
- në KZAZ-të me numër rendor çift, anëtari i shtatë u propozua nga Partia Socialiste.

Ky mekanizëm synoi ruajtjen e balancës politike në përbërjen e KZAZ-ve dhe garantimin e përfaqësimit simetrik ndërmjet shumicës dhe opozitës në nivel zone administrimi zgjedhor. Në total, subjektet politike paraqitën 744 kandidatura për anëtarë KZAZ.

Megjithëse procesi i konstituimit u zhvillua brenda afateve ligjore, praktika tregoi se respektimi formal i afateve nuk garanton domosdoshmërisht stabilitet funksional. Në thirrjen e parë të mbledhjeve të KZAZ-ve morën pjesë 460 anëtarë, çka dëshmon se një pjesë e përbërjes nuk ishte e konsoliduar që në fazën fillestare.

Konstituimi i KZAZ-ve u krye më 11 shkurt 2025 me 460 anëtarë, prej të cilëve 154 gra dhe 306 burra. Gjatë procesit u evidentuan KZAZ të paplota, konkretisht: 30 KZAZ me 4 anëtarë, 40 KZAZ me 5 anëtarë dhe 23 KZAZ me 6 anëtarë. Pavarësisht këtyre vështirësive, të gjitha 93 KZAZ-të u ngritën brenda afateve ligjore.

U evidentua gjithashtu mungesë e propozimeve nga Partia e Lirisë (PL), e cila nuk paraqiti kandidatura për KZAZ nr. 82 dhe nr. 83.

Përbërja gjinore dhe respektimi i kuotës gjinore në KZAZ

KZAZ-të kanë funksionuar me gjithsej 744 anëtarë dhe sekretarë të propozuar nga subjektet politike me të drejtë propozimi (PS, PD, PSD, PL), nga të cilët 233 gra dhe 511 burra. Përfaqësimi gjinor ka rezultuar i pabarabartë ndër subjekte, me përqindje më të lartë të grave në PS (41%) dhe më të ulët në PL (19%).

Analiza e të dhënave tregon një pabarazi të qëndrueshme midis grave dhe burrave, ku kuota gjinore vazhdon të zbatohet në mënyrë të pjesshme dhe jo të njëtrajtshme nga subjektet politike. Diferencat ndërmjet subjekteve mbeten të ndjeshme dhe tregojnë se barazia gjinore trajtohet shpesh si detyrim formal, dhe jo si element cilësor në administrimin zgjedhor.

Ndryshimet dhe zëvendësimet në KZAZ

Gjatë periudhës së funksionimit të KZAZ-ve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi 77 vendime, të cilat rezultuan në 231 zëvendësime anëtarësh, që përfaqësojnë rreth 31% të totalit të kandidaturave të propozuara.

Ky nivel i lartë zëvendësimesh ndikoi drejtpërdrejt në:

- dobësimin e memories institucionale;
- rritjen e varësisë nga stafi mbështetës i KQZ-së;
- rrezikimin e konsistencës dhe koherencës në vendimmarrje.

Gjithashtu, u evidentuan rotacione të anëtarëve, si brenda së njëjtës KZAZ, ashtu edhe nga një KZAZ në tjetrën, duke reflektuar mungesë planifikimi afatmesëm nga subjektet politike dhe një qasje utilitare ndaj administratës zgjedhore.

Emërimi dhe funksionimi i komisioneve të qendrave të votimit

Përbërja dhe funksionimi i KQV

Pas konstituimit të KZAZ-ve, vëmendja institucionale u fokusua në ngritjen dhe funksionimin e KQV, si struktura bazë operative e procesit të votimit. Në total u administruan 5 225 KQV, me shpërndarjen sipas numrit të anëtarëve si më poshtë:

- QV me 7 anëtarë: 68%;
- QV me 6 anëtarë: 24%;
- QV me 5 anëtarë: 7%;
- QV me 4 anëtarë: 1%.

Nga 36 575 pozicione të parashikuara në KQV, u plotësuan 33 104 pozicione, që përfaqëson 90.5% të totalit. Kjo tregon një nivel të lartë formal përmbushjeje, por jo gjithmonë të shoqëruar me stabilitet funksional.

Sfidat e rekrutimit të administratës zgjedhore

Emërimi i KQV-ve dhe GNV-ve përbën një nga fazat më të ndjeshme të procesit zgjedhor. Megjithëse KZAZ-të respektojnë formalisht afatet ligjore për emërimet, praktika eidentoi vështirësi të përsëritura, veçanërisht për shkak të mungesës së dokumentacionit shoqëruar nga subjektet politike. Në shumë raste, kandidatët u depozituan vetëm formalisht, pa dokumentacionin ligjor të nevojshëm, duke detyruar KZAZ-të të kryenin emërimet efektive në momentet e fundit.

Kjo praktikë rrit rrezikun e gabimeve procedurale dhe ul efektivitetin e trajnimeve paraprake, duke prodhuar efekt zinxhir, që reflektohet në:

- komisionerë të papërgatitur;

- trajnim të cunguar ose të pamundur për t'u realizuar plotësisht;
- vështirësi në koordinim dhe komunikim gjatë ditës së votimit dhe numërimit.

Trajnimi i administratës zgjedhore

Trajnimi i administratës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e datës 11 maj 2025 u organizua nga KQZ si proces i strukturuar në disa nivele, duke përfshirë trajnimin e trajnerëve, trajnimin në terren dhe vlerësimin e njohurive përmes testimit online. Ky model synoi të sigurojë standardizim dhe njëtrajtshmëri në përgatitjen e administratës zgjedhore në të gjithë territorin, duke mbuluar anëtarët e KZAZ, KQV, GNV dhe koordinatorët e sigurisë.

Megjithatë, efektiviteti i trajnimeve u ndikua negativisht nga emërimet e vona, zëvendësimet e shpeshta dhe pjesëmarrja jo e plotë në trajnimet e detyrueshme. Edhe pse u parashikuan penalitete financiare për mosndjekjen e trajnimeve, ky mekanizëm rezultoi i pamjaftueshëm për të garantuar trajnim uniform, për sa kohë procesi i emërimit mbeti i paqëndrueshëm.

Rekrutimi dhe certifikimi i trajnerëve

Me Vendimin nr. 192, datë 05.11.2024, KQZ miratoi programin e trajnimit dhe monitorimit, duke përcaktuar kurrikulën, kriteret e rekrutimit dhe numrin e trajnerëve. Procesi i rekrutimit u zhvillua në tri faza:

(i) verifikimi i dokumentacionit;

(ii) testimi i aftësive;

(iii) trajnim intensiv dhe certifikim (8 ditë × 6 orë), bazuar në metodologjinë BRIDGE.

Në total u trajnuan 98 kandidatë për trajnerë, nga të cilët 88 u certifikuan, me qëllim mbulimin e trajnimeve për KZAZ, KQV, GNV, monitorues, operatorë PEI dhe PEVN. Trajnimet u mbështetën nga OSBE dhe trajnerët u ndanë në afatgjatë dhe afatshkurtër, sipas funksionit operacional. Nga ky pool u angazhuan realisht 78 trajnerë, kryesisht mësues dhe pedagogë.

Zhvillimi i trajnimeve dhe organizimi operacional

Trajnimet u zhvilluan kryesisht në formë ekipesh trajnerësh (të ndarë në çifte), duke garantuar më shumë dinamikë dhe balancë praktike. Për shkak të zëvendësimeve të shpeshta në KZAZ, u organizua edhe trajnim i dytë shtesë. Trajnimet e KQV-ve dhe operatorëve PEI u zhvilluan në periudhën 21 prill – 9 maj, ndërsa trajnimet e GNV-ve më 10 maj 2025, në prag të ditës së zgjedhjeve.

Platforma e-learning (KQZLMS.al) – risi funksionale

Një risi e rëndësishme ishte përdorimi i platformës e-learning (KQZLMS.al), e bazuar në Moodle dhe e aksesueshme si në celular ashtu edhe në ueb. Përpara vënies në funksion të saj, u zhvillua një proces i gjerë hartimi, përpunimi dhe prodhimi të përmbajtjes trajnuese (skripte, video, teste), i orientuar jo vetëm drejt përmbledhjes teorike të legjisllacionit, por edhe drejt përkthimit të procedurave në hapa operacionalë dhe unifikimit të terminologjisë dhe praktikave.

Përmbajtja digjitale e standardizuar u bë e aksesueshme si në platformë, ashtu edhe në kanalet publike të komunikimit të KQZ-së (faqe ueb dhe YouTube), duke shërbyer si instrument kryesor për:

- përfshirjen e anëtarëve që nuk mundën të merrnin pjesë fizikisht;
- kompensimin e zëvendësimeve të minutës së fundit;
- garantimin e minimumit të njohurive procedurale për çdo komisioner të emëruar.

Në platformë u regjistruan rreth 1 100 përdorues aktivë dhe u zhvilluan 4 kurse online.

Të dhëna mbi pjesëmarrjen në trajnim

Në kushtet kur administrata zgjedhore përfshinte mbi 36 000 pozicione KQV/GNV dhe zëvendësimet arrinin rreth 30% të përbërjes, pjesëmarrja në trajnimet fizike të KQV-ve rezultoi e ulët (rreth 27%), duke treguar se një model trajnimi i mbështetur vetëm në prezencë fizike do të ishte objektivisht i pamjaftueshëm.

Në total u trajnuan:

- 5 553 operatorë PEI (100% mbulim);
- 10 165 anëtarë KQV (trajnim fizik dhe online), rreth 27% e totalit;
- 2 042 anëtarë GNV, rreth 60% e pozicioneve;
- 96 monitorues (100%);
- mbi 260 punonjës të administratës së KQZ-së.

U zhvilluan rreth 7 200 teste online, me mesatare vlerësimi 95 pikë, çka dëshmon se pjesëmarrja ishte funksionale dhe jo formale.

Mangësi dhe problematika të evidentuara

Mangësitë kryesore të konstatuara lidhen me:

- mbulim të ulët të KQV-ve në trajnimet fizike (rreth 27%);
- zëvendësime të shpeshta në ditët e fundit, duke sjellë persona pa trajnim;
- mungesë simulimesh praktike në disa qarqe;
- disnivel në aftësitë teknologjike të komisionerëve, veçanërisht në përdorimin e PEI.

Vlerësimi i trajnerëve dhe i procesit të trajnimit

Ndjekja e trajnimeve u realizua në mënyrë më të strukturuar, përmes raportimit në kohë reale nga trajnerët, raporteve përfundimtare, testeve dhe pyetësorëve të pjesëmarrësve. Për herë të parë u aplikua vlerësimi online i trajnerëve, si dhe vlerësimi online i KZAZ-ve dhe KQV-ve, duke mundur matjen në kohë reale të nivelit të përvetësimit të procedurave dhe identifikimin e boshllëqeve. Mesatarja e vlerësimit rezultoi:

- 95 pikë për rreth 7 200 teste për anëtarë KQV;
- 76 pikë mesatarja për KZAZ dhe GNV.

Gabimet kryesore u evidentuan në momente kritike të procesit, si:

- mbyllja e votimit (8% gabime, të reflektuara në 6% të QV-ve);
- procedurat për zgjedhësit me aftësi të kufizuara (8% gabime, 5% e QV-ve);
- roli i kryetarit dhe sekretarit të KQV-së (7% gabime, 4% e QV-ve);
- ndërveprimi me PEI (6% gabime, 3–4% e QV-ve).

Kapitulli 9

LISTA E ZGJEDHËSVE

Lista e zgjedhësve përbën një element thelbësor për garantimin e integritetit, transparencës dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor. Administrimi i saj u realizua në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësitë e pushtetit vendor, në mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë gjithë periudhës përgatitore për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 maj 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ushtroi mbikëqyrje të vazhdueshme dhe zhvilloi kontrole periodike mujore mbi listën e zgjedhësve të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe njësitë e pushtetit vendor, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

Paralelisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve angazhoi auditë teknikë dhe auditë ndihmës të pavarur për verifikimin e ligjshmërisë dhe korrektesisë së veprimeve, si dhe të ndryshimeve të kryera në përbërësit zgjedhorë gjatë periudhës së kontrollit. Procesi i auditimit përfshiu gjithashtu verifikimin e metodologjisë së gjenerimit të raporteve nga baza e të dhënave e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky mekanizëm kontrolli kishte për qëllim garantimin e saktësisë, integritetit dhe transparencës së listës së zgjedhësve, përmes publikimit periodik në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të raporteve mujore të hartuara nga auditët e pavarur.

Lista e zgjedhësve u bë e aksesueshme për qytetarët përmes faqes zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe platformës qeveritare “e-Albania”. Gjithashtu, zgjedhësit patën mundësi të identifikonin qendrën e tyre të votimit edhe nëpërmjet aplikacionit zyrtar mobile të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgoi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjithsej katër (4) ekstrakte të listës së zgjedhësve në shkallë vendi. Ekstrakti përfundimtar i listës së zgjedhësve u dorëzua më datë 2 maj 2025. Në bazë të këtij ekstrakti përfundimtar, numri i zgjedhësve në rang vendi ishte 3 713 915 në total. Numri i zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ishte 3 467 962 dhe numri i qendrave të votimit ishte 5,225.

Në nivel qarku, numri i qendrave të votimit dhe numri i zgjedhësve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Qarku	Nr. i Qendrave të Votimit	Nr. i Zgjedhësve
1	Berat	275	169,606
2	Dibër	222	122,167
3	Durrës	493	351,983
4	Elbasan	508	331,859

5	Fier	587	381,524
6	Gjirokastrë	198	114,399
7	Korçë	422	266,794
8	Kukës	139	81,804
9	Lezhë	245	164,954
10	Shkodër	405	261,579
11	Tiranë	1,282	913,415
12	Vlorë	449	307,878
	Totali	5,225	3,467,962

Bazuar në përpunimin e të dhënave të listës së zgjedhësve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi vendimin për përcaktimin e sasisë së fletëve të votimit që duhet të prodhoheshin për çdo qendër votimi për zgjedhësit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, në përputhje me kriteret ligjore dhe teknike në fuqi.

Kapitulli 10

FUSHATA ZGJEDHORE

Kuadri ligjor dhe institucional

Pas shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 399, datë 05.12.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, KQZndërmori veprimet e nevojshme për organizimin dhe zbatimin e mekanizmave ligjorë të monitorimit të fushatës zgjedhore.

Në këtë kuadër, u përgatit dhe u miratua Vendimi nr. 203, datë 06.12.2024, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

Caktimi i monitoruesve dhe mbikëqyrja në terren

Pas miratimit të vendimit të sipërcituar, u caktuan gjithsej 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) monitorues për mbikëqyrjen e zhvillimit të fushatës zgjedhore në 12 (dymbëdhjetë) qarqet e vendit.

Monitoruesit e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishin detyrimin të mbikëqyrnin aktivitetet e fushatës në terren, përfshirë:

- monitorimin e mitingjeve, tubimeve dhe aktiviteteve të tjera elektorale;
- verifikimin e respektimit të ndalimeve ligjore lidhur me përdorimin e burimeve shtetërore;
- kontrollin e respektimit të afatit zyrtar të fillimit të fushatës;
- monitorimin e zbatimit të rregullave për reklamimin zgjedhor.

Monitorimi u shtri gjithashtu edhe ditën e votimit. Në rastet kur u konstatuan shkelje, si hapja e zyrave elektorale në afërsi të qendrave të votimit apo vendosja e materialeve propagandistike pranë tyre, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori vendime për mbylljen e menjëhershme të zyrave përkatëse dhe heqjen e materialeve propagandistike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe monitorimi i financimit të fushatës

Me ndryshimet e miratuara në Kodin Zgjedhor, u parashikua mundësia e vetëfinancimit nga kandidatët e partive politike ose koalicioneve zgjedhore të regjistruara si subjekte zgjedhore, deri në shumën 3 000 000 (tre milionë) lekë.

Subjektet zgjedhore janë të detyruara të hapin llogari bankare të dedikuara ekskluzivisht për fushatën zgjedhore, për pranimin e dhurimeve të fondeve jopublike me vlerë më të madhe se

50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Këto llogari deklarohen në momentin e regjistrimit të subjektit zgjedhor pranë KQZ-së.

KQZ monitoroi procesin e hapjes dhe administrimit të këtyre llogarive bankare, duke siguruar që të gjitha transaksionet financiare të jenë transparente, të dokumentuara dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Ky monitorim është realizuar nëpërmjet monitoruesve të caktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Me urdhrin nr. 51, datë 14.04.2025, u ngrit struktura e posaçme për monitorimin e fushatës zgjedhore online, e përbërë nga 4 (katër) anëtarë. Kjo strukturë kishte për detyrë monitorimin e fushatës zgjedhore në platformat e rrjeteve sociale dhe mediat digjitale, si dhe sigurimin e respektimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushatën zgjedhore online.

Mbikëqyrja e mediave dhe trajtimi i ankesave

Në kuadër të mbikëqyrjes së fushatës, u realizua monitorimi i mediave audiovizive, radios, shtypit dhe mediave online, me qëllim garantimin e respektimit të rregullave lidhur me kohën, përmbajtjen dhe mënyrën e transmetimit të reklamave zgjedhore, si dhe parandalimin e shpifjeve dhe gjuhës së urrejtjes.

Gjithashtu, KQZ pranoi dhe shqyrtoi ankesa të paraqitura nga subjektet zgjedhore, qytetarët apo organizatat monitoruese, lidhur me shkelje të rregullave të fushatës dhe të financimit të saj, duke ndjekur procedurat ligjore përkatëse.

Platforma Elektronike e Raportimit Financiar (PERF)

Platforma Elektronike e Raportimit Financiar (PERF) përbën një instrument të rëndësishëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në financimin e fushatave zgjedhore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të datës 11 maj 2025, platforma PERF është vënë në përdorim nga subjektet zgjedhore, përfshirë financierët dhe kandidatët për deputet, me qëllim plotësimin, miratimin dhe dorëzimin elektronik të raporteve financiare të fushatës.

Gjatë përdorimit të saj në fazën aktuale të procesit zgjedhor, janë evidentuar problematika teknike dhe funksionale që ndikojnë në funksionimin normal të platformës dhe krijojnë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe administrative nga përdoruesit. Këto problematika janë identifikuar përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me përdoruesit e sistemit dhe janë dokumentuar për trajtim dhe përmirësim të mëtejshëm.

Kapitulli 11

VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Portali Elektronik i Vëzhguesit – risi dhe funksionalitet

Portali Elektronik i Vëzhguesit përbën një inovacion thelbësor në procesin e akreditimit të vëzhguesve zgjedhorë, duke garantuar një nivel të lartë transparence, efikasiteti dhe koordinimi institucional. Kjo platformë digjitale mundëson regjistrimin, akreditimin dhe komunikimin në kohë reale të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe vendorë, duke eliminuar procedurat tradicionale burokratike dhe duke reduktuar ndjeshëm kohën e përpunimit të kërkesave.

Nëpërmjet portalit, vëzhguesit kanë patur akses të menjëhershëm për paraqitjen e kërkesës për akreditim dhe ngarkimin elektronik të dokumentacionit përkatës, ndërkohë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në cilësinë e autoritetit akreditues, ka mundur të analizojë, verifikojë dhe menaxhojë procesin në mënyrë të shpejtë dhe transparente.

Përmes Portalit Elektronik të Vëzhguesve u realizua akreditimi i vëzhguesve sipas kategorive të mëposhtme:

- **Vëzhgues ndërkombëtarë (të huaj):**
30 organizata / 935 vëzhgues
- **Vëzhgues vendorë (organizata të shoqërisë civile):**
47 organizata / 2,879 vëzhgues
- **Përfaqësues të misioneve diplomatike (ambasada):**
13 ambasada
- **Media kombëtare dhe të huaja:**
56 subjekte mediatike

Në total, u akredituan:

- **3,814 vëzhgues**, dhe
- **133 organizata** vëzhguese.

Vëzhguesit ndërkombëtarë sipas organizatave

Akreditimi i vëzhguesve ndërkombëtarë është realizuar sipas organizatave si më poshtë:

- **OSBE/ODIHR:**
 - 180 vëzhgues afatgjatë

- 423 vëzhgues afatshkurtër
- **Gjithsej: 603 vëzhgues**
- **Bashkimi Evropian (BE):**
 - 6 vëzhgues afatshkurtër
- **Asambleja Parlamentare e OSBE-së:**
 - 114 vëzhgues afatshkurtër
- **Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës:**
 - 107 vëzhgues afatshkurtër

Në total, u akredituan:

- **2,579 vëzhgues afatgjatë;**
- **1,235 vëzhgues afatshkurtër;**
- **3,814 vëzhgues të akredituar.**

Programi i vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve

Programi i Vëzhgimit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve u zhvillua me pjesëmarrjen e 23 trupave zgjedhore ndërkombëtare. Në kuadër të këtij programi, misionet e vëzhgimit u shoqëruan në qendrat e votimit, si gjatë periudhës parazgjedhore, ashtu edhe ditën e votimit, me qëllim vëzhgimin e drejtpërdrejtë të procesit zgjedhor.

Programi shërbeu gjithashtu si platformë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet institucioneve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor.

Përveç prezantimit të proceseve zgjedhore, identifikimit elektronik dhe votimit elektronik, delegacionet e vëzhguesve ndërkombëtarë u njohën edhe me elementë të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Kjo qasje synoi krijimin e një ambienti të hapur dhe mikpritës për vëzhguesit ndërkombëtarë, promovimin e një imazhi pozitiv të vendit dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe komunikimit në kuadër të proceseve zgjedhore.

Kapitulli 12

VOTIMI NGA JASHTË VENDIT

Kuadri nënligjor

Procesi i votimit nga jashtë vendit u zhvillua në zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe të një kuadri të plotë aktesh nënligjore të miratuara nga organet kompetente të KQZ-së. Ky kuadër nënligjor rregulloi në mënyrë të detajuar të gjitha fazat e procesit, duke përfshirë regjistrimin e zgjedhësve, administrimin e dokumentacionit zgjedhor, organizimin e strukturave të posaçme, si dhe procedurat e numërimit dhe vlerësimit të votave.

Nga këndvështrimi analitik, rëndësia e këtij kuadri qëndron në faktin se ai siguroi kalimin nga parimi ligjor në zbatim praktik, duke reduktuar hapësirat për paqartësi procedurale në një proces që zbatohet për herë të parë në shkallë kombëtare.

Regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit

Regjistrimi në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) për zgjedhësit nga jashtë vendit, u hap në 11 Janar dhe u mbyll në datën 4 Mars 2025.

Në PER dërguan kërkesë për regjistrim gjithsej 294 155 shtetas shqiptarë, nga të cilët: 245 935 shtetasve iu miratua kërkesa për të votuar nga jashtë vendit; 48 180 shtetasve iu refuzua kërkesa për të votuar për shkak të mosplotësimit të kushteve për regjistrim.

Në datën 9 Mars 2025 u publikua lista paraprake e zgjedhësve nga jashtë vendit. Për 48 orë në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor, nga data 9 deri në datën 10 Mars, zgjedhësit patën mundësinë të kërkonin saktësim/përditësim të adresës që kishin regjistruar/deklaruar në PER si dhe mundësinë për t'u tërhequr nga kjo listë në rast se për arsye objektive planifikonin të ndodheshin brenda vendit në ditën e votimit. Gjatë këtij harku kohor, gjithsej 42 shtetas kërkuan saktësim/ përmirësim dhe nga këta, 37 prej tyre iu miratua kërkesa, ndërsa 5 të tjerëve iu refuzua. Zgjedhësit nga jashtë, të cilët për arsye të përligjura kërkuan tërheqje nga kjo listë ishin 25.

Të dhënat statistikore të zgjedhësve të regjistruar sipas qarqeve, gjenden në Aneksin 1 të këtij raporti.

Të dhënat statistikore të zgjedhësve të regjistruar sipas shteteve, gjenden në Aneksin 2 të këtij raporti.

Infrastruktura dixhitale dhe zgjedhjet me shumë platforma

Për të akomoduar diasporën shqiptare të larmishme dhe të shpërndarë gjeografikisht, sistemi elektronik i regjistrimit të votuesve u projektua me një infrastrukturë dixhitale të fuqishme dhe fleksibël që mbështet portimin e kanaleve të shumta të aksesit. Kjo qasje me disa

platforma siguroi akses të gjerë dhe komoditet të përdoruesit pavarësisht nga lloji i pajisjes, lidhja ose vendndodhja.

Arkitektura e sistemit dhe integrimi me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile

PER u zhvillua në një infrastrukturë cloud të sigurt, modulare dhe të shkallëzueshme. Kjo arkitekturë siguroi shpërndarje elastike të burimeve, duke lejuar sistemin të mbështesë vëllime të larta të seancave të njëkohshme të përdoruesve - veçanërisht gjatë ditëve të pikut - pa ndërprerje të shërbimit. Teprica, shkallëzimi automatik dhe balancimi i ngarkesës së shpërndarë ishin komponentët kryesorë që kontribuan në ruajtjen e reagimit dhe disponueshmërisë.

Një tipar thelbësor i sistemit ishte integrimi i tij në kohë reale, në mënyrë të dyanshme me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC), duke përdorur protokolle të sigurta API, platforma kërkoi bazën e të dhënave të RKGjC menjëherë pasi zgjedhësi plotëson numrin e tij personal (NID) gjatë procesit të regjistrimit. Sistemi mori të dhënat zyrtare duke përfshirë emrin e plotë, datën e lindjes, vendlindjen dhe të dhëna të tjera të gjendjes civile, të cilat më pas përputheshin automatikisht me të dhënat e përdoruesit. Ky ndërveprim siguroi që:

- Vetëm qytetarët shqiptarë të kualifikuar mund të regjistroheshin.
- Informacioni i regjistruar u verifikua kundër të dhënave autoritative të shtetit.
- Gabimet manuale u reduktuan dhe dublikatat u parandaluan.

Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis sistemit të regjistrimit të votuesve dhe DPGjC u koduan duke përdorur enkriptimin TLS nga fundi në fund. Qasja në API-në e DPGjC rregullohej nga argumente të sigurta dhe lista e bardhë IP për të parandaluar lidhjet e paautorizuara. Për më tepër, pajtueshmëria me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) dhe ligjet shqiptare të privatësisë u ruajt në të gjitha fazat e trajtimit të të dhënave – si gjatë tranzitit ashtu edhe në pushim – duke zbatuar ruajtjen e koduar, regjistrat anonimë dhe gjurmët e auditimit.

Për të siguruar akses të gjerë dhe gjithëpërfshirës në sistemin e regjistrimit, u zhvilluan tre kanale dixhitale kryesore, secila e përshtatur me kujdes për të përshtatur preferencat e ndryshme të përdoruesit, llojet e pajisjeve dhe kushtet e lidhjes. Nga një këndvështrim thjesht teknik, zbatimi i një zgjidhjeje të vetme të bazuar në ueb mund të konsiderohej qasja më e drejtpërdrejtë ose konvencionale. Megjithatë, konsultimet e gjera me organizatat e shoqërisë civile, aktorët jofitimprurës dhe grupet e mbrojtjes së diasporës theksuan domosdoshmërinë e një strategjie multi-channel për të adresuar spektrin e plotë të nevojave të përdoruesve dhe për të "përfshirë të gjithë skenarët" në procesin e regjistrimit. Këto palë të interesuara mbrojtën fuqimisht zgjidhjet që nuk do të përjashtonin votuesit bazuar në kufizimet teknologjike, shkrim-leximin dixhital ose vendndodhjen gjeografike, duke theksuar se barazia dhe aksesueshmëria duhet të jenë qendrore në dizajnin e sistemit.

Në praktikë, ndërsa përdoruesit hynin në sistem përmes një aplikacioni standard në internet, një aplikacion celular vendas ose një ndërfaqe ueb të optimizuar për celular, të tre kanalet

ishin të lidhura me të njëjtën infrastrukturë backend. Kjo siguroi që, pavarësisht nga kanali i aksesit, procesi i regjistrimit mbështetej në një sistem të unifikuar për verifikimin e identitetit, vërtetimin e të dhënave dhe menaxhimin e të dhënave. Duke prezantuar sistemin përmes ndërfaqeve të ndryshme duke ruajtur një backend të përbashkët, zgjidhja arriti fleksibilitet për përdoruesin dhe qëndrueshmëri në operacionet administrative dhe teknike.

Duke përfshirë këto reagime, KQZ miratoi këtë qasje të larmishme dixhitale, e cila siguroi që qytetarët në të gjitha demografitë dhe rajonet – përfshirë ata me akses të kufizuar në pajisje me performancë të lartë ose lidhje të qëndrueshme interneti – mund të angazhoheshin në platformën e regjistrimit në mënyrë efektive. Duke i dhënë përparësi gjithëpërfshirjes, fleksibilitetit dhe konsistencës teknike, projekti jo vetëm që përmbushi objektivat e tij operacionale, por gjithashtu iu përgjigj kërkesave të shoqërisë për një dizajn user friendly, të përqendruar te përdoruesi, duke kontribuar ndjeshëm në suksesin e përgjithshëm të nismës së regjistrimit elektronik të diasporës.

Aplikacioni në internet (desktop/laptop) Aplikacioni në internet u krijua si një portal me funksione të plota, i përgjegjshëm i aksesueshëm përmes shfletuesve standardë të desktopit dhe laptopit. Ai u ofroi përdoruesve rrjedhën e plotë të punës së regjistrimit, duke përfshirë futjen e të dhënave personale, ngarkimin e dokumenteve, menaxhimin e profilit dhe proceset e vërtetimit. Pavarësisht se ofron ndërfaqen më gjithëpërfshirëse të përdoruesit, ky kanal përbënte një pjesë më të vogël të përdorimit total. Shumë përdorues të diasporës, veçanërisht ata në lëvizje ose pa qasje të rregullt në kompjuter, zgjodhën zgjidhje më portative. Si rezultat, portali i internetit desktop pa angazhim më të ulët në krahasim me opsionet celulare.

Aplikacioni celular (Android/iOS) Aplikacionet celulare vendase, të disponueshme për platformat Android dhe iOS, u krijuan për të ofruar një përvojë shumë të optimizuar në telefonat inteligjentë dhe tabletët. Aplikacionet celulare ofruan performancë më të qetë, kohë më të shpejta ngarkimi, integrim të kamerës vendase për kapjen e dokumenteve dhe selfie-ve dhe njoftime shtytëse për përditësimet e statusit ose rikujtuesit e sesionit. E rëndësishmja, këto aplikacione mbështetën aftësitë offline, duke i lejuar përdoruesit të fillojnë procesin e regjistrimit pa akses të menjëhershëm në internet dhe ta përfundojnë atë pasi të rilidhen. Midis përdoruesve celularë, aplikacioni vendas u vlerësua për besueshmërinë dhe cilësinë e ndërfaqes, veçanërisht në pajisjet më të reja.

Aplikacioni në internet celular (shfletues-bazuar në mobile) Për përdoruesit që nuk dëshirojnë ose nuk mund të instalojnë një aplikacion të dedikuar, u ofrua gjithashtu një aplikacion ueb i optimizuar për celular. I aksesueshëm përmes çdo shfletuesi smartphone, ai ofroi të gjithë funksionalitetin thelbësor të kërkuar për regjistrim të suksesshëm dhe verifikim të identitetit. Megjithëse nuk është aq i shpejtë ose i pasur me veçori sa aplikacionet vendase, ai eliminoi pengesën e instalimit dhe konsumoi më pak hapësirë ruajtëse të pajisjes, duke e bërë atë një zgjedhje popullore për përdoruesit me burime të kufizuara të pajisjes ose komoditet teknik.

Analiza statistikore e përdorimit të platformës zbuloi një preferencë të fortë ndaj regjistrimit të bazuar në celular. Gati 80% e të gjithë të regjistruarve përfunduan procesin duke përdorur

pajisje mobile, ndërsa pjesa tjetër duke përdorur sisteme desktop ose laptop. Disa faktorë kontribuan në këtë dominim:

- Transportueshmëria: Përdoruesit mund të regjistrohen në lëvizje pa pasur nevojë për një stacion pune fiks.
- Lehtësia e përdorimit: Ndërfaqet celulare ishin më të pastra dhe më të thjeshta, duke i udhëhequr përdoruesit hap pas hapi gjatë procesit.
- Nuk ka instalim (Mobile Web): Aplikacioni celular nuk kërkonte shkarkim, duke e bërë atë të shpejtë dhe tërheqës për përdorim një herë.
- Performanca e optimizuar (aplikacioni mobile): Për përdoruesit që preferonin stabilitetin dhe veçoritë e përmirësuar si njoftimet shtytëse dhe hyrjet biometrike, aplikacioni celular vendas ishte zgjedhja superiore.

Ky trend i parë i celularit pasqyron një ndryshim më të gjerë në sjelljen globale të përdoruesve dhe ishte veçanërisht e rëndësishme për angazhimin e votuesve më të rinj dhe atyre në vendet ku telefonat inteligjentë janë mjeti kryesor i aksesit dixhital.

Verifikimi i automatizuar i identitetit

Për të siguruar saktësinë dhe legjitimitetin e regjistruesve, sistemi përfshiu një proces verifikimi të automatizuar. Pas dorëzimit të aplikimit të regjistrimit, platforma u ndërlidh me RKGjC përmes një ndërfaqeje të sigurtë të programimit të aplikacioneve (API). Kjo lidhje në kohë reale mundësoi vërtetimin e menjëhershëm të numrit personal dhe të të dhënave personale të lidhura me të dhënat zyrtare të qeverisë. Ky verifikim i drejtuar nga API reduktoi ndjeshëm kohën e përpunimit manual, minimizoi gabimet dhe përmirësoi integritetin e të dhënave të regjistrimit të votuesve.

Moduli i shqyrtimit të kërkesave

Moduli i shqyrtimit të kërkesave u mundësoi zyrtarëve zgjedhorë të shqyrtonin, verifikonin dhe vërtetonin në mënyrë efikase çdo aplikim regjistrimi kundrejt kërkesave ligjore dhe teknike. Ky proces rishikimi ishte vendimtar në sigurimin e integritetit dhe përputhshmërisë së regjistrimit të votuesve të diasporës.

Siguria dhe mbrojtja e të dhënave

Siguria ishte një shqetësim kryesor në dizajnin e platformës. Të gjitha komunikimet midis pajisjeve të klientit dhe shërbimeve backend janë të koduara duke përdorur protokollin TLS standarde të industrisë. Të dhënat e përdoruesit ruhen në bazat e të dhënave të koduara me kontrolle të rrepta aksesit dhe auditime të rregullta të sigurisë.

Procesi i verifikimit të identitetit përdori vërtetimin me shumë faktorë (MFA) duke kombinuar fjalëkalimet një herë (OTP), fjalëkalimet e përdoruesve dhe njohjen biometrike të fytyrës. Kjo qasje jo vetëm që mbrojt llogaritë e përdoruesve, por gjithashtu siguroi vërtetësinë e regjistrimeve të votuesve.

Shkallëzueshmëria dhe disponueshmëria

Infrastruktura përdori shërbimet cloud të afta për shkallëzim dinamik për të trajtuar periudhat e pikut të regjistrimit pa degradim të shërbimit. Mekanizmat e balancimit të ngarkesës dhe dështimit u zbatuan për të siguruar disponueshmëri të lartë dhe tolerancë ndaj defekteve.

Mbështetja dhe aksesueshmëria e përdoruesit

Për të përmirësuar më tej përdorshmërinë, platforma përfshiu mbështetje shumëgjuhëshe, ndërfaqe intuitive të përdoruesit dhe veçori aksesueshmërie në përputhje me udhëzimet WCAG 2.1. Për më tepër, një helpdesk i dedikuar dhe burime FAQ u vunë në dispozicion për të ndihmuar përdoruesit gjatë gjithë procesit të regjistrimit.

Përdorimi i platformës

Analiza e të dhënave të aksesit në platformë zbulon preferenca të ndryshme të përdoruesve në lidhje me kanalet e regjistrimit. Aplikacioni në internet ishte platforma më e përdorur, e preferuar nga përdoruesit me akses të qëndrueshëm në internet dhe pajisje desktop ose laptop. Aplikacioni celular pa adoptim të lartë në mesin e votuesve më të rinj dhe atyre me smartphone, ndërsa aplikacioni mobile u shërbeu përdoruesve që preferonin të mos instalonin softuer të dedikuar ose kishin hapësirë të kufizuar të pajisjes.

Metrikat e angazhimit të përdoruesve, të tilla si kohëzgjatja e sesionit dhe normat e plotësimit të formularit, treguan një përvojë përgjithësisht të qetë dhe miqësore për përdoruesit në të gjitha platformat. Për më tepër, zbatimi i vërtetimit me shumë faktorë nuk duket se pengon regjistrimin, duke sugjeruar një ekuilibër efektiv midis sigurisë dhe përdorueshmërisë.

Sistemi pati aktivitetin maksimal të regjistrimit gjatë fundjavave, me afërsisht 8 000 deri në 9 000 votues që përpiqeshin të regjistroheshin të shtunave dhe të dielave. Ky model sugjeron që shumë votues të diasporës preferuan të angazhoheshin në procesin e regjistrimit jashtë orarit tipik të punës, duke theksuar rëndësinë e një platforme dixhitale të aksesueshme 24/7.

Pas dorëzimit, çdo aplikim regjistrimi iu nënshtrua një shqyrtimi të plotë nga KQZ. Një ekip i përkushtuar prej rreth 30 anëtarësh të stafit vlerësoi aplikimet përmes një portali të specializuar administrativ. Të gjitha dokumentet mbështetëse të siguruar nga votuesit, të tilla si ID-të kombëtare dhe dëshmia e adresës jashtë vendit, u shqyrtuan me kujdes.

Sistemi automatizoi pjesët kryesore të procesit të verifikimit: ai ndërlidhej me bazën e të dhënave kombëtare përmes API për të nxjerrë dhe verifikuar detajet e identitetit direkt nga të dhënat zyrtare. Për më tepër, teknologjia optike e njohjes së karaktereve (OCR) u përdor për të kapur të dhëna përkatëse nga imazhet e dokumenteve të identitetit të dorëzuara nga votuesit. Për të siguruar integritetin e vazhdueshëm të identitetit, njohja biometrike e fytyrës u përdor jo vetëm në regjistrim, por edhe gjatë hyrjes, duke përputhur të dhënat biometrike të përdoruesit me imazhin fillestar të profilit.

KQZ u angazhua për të përpunuar çdo aplikim brenda një maksimumi prej pesë ditësh. Në praktikë, koha e përpunimit ishte më e shkurtër, me shumë pak raste që kalonin tre ditë, duke demonstruar efikasitetin dhe reagimin e ekipit të rishikimit.

Nëse një aplikim refuzohej për shkak të informacionit jo të plotë ose të pasaktë, votuesit lejoheshin të riaplikonin ose përditësonin paraqitjet e tyre. Kjo qasje përsëritëse rriti regjistrimet e suksesshme dhe ndihmoi në sigurimin që gabimet e vogla të mos rezultonin në heqje të të drejtës.

Një aplikim do të refuzohej nga ekipi shqyrtues nëse nuk përputhet me listën e dokumenteve të miratuara nga Komisioni Rregullator.

Shërbimet e ndihmës së përdoruesve

Për të ndihmuar zgjedhësit nga jashtë gjatë gjithë procesit të regjistrimit, një ekip i dedikuar mbështetës prej 10 anëtarësh të stafit u vu në dispozicion përmes telefonit, emailit dhe mesazheve me tekst. Detyra e tyre ishte t'u përgjigjeshin pyetjeve të përdoruesve, të jepnin udhëzime dhe të zgjidhnin çështjet teknike. Duke plotësuar këtë mbështetje njerëzore, një chatbot u integrua në platformën e regjistrimit, duke ofruar ndihmë të automatizuar për pyetjet e zakonshme dhe duke ndihmuar përdoruesit të lundrojnë në hapat e regjistrimit në mënyrë efikase.

Arsyet më të zakonshme pse votuesit kërkonin ndihmë përfshinin:

- Kushtet e dobëta të ndriçimit gjatë marrjes së fotografisë selfie të kërkuar për verifikimin biometrik ose krijimin e profilit, të cilat shpesh ndikuan në cilësinë e imazhit dhe saktësinë e njohjes.
- Përdorimi i telefonave inteligjentë ose pajisjeve më të vjetra me cilësi të kufizuar të kamerës ose fuqi përpunuese, duke çuar në vështirësi teknike gjatë regjistrimit.
- Përpjekje të shumta të gabuara të hyrjes ose verifikimit brenda një periudhe të shkurtër, të cilat shkaktuan ngrirje të përkohshme të sesioneve për t'u mbrojtur nga aktiviteti mashtrues.
- Vonesa të zgjata ose pasiviteti midis hapave të regjistrimit, ndonjëherë duke shkaktuar kohëzgjatje të sesionit ose humbje të të dhënave.
- Lidhja e ndërprerë ose e dobët e internetit, veçanërisht në vendet e largëta ose rurale të diasporës, duke ndikuar në stabilitetin e procesit të regjistrimit.
- Vështirësi në përmbushjen e kriterëve të kompleksitetit të fjalëkalimit, gjë që çoi në gabime të përsëritura në formular dhe vonesa regjistrimi.
- Ky reagim ishte i paçmuar në rafinimin e materialeve udhëzuese të përdoruesit dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së platformës për të akomoduar një gamë të gjerë mjedisesh përdoruesish dhe aftësish teknike.

Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor për votuesit nga jashtë

Sasia e fletëve të votimit të prodhura për secilin prej qarqeve u miratua me Vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr.313, datë 24.03.2025 “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qark për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”. Këto fletë u vulosën me vulën e qarkut përkatës.

Flete të prodhuara sipas vendimit nr.313, datë 24.03.2025 të KSHZ. (Shih aneksin 3 të këtij raporti)

Seti i dokumentacionit zgjedhor që iu dërgua çdo zgjedhësi përmbante: fletën e votimit, Zarin A, Zarin B (i cili përmbante një QR code dhe kishte të dhënat e qarkut dhe shtetit), numërorin e DHL, udhëzuesin që shpjegonte procedurën e votimit dhe zarfin e kthimit të DHL. I gjithë ky set u vendos në zarfin e DHL të dërgimit të këtij materiali, nga KQZ tek secili zgjedhës. Më poshtë gjeni të ilustruar në foto përmbajtjen.



Figura: Pamje nga Parku Olimpik gjatë përgatitjes së dokumentacionit zgjedhor

Zarfet e parë me dokumentacionin zgjedhor të përgatitur nga KQZ janë nisur në datë 14.04.2024 nëpërmjet shërbimit postar DHL. Zarfet do t'i dorëzoheshin zgjedhësve në adresën e deklaruar prej tyre në PER.

Zarfet e parë me dokumentacionin zgjedhor të dërguar nga zgjedhësit jashtë vendit, mbërritën në Parkun Olimpik të Tiranës "Feti Borova" në datë 17.04.2025, ku grupi i parë i zarfeve të administruara nga komisioni i pranimit ishte 735.

Çdo ditë në ambientet e Parkut Olimpik të Tiranës "Feti Borova" administrohej dokumentacioni zgjedhor i dërguar nga zgjedhësi jashtë vendit. Komisioni i pranimit administronte dokumentacionin sipas procesverbaleve përkatëse, shkëpuste zarfin "B" nga zarfi i shërbimit postar, më pas skanonte QR kodin dhe e vendoste dokumentacionin zgjedhor në kutinë e votimit nga jashtë, e cila për nga funksionaliteti është e ngjashme me kutinë e votimit nga brenda vendit e mbyllur me kode me vula sigurie. Dokumentacioni zgjedhor i cili nuk u dërgua nga zgjedhësit në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.13, datë 12.11.2024 të Komisionit Rregullator, u regjistrua në një regjistrë të posaçëm, futej në një zarf plastik dhe vendosej në Kutinë e Posaçme të votimit nga jashtë.

Sasia e zarfeve të dërguara nga KQZ sipas qarqeve: (shiko Aneks 4)

Sasia e zarfeve të mbërritura në KQZ sipas qarqeve: (shiko Aneks 5)

Të pranishëm gjatë fazës së përgatitjes, dërgimit dhe mbërritjes së dokumentacionit zgjedhor kanë qenë mbikëqyrës subjektet zgjedhore "Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore" dhe Partia Socialiste e Shqipërisë. Gjatë fazës së administrimit, vlerësimit dhe numërimit të dokumentacionit zgjedhor kanë qenë në rolin e vëzhguesve të akredituar të 11 subjektet zgjedhore.

Çdo punonjës i atashuar në procesin e votimit nga jashtë ka nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti. I gjithë procesi i votimit nga jashtë është monitoruar me kamera 24/7. Pamjet e tyre kanë qenë live-streaming në web 24/7 orë/ditë.

Vlerësimi dhe numërimi i dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësve nga jashtë vendit

Me Vendimin nr.406, datë 04.04.2025 janë caktuar Komisionet e Administrimit, Numërimit dhe Vlerësimit të Votave nga Jashtë (KANVVJ) dhe Grupet e Numërimit të Votave nga Jashtë (GNVJ), të cilat në total ishin: 37 grupe numërimi dhe 37 grupe numërimi rezervë, me 2 anëtarë, përfaqësues nga subjektet zgjedhore “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” dhe Partia Socialiste e Shqipërisë. KANVVJ në total ishin 7 komisione me 5 anëtarë. Puna e KANVVJ dhe GNVJ nisi më datë 11.05.2025, ku numërimi nisi njëkohësisht me numërimin brenda vendit sipas zonave zgjedhore përkatëse. Konkretisht qarku i parë që nisi numërimin ishte Korça, numërimi zgjati 8 ditë dhe ishte pikërisht po qarku Korçë, i cili mbylli procesin e vlerësimit dhe numërimit të dokumentacionit zgjedhor.

Në total KANVVJ dhe GNVJ administruan, vlerësojnë dhe numërojnë 945 uti Votimi ‘A’/të rregullta’ dhe 14 Kutitë Votimi të Posaçme (1 për çdo qark dhe 2 për Tiranën).

Burimet njerëzore të angazhuara në votimin nga jashtë

Gjatë fazës së regjistrimit për trajtimin e kërkesave në PER u angazhuan 42 persona (staf KQZ). Për përgatitjen e dokumentacionit zgjedhor në fazën e vulosjes së fletëve të votimit dhe përgatitja e setit në zarfin A dhe B u angazhuan 54 persona (staf KQZ).

Në fazën e përgatitjes së dërgesave u angazhuan 340 persona (staf KQZ + DHL) ndërsa në fazën e pritjes së zarfeve me fletë votimi u angazhuan 50 persona.

Për procesin e administrimit, vlerësimit dhe numërimit të votave nga jashtë u angazhuan 200 persona (KANVVJ + GNVJ + KQZ).

Për të gjitha fazat e votimit nga jashtë janë angazhuar gjithsej 680 persona. Puna në ambientet e Parkut Olimpik të Tiranës “Feti Borova” u organizua me turne.

Fushata e edukimit për votimin nga jashtë

Në zbatim të programit për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve jashtë vendit për zgjedhjet për Kuvendin 2025 u përcaktuan objektivat dhe hapat konkrete që u ndërmorrën për realizimin e procesit të votimit nga jashtë.

Fushata “Regjistrohu në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER)” për votuesit nga jashtë

Qëllimi:

Informimi i zgjedhësve me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbi procedurat e regjistrimit në PER dhe mënyrat e pjesëmarrjes në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

Periudha e regjistrimit në PER: 11 janar – 4 mars 2025.

Mjetet:

- Spot televiziv (40 sekonda), i transmetuar në 22 televizione dhe në 2 platformat dixhitale më të ndjekura nga shqiptarët në botë;
- Video dhe baner në 28 Ledwall në pikat kufitare dhe nyjet kryesore (Rinas, porti i Durrësit, Pogradec, Gjirokastër);
- Reklama të ndriçuara (City Lights) në aeroport dhe porte, me informacion mbi regjistrimin në PER;
- Fletëpalosje të shpërndara në të gjitha pikat kufitare;
- Fushatë intensive në media sociale (Facebook, Instagram dhe Google Ads), me miliona klikime dhe shtrirje të gjerë në vendet ku ka përqendrim të lartë të diasporës (Itali, Greqi, Gjermani, SHBA, Mbretëri e Bashkuar);
- Banera dhe POP-UP në 12 faqe web të televizioneve më të ndjekura nga diaspora;
- Konferenca për shtyp me apel dhe udhëzim për votuesit nga jashtë;
- Takime me përfaqësues të organizatave të diasporës;
- Përdorimi i Platformës Elektronike të Regjistrimit si qendër informacioni për pjesëmarrjen nga jashtë vendit.

Dërgimi dhe plotësimi i fletës së votimit për votuesit nga jashtë**Qëllimi:**

Informimi i zgjedhësve nga jashtë vendit mbi dërgimin e zarfit të votimit, procedurat e plotësimit të fletës së votimit dhe kthimin e saj tek KQZ.

Mjetet:

- Spot televiziv (1 minutë e 42 sekonda) mbi dërgimin dhe kthimin e zarfit të votimit, i transmetuar 8 000 herë, përfshirë në dy platformat Tring dhe Digitalb të dedikuara për diasporën;
- Video dhe postera në rrjetet sociale me të gjithë hapat e procesit;
- Banera dhe mesazhe në faqet web të televizioneve për mënyrën e saktë të plotësimit dhe kthimit të zarfit në KQZ.

Në tërësi, për fushatën e edukimit për votimin nga jashtë vendit, u prodhuan dhe u shpërndanë këto materiale informuese/promovuese:

- 2 spote televizive të transmetuara në televizionet kombëtare dhe në platformat televizive Tring dhe Digitalb, një për fazën e regjistrimit dhe tjetra për procedurën e votimit.
- 2 video tutorial të publikuara në kanalet zyrtare të KQZ në rrjete sociale, një për fazën e regjistrimit dhe tjetra për procedurën e votimit.
- 20 mijë leaflets me informacion mbi procedurën regjistrimit në PER, të cilat në bashkëpunim me Policinë e Shtetit u shpërndanë në Pikat e Kalimit Kufitar.

- 255 mijë udhëzues me informacion mbi procedurën e votimit nga jashtë, të cilat ishin pjesë e dokumentacionit zgjedhor që iu dërgua zgjedhësve nga jashtë vendit.
- 255 mijë numratorë me numrat e kontaktit të shërbimit postar të DHL në 85 shtete të cilat ishin pjesë e setit që iu dërgua zgjedhësve nga jashtë vendit.
- U vendosën billboard në dy faza. Në fazën e regjistrimit dhe në fazën e procesit të votimit. Billboardet u vendosën në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, në portin e Durrësit, në portin e Vlorës, në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës, në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës, në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit dhe në pikën e kalimit kufitar në Murriqan, në pikën e kalimit kufitar në Qafë - Thanë.

Vendet ku fushata edukuese për procesin e votimit nga jashtë vendit pati shikueshmërinë më të madhe ishin:

- Itali
- Greqi
- Gjermani
- Shtetet e Bashkura të Amerikes
- Mbretëri e Bashkuar

Këto shtete përbënë 80% të totalit të klikimeve të fushatës edukuese/informuese. Pasditja ishte koha kur shikueshmëria dhe klikimet ishin më të mëdha.

- Në Facebook dhe Instagram (META) pati 7,176,000 klikime e cila përkthehet në rreth 1.596,400 përdorues unikë.
- Google Ads: 9,596,000 klikime.

Reflektime

Votimi nga jashtë si zhvillim strukturor i administrimit zgjedhor

Zbatimi i votimit nga jashtë vendit në zgjedhjet e 11 majit 2025 përfaqësoi një zhvillim strukturor në arkitekturën e administrimit zgjedhor. Ky mekanizëm nuk shtoi thjesht një kategori të re votuesish, por zgjeroi fushën e përgjegjësisë së administratës zgjedhore përtej kufijve territorialë të vendit.

Nga një perspektivë institucionale, ky zgjerim kërkoi rikonceptim të proceseve ekzistuese, pasi administrimi i votës nga jashtë përfshiu faktorë të rinj si: shtrirja ndërkombëtare, koordinimi me shërbimet postare, menaxhimi i afateve të zgjatura dhe garantimi i sigurisë në një zinxhir administrimi më kompleks.

Regjistrimi paraprak si mekanizëm garantues i integritetit

Regjistrimi paraprak i zgjedhësve nga jashtë, i realizuar përmes PER, ishte një element kyç për integritetin e procesit. Analiza e kësaj faze tregoi se regjistrimi nuk ka pasur vetëm funksion organizativ, por edhe rol kontrollues, duke garantuar që vetëm zgjedhësit që plotësonin kriteret ligjore të përfshiheshin në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë.

Nga pikëpamja analitike, regjistrimi paraprak kontribuoi në:

- rritjen e saktësisë së listës së zgjedhësve;
- reduktimin e riskut të pasaktësive administrative;
- forcimin e përgjegjësisë individuale të zgjedhësit në ushtrimin e të drejtës së votës.

Dimensionimi logjistik dhe ndikimi i tij në barazinë e votës

Logjistika postare ishte një nga aspektet më të ndjeshme të votimit nga jashtë. Vendimi për të mbuluar kostot postare nga shteti pati një rëndësi të veçantë, pasi eliminoi barrierat financiare që do të mund të çënonin barazinë reale të ushtrimit të së drejtës së votës.

Gjithashtu, përdorimi i dokumentacionit të standardizuar dhe elementëve të gjurmueshmërisë administrative përforcoi kontrollin institucional mbi procesin, duke ruajtur njëkohësisht ndarjen ndërmjet identifikimit administrativ dhe sekretit të votës.

Centralizimi i administrimit dhe kontrolli procedural

Zgjedhja për administrimin e centralizuar të votave nga jashtë vendit përbën një vendimarrje strategjike që synoi standardizimin e praktikave dhe rritjen e kontrollit procedural. Ky model lehtëson monitorimin, krijon kushte për transparencë të shtuar dhe redukton fragmentimin e proceseve.

Nga këndvështrimi analitik, centralizimi krijon avantazhe të qarta organizative, por njëkohësisht kërkon kapacitete të larta menaxheriale dhe teknike, si dhe planifikim të detajuar të burimeve njerëzore.

Integrimi i numërimit në procesin kombëtar

Integrimi i numërimit të votave nga jashtë në procesin e përgjithshëm të numërimit, por me struktura të posaçme, përfaqëson një kompromis institucional ndërmjet unitetit të procesit zgjedhor dhe nevojës për trajtim të diferencuar të votave të diasporës.

Ky integrim shmang krijimin e një procesi paralel dhe kontribuon në ruajtjen e besueshmërisë së rezultatit zgjedhor, duke siguruar që votat nga jashtë të trajtohen si pjesë integrale e vullnetit elektoral.

Transparenca dhe besimi publik

Procesi i votimit nga jashtë vendit u shoqërua me ndjeshmëri të shtuar publike për shkak të distancës fizike ndërmjet zgjedhësit dhe administratës zgjedhore. Masat e transparencës, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm dhe transmetimin live, luajtën një rol thelbësor në ndërtimin dhe ruajtjen e besimit publik.

Nga pikëpamja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, transparenca nuk është vetëm element informues, por mekanizëm parandalues ndaj dyshimeve dhe perceptimeve negative mbi integritetin e procesit.

Burimet njerëzore si faktor kritik suksesi (ose jo)

Angazhimi i një numri të konsiderueshëm burimesh njerëzore në të gjitha fazat e procesit tregoi se votimi nga jashtë është një komponent që kërkon kapacitete të dedikuara dhe koordinim të lartë ndërmjet strukturave të ndryshme.

Kjo përvojë nënvizon nevojën për institucionalizimin e njohurive dhe praktikave të fituara, në mënyrë që procesi të mos varet nga zgjidhje ad hoc në zgjedhjet e ardhshme.

Mësime institucionale dhe implikime për të ardhmen

Analiza e procesit të votimit nga jashtë në zgjedhjet e 11 majit 2025 nxori në pah disa implikime kyçe:

- domosdoshmërinë e planifikimit më të hershëm dhe më të detajuar;
- nevojën për konsolidimin e kuadrit nënligjor mbi bazën e praktikës së krijuar;
- rëndësinë e forcimit të mekanizmave të mbështetjes/ndihmës për zgjedhësit;
- vlerën e standardizimit dhe dokumentimit të plotë të procedurave.

Procesi i votimit nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 përfaqësoi një zhvillim të rëndësishëm institucional që zgjeroi përmbajtjen praktike të së drejtës së votës dhe forcon lidhjen ndërmjet shtetit dhe diasporës shqiptare. Përvoja e fituar tregon se mekanizmi është funksional, por kërkon konsolidim të mëtejshëm për të garantuar qëndrueshmëri dhe standardizim në proceset zgjedhore të ardhshme.

KREU II

DITA E ZGJEDHJEVE

Kapitulli 1

HAPJA E VOTIMIT

Hapja e qendrave të votimit u zhvillua përgjithësisht në mënyrë të rregullt dhe pa probleme sistemike. 96% e QV-ve u hapën në orarin ligjor 07:00–07:30, duke garantuar nisjen në kohë të procesit të votimit në pjesën dërrmuese të territorit.

Vetëm 4% e QV-ve patën hapje me vonesë, deri rreth orës 09:30, kryesisht për arsye logjistike ose për shkak të përbërjes së paplotë të komisioneve në momentin e hapjes. Në 3 QV, në zonat Dropull dhe Finiq, baza materiale u tërhoq në orën 09:00 të ditës së zgjedhjeve, duke sjellë vonesa të përkohshme, të cilat u adresuan nga KZAZ-të përkatëse.

Sa i përket përbërjes së komisioneve:

- 70% e KQV-ve funksionuan me përbërje të plotë prej 7 anëtarësh;
- vetëm në 2 raste procesi u zhvillua pa praninë e vëzhguesve politikë.

Në orët e para të mëngjesit u evidentuan denoncime për prani të shtuar të kandidatëve dhe mbështetësve të tyre në ambientet e QV-ve, situatë e cila u adresua nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përmes njoftimeve dhe ndërhyrjeve institucionale.

Kapitulli 2

ZHVILLIMI I VOTIMIT

Gjatë zhvillimit të votimit, dita rezultoi përgjithësisht e qetë, pa ndërprerje të zgjata të procesit dhe pa incidente që cenojnë integritetin e votimit.

Nga raportimet operative:

- 3% e QV-ve raportuan situata problematike, kryesisht tensione ose tentativa për ndërhyrje;
- në 14 QV u evidentuan përpjekje për ndikim te votuesit;
- në 26 QV pati ndërprerje të përkohshme të votimit për arsye teknike ose logjistike;

Të gjitha këto raste u trajtuan në kohë nga KZAZ-të, Policia e Shtetit dhe Qendra e Monitorimit, pa prekur vijueshmërinë dhe integritetin e procesit zgjedhor.

Fshehtësia e votës u respektua në 99% të QV-ve. Vetëm në 9 raste u përdor kutia rezervë e votimit, për shkak të mbushjes së parakohshme të kutisë kryesore.

Në lidhje me votimin e asistuar për zgjedhësit me aftësi të kufizuara (PAK):

- 88% e QV-ve respektuan protokollin përkatës,
- 12% shfaqën mangësi në zbatim, duke reflektuar problematika të identifikuara edhe gjatë fazës së trajnimeve.

Sa i përket fluksit të votuesve:

- 70% e QV-ve patën fluks mesatar,
- 24% fluks të ulët,
- vetëm 6% fluks të lartë.

Të dhënat në format elektronik, mbi pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, aksesohet në format elektronik, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



Në kuadër të garantimit të transparencës, reagimit të shpejtë dhe mbikëqyrjes efektive të procesit zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ngriti Strukturën e Monitorimit të Zgjedhjeve dhe Mbikëqyrjes së Veprimtarisë së Administratës Zgjedhore (këtu e në vijim, Qendra e Monitorimit).

Kjo strukturë u konceptua si mekanizëm qendror koordinimi, për trajtimin në kohë reale të çdo sinjalizimi, incidenti apo problematike para, gjatë ditës së votimit dhe fazave pasuese.

Në përbërje të Qendrës së Monitorimit u përfshinë:

- Struktura të administratës së KQZ-së,
- Oficerë të Policisë Gjyqësore (OPGJ) të Prokurorisë së Përgjithshme,
- Përfaqësues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), të atashuar dhe në koordinim me prokuroritë e juridiksionit përkatës, duke garantuar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet administrimit zgjedhor dhe ndjekjes penale kur ishte e nevojshme.

Për lehtësimin e komunikimit dhe raportimit të problematikave nga administrata zgjedhore dhe publiku, KQZ vuri në dispozicion edhe numrin pa pagesë 199, i cili shërbeu si kanal i dedikuar raportimi gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve.

Gjatë ditës së zgjedhjeve, Qendra e Monitorimit trajtoi gjithsej 26 denoncime, dhe rreth 358 informacione telefonike, të cilat u administruan, analizuan dhe adresuan në kohë.

Shpërndarja e denoncimeve sipas kategorive ishte si më poshtë:

- Grumbullim në Qendrat e Votimit: 13 raste (kategoria dominuese, rreth 52% e totalit);
- Zgjedhës (sjellje apo situata problematike): 4 raste;
- Administrata zgjedhore: 3 raste (gabime operacionale ose sjellje e papërshtatshme);
- Të tjera 5 raste

Nga totali i denoncimeve:

- 5 raste u përcollën për ndjekje penale pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, në koordinim me OPGJ të Prokurorisë së Përgjithshme dhe BKH;
- të gjitha rastet e tjera u adresuan në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe KZAZ-të përkatëse, përmes masave administrative dhe ndërhyrjeve të menjëhershme në terren.

Si rezultat i ndërhyrjeve të Qendrës së Monitorimit:

- në KZAZ nr. 27 dhe nr. 41 u mor vendimi për revokimin e akreditimit të vëzhguesve, për shkak të sjelljeve që cenonin procesin zgjedhor;
- u garantua reagim i shpejtë ndaj situatave të grumbullimit, presionit apo ndërhyrjeve në Qendrat e Votimit.

Funksionimi i kësaj strukture konfirmon nevojën për vazhdimësi dhe forcim të këtij mekanizmi në proceset e ardhshme zgjedhore, si element kyç për garantimin e integritetit dhe besueshmërisë së zgjedhjeve.

Këto të dhëna tregojnë se problematika e mjedisit përreth QV-ve mbetet një nga sfidat kryesore të procesit zgjedhor.

Kapitulli 3

MBYLLJA E VOTIMIT

Mbyllja e procesit të votimit në të gjitha qendrat e votimit u krye në orën **19:00**, duke respektuar procedurat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Në shumicën dërrmuese të QV-ve, dokumentacioni u përgatit në mënyrë korrekte dhe materialet zgjedhore u dorëzuan në KZAZ brenda afateve ligjore.

Megjithatë, u evidentuan disa problematika:

- 7 kuti votimi dhe 1 kuti materiale zgjedhore u konstatuan si të parregullta;
- në rreth 20% të QV-ve, fletët e votimit të papërdorura u administruan jashtë kutisë së materialeve zgjedhore;
- në dy raste, GNV-të deklaruan të parregullta kuti që ishin marrë në dorëzim si të rregullta, kryesisht në Përrenjas dhe Durrës, të cilat u hapën me urdhër të Komisionerit në KQZ.

Procesi i numërimit në GNV u zhvillua në tërësi i pandërprerë dhe brenda standardeve, por evidentoi sfida të njohura:

- mospërputhje në procedurat e hapjes së kutive,
- ndryshime në ritmin e punës mes GNV-ve,
- ndikim të pranishëm të vëzhguesve politikë në fluiditetin e procesit.

Për shkak të rolit të vëzhguesve janë evidentuar edhe situata të tensionuara fgjatë procesit të numërimit. U evidentuan gjithashtu:

- revokime akreditimi të vëzhguesve në KZAZ nr. 27, 41, 30, 31, 36 dhe 43 për cënim të procesit;
- rreziqe të lidhura me ndikimin e kandidatëve në caktimin e numëruesve, zëvendësime në kundërshtim me kriteret ligjore, si dhe mbipopullim të VNV-ve dhe mungesë kontrolli të plotë mbi prezencën e objekteve të ndaluara.

Megjithatë, pavarësisht këtyre problematikave, procesi i numërimit u përmbyll pa incidente që cenojnë integritetin e rezultatit zgjedhor, duke mbyllur ciklin zgjedhor në mënyrë të rregullt.

Kreu III

NXJERRJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR

Kapitulli 1

GRUPET E NUMËRIMIT

Përbërja dhe funksionimi i GNV

Në fazën e numërimit, u ngritën 449 tavolina numërimi, me 3 592 pozicione të parashikuara për anëtarë GNV, ndërkohë që u emëruan rreth 3 357 anëtarë, që përfaqëson 93% të pozicioneve plan në total.

Megjithatë, u evidentuan problematika të përsëritura lidhur me paplotësinë e grupeve të dyta të numërimit, duke krijuar ngarkesë të shtuar për grupet e para dhe duke ndikuar në ritmin dhe qëndrueshmërinë e procesit. Në total u emëruan 1 796 numërues për grupet e para, ndërkohë që mungesat në grupet e dyta u reflektuan në performancën e përgjithshme të numërimit.

Kuota gjinore në KQV dhe GNV

Përfaqësimi gjinor në KQV dhe GNV ka mbetur problematik. Nga përbërja totale, rreth 19% janë gra dhe 81% burra. Këto të dhëna tregojnë se kuota gjinore nuk është respektuar në mënyrë të kënaqshme, duke reflektuar një trend të përsëritur ndër procese zgjedhore dhe nevojën për masa më efektive dhe detyruese gjatë fazës së propozimeve nga subjektet politike.

Kapitulli 2

NUMËRIMI, VLERËSIMI I VOTAVE DHE TABULIMI I REZULTATIT

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe numërimit, KSHZ miratoi rezultatin e votimit për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e tabelave përmbledhëse të rezultateve të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe tabelave të rezultatit të Qendrave të Votimit të plotësuara nga Grupet e Numërimit.

Të gjitha vendimet e KSHZ për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet u ankimuan në KAS. Në përfundim të shqyrtimeve në KAS, ky i fundit për kundërshtimin e 8 vendimeve për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, si dhe për kandidatët për deputetë, për zonën zgjedhore Kukës, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Shkodër dhe Elbasan vendosi rrëzimin e kërkesave ankimore dhe lënien në fuqi të vendimeve të KSHZ.

Për kundërshtimin e 4 (katër) vendimeve për Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, si dhe për kandidatët për deputetë, për zonat zgjedhore Tiranë, Durrës, Fier dhe Dibër KAS vendosi të rrëzojë kërkesat ankimore për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të zhvilluara në datën 11.05.2025 në këto zona dhe të ndryshojë vendimin e KSHZ për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultatit të votimit në zonat zgjedhore Qarku Tiranë, Durrës, Fier dhe Dibër.

Të gjithë vendimet e sipërsënuara të marrë nga KAS, lidhur me kundërshtimin e miratimit të tabelave përmbledhëse, u ankimuan pranë Kolegjit Zgjedhor i cili pas përfundimit të shqyrtimit, ka vendosur të rrëzojë ankimet e kryera.

Në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor, KSHZ, në zbatim të neneve 162 dhe 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, përlllogariti shpërndarjen e mandateve të subjekteve zgjedhore, në çdo zonë zgjedhore. Dy nga vendimet për shpërndarjen e mandateve u ankimuan në KAS dhe më pas në Kolegjin Zgjedhor.

Konkretisht u ankimua vendimi nr. 1360 datë 28.7.2025 " Për caktimin e kandidatëve fitues të subjektit zgjedhor Koalicionit PD-AMSH në zonën zgjedhore Qarku Durrës, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025", dhe KAS në përfundim të shqyrtimit nëpërmjet vendimit nr. 107, datë 30.07.2025 vendosi rrëzimin e kërkesës ankimore dhe lënien në fuqi të vendimit të KSHZ. Vendimi i KAS u ankimua në Kolegjin Zgjedhor i cili pas shqyrtimit, nëpërmjet vendimit nr. 28, datë 19.8.2025 vendosi pushimin e gjykimit të çështjes.

U ankimua vendimi nr. 1354 datë 23.7.2025 “Për caktimin e kandidatëve fitues të Koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet”, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, dhe KAS në përfundim të shqyrtimit nëpërmjet vendimit nr. 106 të datës 30.07.2025 vendosi pranimin e pjesës së kërkesës ankimore dhe ndryshimin e vendimit të KSHZ. Vendimi i KAS u ankimua në Kolegjin Zgjedhor i cili në përfundim të shqyrtimit, nëpërmjet vendimit nr. 29 datë 25.08.2025 vendosi rrëzimin e kërkesës padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të KAS.

Kapitulli 3

ANKIMET ZGJEDHORE

ANKIMET PARAZGJEDHORE

Administrimi i denoncimeve

Pas dekretimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të detyrimeve ligjore, ka vijuar monitorimin periodik të Portalit të Denoncimeve dhe Ankimeve, si dhe të adresës zyrtare elektronike, për trajtimin e çdo denoncimi apo ankimi të depozituar në lidhje me zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025.

Strukturat përgjegjëse pranë KQZ-së kanë administruar çdo denoncim dhe ankim të paraqitur, duke ndjekur procedurat përkatëse administrative, si dhe kanë përfaqësuar institucionin në proceset gjyqësore të zhvilluara pranë Kolegjit Zgjedhor.

Në këtë kuadër, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë depozituar gjithsej 199 denoncime, që lidhen me 456 subjekte, për shkelje të pretenduara të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe në vendimin nr. 9, datë 29.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Pas verifikimit paraprak të denoncimeve, KSHZ ka vendosur:

- Mosfillimin e procedurës administrative për 44 denoncime, për shkak se informacioni i paraqitur nuk krijonte bazë të mjaftueshme për hetim administrativ;
- Fillimin e procedurës administrative për 155 denoncime.

Denoncuesit

Denoncimet për të cilat është filluar procedura administrative janë paraqitur nga subjektet e mëposhtme:

- 128 denoncime nga Koalicioni *PD-ASHM*;
- 8 denoncime nga sinjalizues;
- 6 denoncime nga individë;
- 2 denoncime nga Struktura e Posaçme e Monitorimit;
- 1 denoncim nga institucion shtetëror;
- 54 denoncime nga organizata jofitimprurëse, konkretisht:
 - 14 nga Qendra “Qëndresa Qytetare”;
 - 28 nga KRIIK;
 - 1 nga Instituti i Studimeve Politike;
 - 10 nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit;
 - 1 nga organizata “Drejtësi Sociale”.

Objekti i denoncimeve

Denoncimet e administruara janë kategorizuar sipas objektit të tyre, duke përfshirë, ndër të tjera, përdorimin e aseteve dhe burimeve publike, miratimin e akteve nënligjore, veprimtaritë e ndaluara gjatë fushatës zgjedhore, përdorimin e burimeve njerëzore, asfaltin elektorale, korrupsionin aktiv dhe pasiv, përdorimin e të miturve në fushatë, afishimin e materialeve propagandistike, hapjen e zyrave elektorale, zhvillimin e tubimeve elektorale, si dhe shfrytëzimin e imazhit të fëmijëve për përfitim politik.

Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Për 155 denoncimet për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur si më poshtë:

- 144 denoncime – pushim i hetimit administrativ;
- 1 denoncim – përfundim i hetimit administrativ;
- 1 denoncim – rekomandim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
- 3 denoncime – propozim drejtuar KAS për vendosje mase administrative me gjobë;
- 2 denoncime – urdhërim i Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëhershme të materialeve propagandistike;
- 3 denoncime – tërheqje vëmendjeje për kryetarë bashkish;
- 1 denoncim – urdhërim i Policisë Bashkiake Tiranë dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e menjëhershme të një zyre zgjedhore të subjektit zgjedhor *Koalicioni "Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore"*.

Ankimet ndaj vendimeve të Komisionerit

Ndaj vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve janë administruar gjithsej 9 kërkesa ankimore, të depozituara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, organizata të shoqërisë civile dhe individë.

Në të gjitha rastet, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka ushtruar kompetencat e tij, duke vendosur shfuqizimin, rrëzimin ose moskalimin për shqyrtim të kërkesave ankimore, sipas rastit dhe bazuar në vlerësimin ligjor të çështjeve konkrete.

Kërkesat e KSHZ për vendosje sanksioni administrativ

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i paraqititi KAS-it 3 (tre) kërkesa për vendosje sanksioni administrativ me gjobë. Në përfundim të shqyrtimit:

- 1 kërkesë është mospranuar nga KAS;
- 2 kërkesa janë pranuar, duke vendosur sanksion administrativ me gjobë ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë Tiranë.

Ankimet parazgjedhore

Gjatë këtij procesi zgjedhor, KAS ka administruar 21 kërkesa ankimore, të paraqitura nga 10 subjekte të ndryshme, si dhe 3 kërkesa të Komisionerit për vendosje sanksionesh administrative.

Lënda e këtyre ankesave ka përfshirë çështje që lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore, raportimin e veprimtarive publike, përmbajtjen e fletës së votimit, regjistrimin e subjekteve zgjedhore, ngritjen e qendrave të posaçme të votimit, shkarkimin e anëtarëve të KZAZ-ve, heqjen e materialeve propagandistike, mbylljen e zyrave zgjedhore, si dhe çështje që lidhen me numërimin dhe vlerësimin e votave.

Vendimmarrja e KAS

Në përfundim të shqyrtimit, KAS ka marrë 21 vendime themeli, duke vendosur:

- Moskalimin për shqyrtim të 4 kërkesave ankimore;
- Pushimin e shqyrtimit për 1 kërkesë ankimore;
- Pranimin e 6 kërkesave ankimore dhe ndryshimin e vendimeve të KSHZ;
- Rrëzimin e 7 kërkesave ankimore;
- Pranimin e 2 kërkesave ankimore dhe vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë;
- Detyrimin e KSHZ-së për të shqyrtuar propozimin e një KZAZ-je në 1 rast.

ANKIMET PASZGJEDHORE

Administrimi i kërkesave ankimore

Gjatë procesit paszgjedhor, KAS administroi gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) kërkesa ankimore, të paraqitura nga 21 subjekte të ndryshme ankuese.

Lënda e kërkesave ankimore të depozituara nga subjektet zgjedhore lidhej kryesisht me:

- numërimin dhe vlerësimin e votave të caktuara;
- kundërshtimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve zgjedhore;
- pavlefshmërinë e zgjedhjeve;
- shpalljen e kandidatëve fitues.

Kërkesat ankimore të paraqitura nga organet shtetërore kishin për objekt kundërshtimin e ndalimit të disa procedurave ligjbërëse, ndërsa ato të paraqitura nga organizatat e shoqërisë civile lidhen me ushtrimin e veprimtarive publike të ndaluara gjatë periudhës zgjedhore ose me keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Nga ana tjetër, kërkesat ankimore të kandidatëve për deputet kishin në fokus problematika që lidhen me numërimin dhe rivlerësimin e votave, si dhe me shpalljen e kandidatëve fitues.

Subjektet ankuese

Kërkesat ankimore të depozituara sipas kategorisë së subjektit ankues paraqiten si më poshtë:

- 1 (një) kërkesë ankimore nga person fizik;
- 13 (trembëdhjetë) kërkesa ankimore nga kandidatë për deputet;
- 22 (njëzet e dy) kërkesa ankimore nga subjekte zgjedhore;
- 2 (dy) kërkesa ankimore nga organizata jofitimprurëse.

Vendimmarrja e KAS

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, KAS-i mori 38 (tridhjetë e tetë) vendime themeli, me rezultatet si vijon:

- për 12 (dymbëdhjetë) kërkesa ankimore u vendos moskalimi për shqyrtim;
- për 3 (tre) kërkesa ankimore u vendos pushimi i shqyrtimit;
- për 2 (dy) kërkesa ankimore u vendos kthimi për plotësim;
- për 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa ankimore u vendos rrëzimi i kërkesës dhe lënia në fuqi e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ose të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor;
- për 4 (katër) kërkesa ankimore u vendos pranimi i kërkesës dhe ndryshimi i vendimit të KSHZ.

Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave

Gjatë periudhës paszgjedhore, në zbatim të vendimeve të KAS-it, u kryen procedura të gjera të rinumërimit dhe rivlerësimit të votave, të cilat përfshinë:

- të gjitha kutitë me fletë votimi brenda vendit për qarqet Tiranë (1 282 QV) dhe Fier (586 QV);
- 174 kuti të materialeve zgjedhore për qarkun Durrës;
- 154 kuti të fletëve të votimit brenda vendit dhe 84 kuti me vota nga jashtë vendit për të njëjtin qark;
- hapjen dhe këqyrjen e një kutie nga votimi nga jashtë vendit për qarkun Berat, për verifikimin e fletëve të votimit me shënime të njëjta;
- hapjen dhe këqyrjen e një kutie të fletëve të votimit (QV nr. 4494/00) për qarkun Vlorë, për verifikimin e vulave në pjesën e pasme të fletëve të votimit;
- këqyrjen e 44 kutive të fletëve të votimit për qarkun Dibër, për verifikimin e votave parapëlqyese të kandidatëve të subjektit zgjedhor PD-ASHM;
- verifikimin e 232 kutive të materialeve zgjedhore në shkallë vendi, për rakordimin e numrit të fletëve të votimit të papërdorura;
- rakordimin e kutive të materialeve zgjedhore dhe fletëve të votimit për 94 Qendra Votimi të ZAZ-ve nr. 45 dhe nr. 52 të qarkut Elbasan.

Shqyrtimi gjyqësor i vendimeve të KAS

Gjatë periudhës zgjedhore dhe paszgjedhore, në KAS u depozituan në total 59 (pesëdhjetë e nëntë) kërkesa ankimore, për të cilat u miratuan 59 vendime themeli. Nga këto, 22 vendime, ose 37 për qind e totalit, iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, si organi kompetent për shqyrtimin e padive kundër vendimeve të KAS-it, rrëzoi 15 kërkesa padi dhe pushoi gjykimin për 7 të tjera, duke konfirmuar në tërësi ligjshmërinë e vendimmarrjes së KAS-it dhe duke e çuar nivelin e konfirmimit në 100 për qind të vendimeve të shqyrtuara gjyqësisht.

Kapitulli 4

SHPLLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR

Pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Rregullator me vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”, vendosi të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Ndaj vendimit nr. 34, datë 28.08.2025, të Komisionit Rregullator, u depozitua ankim në Kolegjin Zgjedhor nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Kolegj Zgjedhor me vendimin nr. 30, datë 04.09.2025, me shumicë votash vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

Të dhënat në format elektronik, mbi rezultatin e Zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025 në format elektronik, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



PJESA II

ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, 9 NËNTOR

Ky sesion i raportit dokumenton organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetarët e bashkive Berat, Cërrik, Mat, Tepelenë dhe Vlorë të zhvilluara më 9 nëntor 2025. Ky sesion përmbledh planifikimin në pikëpamje të kornizës nënligjore, implikimet buxhetore, menaxhimin e burimeve njerëzore, logjistikën dhe përdorimin e teknologjisë për identifikimin dhe numërimin e votave, si dhe fushatën e edukimit të zgjedhësve. Raporti përshkruan gjithashtu vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë, shqyrtimin e ankesave dhe vendimet e organeve kompetente, duke nxjerrë mësimet dhe rekomandime për përmirësimin e transparencës, efikasitetit dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Kjo pjesë e Raportit që lidhet me zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025, aksesohet në format elektronik duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



KREU I

PËRGATITJA E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME

Kapitulli 1

Aktet rregullatore

Pas shpalljes së Dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës së zgjedhjeve (këtu e në vijim, Dekreti), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmori një sërë veprimesh:

- Analizimi i bazës ligjore: U shqyrtuan detyrimet institucionale që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore përkatëse për organizimin e zgjedhjeve.
- Hartimi i matricës së akteve: U përcaktuan qartë të gjitha aktet ligjore dhe administrative që duhej të miratoheshin, me qëllim respektimin e afateve dhe rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
- Hartimi dhe miratimi i akteve: U realizua një proces i strukturuar për miratimin e aktet të nevojshme për administrimin e zgjedhjeve.

Miratimi i akteve gjatë procesit zgjedhor

Nga momenti i shpalljes së Dekretit deri në përfundim të procesit zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi gjithsej 81 akte, prej të cilave 3 u miratuan në bashkëkompetencë me Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Këto akte përfshinin:

- Miratimin e shpenzimeve buxhetore për organizimin e zgjedhjeve.
- Regjistrimin e partive politike dhe Komiteteve Nismëtare si subjekte zgjedhore.
- Emërimin e auditit dhe ndihmës auditit teknikien për mbikëqyrjen e hartimit të listave të zgjedhësve.
- Përcaktimin e masave të shpërblimit të personelit të administratës zgjedhore (operatorë PEI, kamera video regjistruese, administratë zgjedhore etj.).
- Miratimin e dokumentacionit të punës dhe materialeve ndihmëse për administratën zgjedhore.
- Miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve.
- Miratimin e sasisë së fletëve të votimit për çdo qendër votimi.

Veprimet e Komisionit Rregullator dhe Kolegjit Zgjedhor

Komisioni Rregullator shqyrtoi 4 akte, të cilat nuk u miratuan fillimisht për shkak të mosarritjes së numrit të kërkuar të votave. Vendimet e tyre u ankimuan dhe u shqyrtuan nga Kolegji Zgjedhor, i cili vendosi miratimin e të 4 (katër) akteve me Vendimin nr. 32, datë 15.10.2025, pas vlerësimit të argumenteve ligjore dhe procedurale.

Kapitulli 2

BUXHETI

Procesi i planifikimit, miratimit dhe menaxhimit të buxhetit për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme është kryer në zbatim të ligjit të buxhetit 2025, dekretit të Presidentit, vendimeve të KSHZ-së dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Vlerësimi i nevojave dhe struktura buxhetore

Fillimisht, u zhvillua një vlerësim i plotë i nevojave financiare, duke analizuar kërkesat funksionale, operative dhe teknike të procesit zgjedhor. U përgatit preventivi financiar dhe u përditësuan tavane të buxhetit bazuar në nevojat reale.

Miratimi

Kërkesat buxhetore dhe preventivi total prej 217,200,000 lekësh u paraqitën dhe u miratuan nga titullari i institucionit.

Ndarja e buxhetit:

- Mallra: 28,860,000 lekë;
- Shërbime: 188,340,000 lekë.

Ekzekutimi i buxhetit

Gjatë procesit zgjedhor, u kryen transferime për bashkitë për transport, qira ambientesh, shpërblime të komisionerëve dhe shpenzime të tjera operationale.

Mbyllja e procesit

Pas zgjedhjeve u krye rakordimi financiar, u përgatitën pasqyrat përfundimtare dhe raportet u dorëzuan në institucionet përkatëse. Menaxhimi financiar është kryer në mënyrë të rregullt dhe transparente, duke siguruar të gjitha mallrat dhe shërbimet e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Analiza buxhetore:

- Buxheti total: 217,200,000 lekë
- Kontraktuar: 180,746,016 lekë (83.2%)
- Paguar: 180,746,016 lekë (57.9%)
- Të pakontraktuara: 36,453,984 lekë (16.8%)

Mallrat

- Buxhet plan: 28,860,000 lekë
- Kontraktuar fakt: 97.2%
- Paguar: 97.2%
- Të pakontraktuara: 796,052 lekë

Shërbimet

- Buxhet plan: 188,340,000 lekë
- Kontraktuar fakt: 81.1%
- Paguar: 81.1%
- Të pakontraktuara: 18.9%

Procesi i prokurimit dhe menaxhimit financiar vlerësohet i përmbushur dhe në përputhje me afatet e zgjedhjeve.

Kapitulli 3

PERSONELI

Në funksion të organizimit të zgjedhjeve të pjesshme , u kryen disa veprimtari kryesore:

- Angazhimi i personelit të përkohshëm;
- U angazhuan rreth 30 punonjës për procesin e këqyrjes paszgjedhore;
- U punësuan 53 punonjës me kontrata afatshkurtra;
- Hartimi i kontratave tip;
- U përgatitën kontrata standarde sipas kategorive dhe funksioneve të punonjësve.

Shpallja e vendeve të lira dhe rekrutimi

Vendet e lira u shpallën në modulën e punësimit të KQZ-së ku u regjistruan 181 aplikime dhe u lidhën 92 kontrata shërbimi.

Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave

U ngrit një bazë e plotë të dhënash për punonjësit e rekrutuar, me të gjitha informacionet përkatëse të kontratave dhe pozicioneve të punës.

Përgatitja e kurrikulës dhe zhvillimi i trajnimeve

U hartuan kurrikula trajnimi për personelin part -time, me fokus organizimin e KQZ-së, si dhe normat e etikës. Personelit iu shpërndanë materiale trajnimi (prezantimi dhe fletëpalosje).

Në përfundim, veprimtaritë u përqendruan në përzgjedhjen, kontraktimin dhe trajnimin e personelit, duke siguruar mbështetjen e nevojshme për zhvillimin me sukses të zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar të disa bashkive.

Kapitulli 4

LOGJISTIKA DHE INFRASTRUKTURA ZGJEDHORE

Vlerësimi i nevojave për pajisje dhe materiale zgjedhore

Pas miratimit të Dekretit, KQZnisi menjëherë procedurat përgatitore për sigurimin e bazës materiale dhe logjistike të procesit zgjedhor. U hartuan:

- Lista e materialeve zgjedhore me kërkesat specifike nga të gjitha drejtoritë;
- Kërkesat buxhetore të nevojshme për realizimin e procesit.

Zgjedhjet e pjeshme u zhvilluan në 5 bashki, të cilat korrespondojnë me 9 Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ), me një total prej 472 qendra votimi (QV).

Tabela 1. Bashkitë, ZAZ-të dhe numri i QV-ve

Nr.	Bashkia	ZAZ	Nr. QV
1	Berat	66	72
2	Berat	67	44
3	Cërrik	47	57
4	Mat	16	47
5	Tepelenë	80	21
6	Vlorë	84	68
7	Vlorë	85	52
8	Vlorë	86	54
9	Vlorë	87	57
TOTAL		9 ZAZ	472 QV

Përgatitja e bazës materiale zgjedhore

Për garantimin e një procesi të rregullt dhe të standardizuar në përgatitjen e bazës materiale zgjedhore, u krijua kuadri i nevojshëm rregullator. Me vendimin nr. 1388, datë 06.10.2025, u miratua akti që përcakton formatin dhe specifikimet e vulave të KZAZ-ve, KQV-ve dhe kryetarëve të qendrave të votimit, si dhe numrin e vulave rezervë për çdo zonë. Ky akt siguroi unifikimin e elementëve dhe rriti integritetin e dokumentacionit zgjedhor në të gjitha ZAZ-të.

Një komponent i rëndësishëm ishte përditësimi i modulit elektronik për administrimin e materialeve zgjedhore. Bazuar në përvojën e zgjedhjeve të 11 majit 2025, u identifikuan disa mangësi në funksionimin e sistemit dhe u ndërmorën përmirësimet përkatëse në versionin e ri të modulit. Ndryshimet kishin për qëllim:

- Lehtësimin e punës së ZAZ-ve dhe KQV-ve;
- Sigurimin e një regjistrimi më të saktë të inventarit;

- Minimizimin e gabimeve gjatë shpërndarjes dhe kthimit të materialeve.

Procesi i përgatitjes së materialeve zgjedhore në magazinat e KQZ-së u krye përmes një sistemi të digjitalizuar, i cili përfshinte hapat kryesorë:

- Përgatitjen e etiketave të kutive të votimit, materialeve zgjedhore dhe ambalazhit përkatës;
- Ndarjen dhe regjistrimin e vulave dhe kodeve të sigurisë në sistem për çdo KZAZ;
- Skanimin e fletëve të votimit dhe vendosjen e tyre në kutitë përkatëse të qendrave të votimit.

Në përputhje me udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çdo kuti të qendrës së votimit u vendos një listë e plotë e materialeve logjistike, e cila shërbeu si:

- Udhëzues për anëtarët e administratës zgjedhore;
- Mjet kontrolli për të siguruar pajisjen e plotë të kutive me materialet e nevojshme.

Kjo praktikë thjeshtësoi punën në terren dhe kontribuoi në një menaxhim më të sigurt, më të saktë dhe më efikas të bazës materiale për procesin zgjedhor.

Objektet zgjedhore

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi ngritjen e një numri qendrash votimi (QV) në ambiente private. Në total, u miratuan 36 QV në ambiente private. Me kërkesë të Partisë Demokratike, u bë ndryshimi i një QV-je nga ambient privat në ambient publik.

Po ashtu, me propozim të Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe miratim nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, u miratuan dy QV të posaçme pranë I.E.P.V-ve, njëra në Bashkinë Berat dhe tjetra në Bashkinë Mat.

Aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në zgjedhje

Sistemi i kamerave regjistruese dhe monitorëve në VNV dhe QV

Në të gjitha qendrat e votimit dhe vendet e numërimit u instaluan kamera për regjistrim video, duke ruajtur fshehtësinë e votës. U krijuan 9 VNV për numërimin e votave pas mbylljes së procesit zgjedhor, me transmetim live online të pamjeve të ambienteve të tyre në kanalën zyrtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në youtube.

Nuk pati problematika të konstatuara në implementimin e këtyre sistemeve.

Sistemi i identifikimit të zgjedhësve

Edhe në zgjedhjet e pjesshme të datës 9 Nëntor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përdori sistemin e identifikimit të zgjedhësve në masën 100% për 5 bashkitë objekt i Dekretit, për të siguruar identifikimin korrekt, parandalimin e votimit të dyfishtë, familjar ose për një zgjedhës tjetër, si dhe një proces të shpejtë dhe transparent në çdo qendër votimi

Në këto zgjedhje, SEIV u implementua në 472 qendra votimi, sipas ekstraktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Pajisjet Elektronike të Identifikimit (PEI) përdorën versionin e ri të aplikacionit VIU Client, me funksionalitetin e transmetimit të statistikave zgjedhore.

Shpërndarja e Pajisjeve PEI

Shpërndarja u realizua më 7 Nëntor 2025, sipas të dhënave në vijim:

Destinacioni	Pajisje Rezerve	Pajisje PEI (primare)	Gjithsej
ZAZ 16	12	47	59
ZAZ 47	10	57	63
ZAZ 66	10	72	78
ZAZ 67	10	44	50
ZAZ 80	5	21	26
ZAZ 84	12	68	80
ZAZ 85	12	52	64
ZAZ 86	12	54	66
ZAZ 87	12	57	69
Totali	95	472	567

Performanca e pajisjeve PEI

- Pajisjet që raportuan pjesëmarrjen: 469 nga 472 (99.36%).
- Raportimi i statistikave: 96.82% e pajisjeve të identifikimit elektronik raportuan të paktën një statistikë gjatë ditës.
- Monitorimi sipas qarqeve: Shkalla më e lartë e lidhjes së pajisjeve ishte në Berat, ndërsa më e ulëta në Mat.
- Të gjitha pajisjet PEI u përgatitën, u dërguan dhe u kthyen 100%.

Të dhënat në format elektronik, mbi pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025, aksesohet në format elektronik, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



Moduli i raportimit për pajisjet PEI

Operatorët e përzgjedhur për secilën qendër votimi raportuan në tre kategori:

1. Para ditës së votimit: Raportimi u krye nga të gjithë 472 operatorë/QV.
2. Dita e votimit: Raportimi u krye nga 418 operatorë/QV.
3. Pas mbylljes së votimit: Raportimi u krye nga 127 operatorë/QV.

Problematikat e identifikuara

Gjatë procesit të votimit u vërejt ngadalësim në funksionimin e disa pajisjeve PEI, duke ndikuar në ritmin e identifikimit të qytetarëve.

Menaxhimi i sfidave:

Ekipet e suportit në terren dhe helpdesk-u kryen zëvendësime të pajisjeve dhe USB-ve rezervë, duke siguruar stabilitet operativ dhe rrjedhshmëri të procesit.

Rekomandime

1. Përmirësimi i proceseve të punës:
 - a. Segmentimi i stafit në faza të veçanta për "fshirjen" e pajisjeve dhe konfigurimin e tyre.
 - b. Implementimi i quality assurance për minimizimin e gabimeve në prodhim.
2. Zbatimi i procedurave dhe ndarja e detyrave:
 - a. Përcaktimi i qartë i përgjegjësive për stafin e përhershëm dhe part-time.
 - b. Çdo grup të fokusohet në një proces/hap të vetëm për të reduktuar gabimet njerëzore.
3. Dokumentimi i problematikave dhe zgjidhjeve:
 - a. Regjistrimi i çdo problemi dhe zgjidhjeje të aplikuar për të siguruar cilësinë dhe për të minimizuar gabimet operative.

Shpërndarja dhe kthimi i materialeve zgjedhore

Shpërndarja e materialeve zgjedhore është një element kyç për funksionimin e duhur të KZAZ-ve dhe garantimin e integritetit të procesit zgjedhor. Për këtë qëllim, u planifikuan dhe zbatuan tre etapa të mirë përcaktuara në bashkëpunim me sektorët përkatës dhe institucionet mbështetëse.

Etapa 1: Përgatitja e bazës materiale për KZAZ-të

- Përgatitja e plotë e bazës materiale për ngritjen dhe funksionimin e KZAZ-ve.
- Çdo KZAZ u pajis me dokumentacionin dhe materialet zgjedhore të nevojshme për konstituimin e tyre.
- Mangësitë e vogla të evidentuara gjatë kësaj faze u zgjidhën menjëherë.

Etapa 2: Dërgimi i materialeve për procesin e numërimit

- Dërgimi drejt VNV-ve i materialeve që përdoren gjatë numërimit, përfshirë dhomat e fshehta, elementët ndarës dhe komponentët ndihmës të tjerë.

Etapa 3: Shpërndarja e materialeve për votim

- Shpërndarja e kutive me fletët e votimit, pajisjes PEI, vulave me kode sigurie dhe materialeve të tjera zgjedhore.
- Ky proces u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Policinë e Shtetit.

Përdorimi i modulit ERP për menaxhimin e materialeve

Përdorimi i modulit ERP lehtësoi procesin e shpërndarjes dhe të kthimit të bazës materiale.

Nga ana e KZAZ-ve, aplikacioni është përdorur për:

- Skanimin e kutive të ambalazhit në 472 QV;
- Skanimin e vulave/kodeve të sigurimit drejt KQV-ve për 472 QV.

Pas kthimit të materialeve në magazinat e KQZ:

- Skanimi i kutive të votimit u krye për 465 QV;
- Skanimi i kutive të materialeve u krye për 442 QV.



Figura 1: Te dhena mbi gjurmimin e materialeve zgjedhore ne KZAZ

Kapitulli 5

DOKUMENTACIONI DHE MODELET

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori një sërë vendimesh thelbësore që lidhen me miratimin e dokumentacionit teknik dhe operacional për strukturat zgjedhore. Këto vendime synuan standardizimin e praktikave të punës, harmonizimin me aktet rregullatore në fuqi dhe garantimin e një administrimi profesional të procesit zgjedhor.

Dokumentacioni për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi setin e modeleve të punës të personalizuar për procesin e zgjedhjeve të pjeshme për kryetar bashkie. Ky set përfshiu:

- Modelimin e vendimmarrjeve administrative për caktimin dhe emërimin e komisioneve të niveleve të treta (KQV dhe GNV) si dhe të vëzhguesve të subjekteve politike.
- Librin e Protokollit të Mbledhjeve, të cilit i është inkorporuar Regjistri i Vendimeve të KZAZ-së.
- Regjistrin e korrespondencës dhe formularë të tjerë të nevojshëm administrativë.

Dokumentacioni për Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV)

Për KQV-të janë miratuar modelet e dokumenteve që lidhen me proceset administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor, përfshirë:

- Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
- Procesverbalet e hapjes dhe mbylljes së kutisë së votimit.
- Vendimmarrjet operative dhe formularët ndihmës për administrimin e ditës së votimit.

Dokumentacioni i përgjithshëm zgjedhor

Dokumentacioni i miratuar mbulon të gjitha fazat e procesit zgjedhor, duke nisur nga ngritja e strukturave dhe shpërndarja e materialeve, deri tek administrimi i ditës së votimit, mbyllja e procesit, numërimi dhe shpallja e rezultateve. Harmonizimi me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore garanton lehtësimin e punës së komisionerëve dhe uljen e gabimeve procedurale.

Materialet ndihmëse dhe udhëzimet për administratën zgjedhore

KQZ miratoi gjithashtu paketën e materialeve ndihmëse për KZAZ-të, e cila përfshin:

- Udhëzime të përshtatura për proceset specifike të zgjedhjeve të pjeshme.
- Referenca konkrete lidhur me sjelljen dhe detyrimet e administratës zgjedhore.

Qëllimi i kësaj pakete është rritja e efikasitetit dhe koherencës në zbatimin e standardeve zgjedhore, duke siguruar uniformitet në të gjitha zonat zgjedhore dhe qendrat e votimit.

Miratimi i dokumenteve të reja të identifikimit

Një risi e rëndësishme për procesin zgjedhor të 9 nëntorit 2025 ka qenë miratimi i modeleve të përditësuara të dokumenteve të identifikimit për:

- Anëtarët e KZAZ-ve.
- Anëtarët e KQV-ve.
- Anëtarët e GNV-ve.
- Vëzhguesit e subjekteve politike / zgjedhore.

Dokumentet e reja u konceptuan me elemente të shtuara sigurie dhe gjurmueshmërie, duke përfshirë:

- Numërim unik identifikimi;
- Elemente grafike të posaçme;
- Komponentë të mbrojtur ndaj falsifikimit.

Këto masa adresojnë problematikat e evidentuara në procese të mëparshme, ku janë identifikuar raste të përdorimit të dokumenteve jo standarde apo qasje të paautorizuara në ambientet zgjedhore. Implementimi i dokumenteve të reja ka rritur nivelin e kontrollit, disiplinës dhe integritetit të procesit.

Kapitulli 6

EDUKIMI DHE INFORMIMI I ZGJEDHËSVE

Në kuadër të zgjedhjeve për kryetarët e bashkive Berat, Cërrik, Mat, Tepelenë dhe Vlorë, të zhvilluara më 9 nëntor 2025, u organizua një fushatë gjithëpërfshirëse informimi dhe ndërgjegjësimi për zgjedhësit. Fushata u bazua në “Programin e Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve”, të miratuar me Vendimin nr. 1402, datë 09.10.2025.

Qëllimi i programit ishte forcimi i njohurive të qytetarëve për procesin zgjedhor, rritja e pjesëmarrjes në votime dhe sigurimi i informimit të saktë mbi të drejtat dhe detyrimet e zgjedhësve. Programi synoi:

- Informimin e zgjedhësve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.
- Ndërgjegjësimin për rëndësinë e procesit zgjedhor dhe parandalimin e shkeljeve.
- Sensibilizimin e grupeve vulnerabël, të rinjve dhe grave .
- Informimin e administratës publike për kufizimet dhe detyrimet ligjore gjatë periudhës zgjedhore.
- Edukimin e zgjedhësve për mënyrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit.

Audienca e synuar: Të gjithë zgjedhësit mbi 18 vjeç në bashkitë Berat, Cërrik, Mat, Tepelenë dhe Vlorë.

Mjetet e përdorura:

- Media sociale (spote, banera dhe mesazhe informuese);
- Takime informuese me komunitetin;
- Postera në qendrat e votimit;
- Aplikacioni mobile i KQZ;
- Faqja zyrtare e internetit të KQZ;

Informimi mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit

Përmes kanaleve digjitale, takimeve në terren dhe aplikacionit “Ku votoj”, zgjedhësit morën informacion mbi regjistrimin e tyre në listat zgjedhore dhe vendndodhjen e qendrës së votimit.

Ndërgjegjësimi për procesin zgjedhor dhe parandalimi i shkeljeve

U shpërnda informacion për veprat penale zgjedhore, u transmetuan spote sensibilizuese dhe u vendosën postera në qendrat e votimit. Seksioni “Denonco” në aplikacion u përdor për raportimin e shkeljeve.

Rritja e pjesëmarrjes së grupeve vulnerabël dhe votuesve të rinj

U mbajtën takime informuese për rëndësinë e pjesëmarrjes, votimin e lirë dhe të pandikuar, si dhe për përdorimin e aplikacionit dhe faqes së KQZ-së.

Informimi i administratës publike

Përmes materialeve informuese në rrjete sociale dhe platformave të KQZ-së u komunikuan qartë rregullat ligjore që kufizojnë përdorimin e burimeve shtetërore dhe veprimtarinë institucionale gjatë fushatës zgjedhore.

Edukimi për mënyrën e votimit

Përmes spoteve, materialeve vizuale dhe seksionit “Si mund të votoj” në aplikacion dhe në faqen e KQZ-së, zgjedhësit u njohën me hapat e votimit, përmbajtjen e fletës së votimit dhe mënyrën e saktë të shënimit.

Aktivitetet me të rinjtë

Gjatë tetorit 2025 u organizuan sesione informuese në gjimnazet e bashkive të përfshira, me fokus rritjen e pjesëmarrjes së votuesve të rinj dhe respektimin e rregullave ligjore në ditën e votimit.

Takime me koordinatorët e KQZ-së

U diskutuan mënyrat për të rritur aksesueshmërinë e materialeve dhe shërbimeve zgjedhore, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.

Sfidat

Sfida kryesore ishin afatet e shkurtra, vështirësitë logjistike në zonat rurale dhe pjesëmarrja më e ulët se parashikuar në disa takime për shkak të kushteve atmosferike. Pavarësisht këtyre vështirësive, programi u realizua sipas planifikimit dhe standardeve të kërkuara.

Kapitulli 7

REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

Në afatin e përcaktuar 16.10.2025, u informuan të gjitha partitë politike dhe kandidatët për dokumentacionin dhe procedurat që duhej të përmbushnin. Si rezultat, u regjistruan:

1. Parti pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar Bashkie të datës 9 nëntor 2025:

Partia Socialiste e Shqipërisë (PS)

Partia Demokratike e Shqipërisë (PD ose PDSH)

Partia e Lirisë (PL)

Lëvizja Shqipëria Bëhet (SHB)

Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL)

Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK)

2. Fitues në Zgjedhjet e Pjesshme për Kryetar Bashkie të datës 9 Nëntor 2025

1. Bashkia Berat Kryetar z. Ervin Llazar Ceca (PS)

2. Bashkia Cërrik Kryetar z. Florenc Spiro Doka (PS)

3. Bashkia Mat Kryetar z. Altin Ramazan Bojni (PS)

4. Bashkia Tepelenë Kryetar z. Gramoz Sadik Sako (PS)

5. Bashkia Vlorë Kryetar zj. Brunilda Flamur Mersini (PS)

3. Në përmbledhje në zgjedhjet e datë 9 Nëntor 6 (gjashtë) kandidatë janë regjistruar nga Partia Socialiste dhe 7 (shtatë) janë kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.

Kandidatë të pavarur:

Bashkia Berat (Pavlo Shkarpa)

Bashkia Cërrik (Amarildo Hoxha)

Bashkia Mat (Eduart Brahilika) (Suzana

Pasha) Bashkia Tepelene (Gabriel Guma)

Bashkia Vlorë (Dionis Sota) (Gjergji Nika)

Kandidatë PS:

Bashkia Berat (Ervin Ceca)

Bashkia Cërrik (Florenc Doka)

Bashkia Mat (Altin Bojni)

Bashkia Tepelenë (Gramoz Sako)

Bashkia Vlorë (Brunilda Mersini)

Verifikimi i kandidatëve

Në përputhje me Ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve u krye verifikimi i pastërtisë së figurës për kandidatët në Bashkitë: Berat, Tepelenë, Mat, Cërrik dhe Vlorë. Afati për dorëzimin e dokumentacionit për këtë proces ishte 24.10.2025.

Të dhënat në format elektronik mbi subjektet zgjedhore të regjistruara për Zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



Kapitulli 8

KOMISIONET ZGJEDHORE

Në zbatim të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, u përcaktuan partitë politike me të drejtë propozimi të anëtarëve të Komisioneve Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ): Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike dhe Partia e Lirisë; paraqitën propozimet e tyre përkatëse, së bashku me dokumentacionin ligjor të kërkuar.

Më datë 13.10.2025 u krye konstituimi i 9 KZAZ-ve, duke mundësuar nisjen e funksionimit të tyre sipas afateve të parashikuara në kuadër të procesit zgjedhor.

Zëvendësimet e anëtarëve të KZAZ-ve nga subjektet politike

Gjatë gjithë periudhës zgjedhore, subjektet politike kryen zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-ve si më poshtë:

- **Partia Demokratike:** janë liruar 15 anëtarë (6 gra, 9 burra)
- **Partia Socialiste e Shqipërisë:** janë liruar 10 anëtarë (2 gra, 8 burra)
- **Partia e Lirisë:** është liruar 1 anëtar

Pas publikimit të njoftimit në portalin e KQZ për aplikime si komisioner të Qendrave të Votimit të emëruar nga KQZ, u regjistruan gjithsej **288 aplikantë**.

Nga këta, aplikantët që plotësuan kriteret ligjore u miratuan me vendim të KSHZ, duke rezultuar në **123 shtetas të emëruar** si anëtarë të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).

Trajnimet për administratën zgjedhore u organizuan me synimin për të rritur kapacitetet profesionale të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin zgjedhor, duke siguruar zbatim të saktë të legjislacionit, standardizim të procedurave dhe administrim efikas e të paanshëm.

Procesi u zhvillua në bazë të Vendimit nr. 1392 (7.10.2025) dhe u udhëhoq nga skema e trajnimeve e miratuar me Urdhrin nr. 642 (21.10.2025). Komisioni Qendror i Zgjedhjeve realizoi planifikimin për:

- numrin dhe përzgjedhjen e trajnerëve,
- logjistikën,
- numrin dhe kohëzgjatjen e sesioneve,
- buxhetin e nevojshëm.

Modeli me grupe trajnerësh u përdor për të rritur efektivitetin dhe cilësinë e procesit. Volumi i trajnimeve:

- 24 orë për KZAZ-të
- 122 sesione për KQV-të (366 orë)
- 25 sesione për operatorët e PEI (75 orë)
- 18 sesione për GNV-të (36 orë)

Rekrutimi i trajnerëve

U angazhuan 11 trajnerë të certifikuar, të cilët morën pjesë në një trajnim dyditor për rifreskim dhe harmonizim metodologjik. Trajnimet u zhvilluan përmes diskutimit të rasteve praktike.

Logjistika dhe materialet

KQZ përgatiti dhe shpërndau manuale dhe kujtues për të gjitha kategoritë e administratës zgjedhore. Trajnerët u pajisën me USB me materiale të standardizuara.

Mjediset e trajnimeve, kalendari dhe monitorimi

Në bashkëpunim me bashkitë dhe Ministrinë e Arsimit, u siguruan mjedise të përshtatshme, për zhvillimin normal të trajnimeve. Kalendarët e trajnimeve dhe plani i monitorimit u miratuan me urdhra të veçantë. U krijuan platforma online për raportim në kohë reale të sesioneve dhe monitorimeve. Nga të dhënat e raportimit rezulton se janë trajnuar:

- **86.1%** e komisionerëve të KZAZ,
- **24%** e komisionerëve të KQV,
- **41.8%** e anëtarëve të GNV,
- **100%** e operatorëve të PEI.

Kapitulli 9

LISTA E ZGJEDHËSVE

Lista e zgjedhësve përbën një nga elementët kyç për garantimin e integritetit të procesit zgjedhor. Administrimi i saj u realizua në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësitë e pushtetit vendor, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë periudhës përgatitore, KQZ ushtroi mbikëqyrje dhe zhvilloi kontroll periodik mujor mbi listën e zgjedhësve të dërguar nga DPGJC dhe njësitë e pushtetit vendor.

Paralelisht, u angazhuan auditë teknicienë dhe ndihmës/auditë të pavarur për verifikimin e veprimeve dhe ndryshimeve në përbërësit zgjedhorë për periudhën e kontrollit, duke përfshirë edhe metodologjinë e gjenerimit të raporteve nga baza e të dhënave e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky proces kishte për qëllim garantimin e saktësisë dhe transparencës së listës së zgjedhësve, përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së të raporteve mujore të hartuara nga këta auditë.

Lista e zgjedhësve u publikua në mënyrë të aksesueshme për qytetarët përmes faqes zyrtare të KQZ-së dhe platformës “e-Albania”, ndërsa zgjedhësit patën mundësi të identifikonin qendrën e tyre të votimit edhe përmes aplikacionit mobil të KQZ-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgoi KQZ-së 4 (katër) ekstrakte të listës së zgjedhësve në shkallë vendi. Ekstrakti përfundimtar u dorëzua më datë 02.05.2025.

Në bazë të këtij ekstrakti, numri i zgjedhësve në rang vendi ishte 3.467.962 dhe numri i qendrave të votimit 5225.

Në nivel qarku, numri i qendrave të votimit dhe numri i zgjedhësve paraqitet si më poshtë:

Nr.	Qarku	Nr. QV-ve	Nr. Zgjedhësve
1	Berat	275	169.606
2	Diber	222	122.167
3	Durrës	493	351.983
4	Elbasan	508	331.859
5	Fier	587	381.524
6	Gjirokaster	198	114.399
7	Korçë	422	266.794
8	Kukës	139	81.804



9	Lezhe	245	164.954
10	Shkoder	405	261.579
11	Tiranë	1282	913.415
12	Vlorë	449	307.878
Total		5225	3.467.962

Po ashtu, nga përpunimi i të dhënave të listës së zgjedhësve, KQZ miratoi vendimin për sasinë e fletëve të votimit që duhet të prodhoheshin për çdo qendër votimi për zgjedhësit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11.05.2025.

Kapitulli 10

FUSHATA ZGJEDHORE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi me Vendimin nr. 1417, datë 14.10.2025, numrin e monitoruesve për pesë bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet e datës 9 Nëntor. Në përputhje me këtë vendim, u shpall publikisht njoftimi për shprehje interesi për pozicionet e monitoruesve të fushatës. Pas procesit të aplikimit dhe vlerësimit, u përzgjedhën **38 monitorues**, të cilët mbuluan monitorimin në pesë bashkitë përkatëse.

Gjatë periudhës 20 tetor – 9 nëntor 2025, monitoruesit dorëzuan pranë KQZ-së gjithsej 123 raporte monitorimi. Bazuar në këto raporte dhe informacionet e administruara nga KQZ:

- Nuk u konstatua asnjë rast shkeljeje nga subjektet pjesëmarrëse.
- Nuk u evidentuan denoncime nga qytetarët apo entitete të tjera.
- Procesi administrativ u zhvillua në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet përkatëse të transparencës dhe integritetit zgjedhor.

Pasqyrimi mediatik dhe financimi i fushatës

Komisioni ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme për garantimin e trajtimit të barabartë të subjekteve zgjedhore dhe transparencës së financimit të fushatës:

1. U dërguan **njoftimet zyrtare** OSHMA-ve për tarifatat zyrtare të zbatueshme.
2. Bashkive iu përcollën rregullat dhe udhëzimet për organizimin e fushatës dhe vendafishimin e materialeve propagandistike.
3. Autoritetit të Mediave Audiovizive iu dërgua lista e subjekteve të regjistruara për zgjedhjet.
4. **13 OSHMA** dorëzuan tarifatat e tyre, të cilat u publikuan në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve caktoi me **Vendimin nr. 1451, datë 26.10.2025**, kohën e transmetimit për subjekte zgjedhore në radiotelevizionin publik.

Në raportin e AMA-s datë 3 Nëntor 2025 u evidentua se OSHMA “6+1 TV” kishte transmetuar dy reklama politike të modifikuara, favorizuese për një kandidat në Bashkinë Vlorë. Si pasojë, Komisioneri Shtetëror miratoi **Vendimin nr. 1501, datë 6.11.2025**, për shqyrtimin e pasqyrimin mediatik të datës 3 Nëntor.

Vlerësimi i procesit zgjedhor

Analiza e veprimtarive gjatë periudhës parazgjedhore dhe monitorimi i 123 raporteve të dorëzuara tregoi se:

- Procesi u administrua në mënyrë të rregullt dhe transparente.
- Nuk u evidentuan shkelje të rregullave zgjedhore nga subjektet pjesëmarrëse.
- Nuk u paraqitën denoncime nga qytetarët apo grupe interesi.
- Monitorimi i Portalit të Denoncimeve dhe i e-mail-it zyrtar nuk evidentoi shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (neni 91) apo të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Përfundim

Procesi i zgjedhjeve të pjesshme vendore në Bashkitë Vlorë, Tepelenë, Berat, Cërrik dhe Mat u zhvillua në mënyrë të rregullt, transparente dhe pa incidente që cenojnë integritetin e procesit zgjedhor.

Raportimi i veprimtarive publike dhe përdorimi i burimeve shtetërore

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, KQZ rikujtoi të gjitha institucionet publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe ndërmarrjet shtetërore, për detyrimin e respektimit të këtyre dispozitave në territorin e Bashkive **Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë**, gjatë periudhës nga momenti i njoftimit deri në mbylljen e procesit të votimit. Qëllimi i Kujtesës Zyrtare ishte:

- Garantimi i një interpretimi të unifikuar dhe të saktë të rregullave që lidhen me raportimin e veprimtarive me karakter publik.
- Dallimi i veprimtarive të lejuara nga ato të ndaluara në kuptim të ligjit.

Sistemi i Raportimit

Ndërfaqja Elektronike e Raportimeve të Institucioneve (NRI), u përdor për raportimin e veprimtarive publike të planifikuara në periudhën 22 tetor – 9 nëntor 2025. Gjatë kësaj periudhe u raportuan gjithsej:

- **37 veprimtari publike**
- Nga **13 institucione publike**

Këto raportime janë bërë sipas kërkesave të përcaktuara nga **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**.

Kapitulli 11

VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Për zgjedhjet e pjesshme të datës 9 nëntor 2025, u akredituan vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë. Përmes portalit elektronik aplikuan 20 organizata: 19 vendase dhe 1 ndërkombëtare.

Organizatat e akredituara:

1. Citizen for Social Change
2. KRIIK
3. MTSC shpk
4. Top News
5. Shoqata për Kulturë Demokratike
6. Shoqata e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut
7. Media Vizion SHA
8. Klan TV
9. Vani shpk (TV Mati)
10. Euro Balkans News
11. 3 DS and AF Entertainment
12. RTSH
13. Arbi Fortuzi
14. Top Channel
15. Anadolu Agency
16. ABC News
17. G2 Media
18. Johaniteri (MCN News)
19. MCA@PRESS
20. Alb TV Canada Inc.

KQZ përfundoi me sukses dhe brenda afateve akreditimin e rreth **358 vëzhguesve jopolitikë**, nga të cilët:

- **357 vëzhgues vendas** nga 19 OShC:
 - 255 afatgjatë
 - 100 afatshkurtër
 - 2 përkthyes
- **1 vëzhgues afatgjatë ndërkombëtar** nga organizata e huaj pjesëmarrëse.

KREU II

DITA E ZGJEDHJEVE

Kapitulli 1

HAPJA E VOTIMIT

Procesi i votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore u zhvillua më 9 nëntor 2025, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Votimi filloi në orën 07:00 dhe përfundoi në orën 18:00, duke u zhvilluar në mënyrë të qetë dhe të rregullt në 472QV.

Orari i Hapjes së qendrave të votimit:

- 81% e QV-ve u hapën në orën 07:00.
- 19% e QV-ve u hapën me vonesë, ku vetëm 20 QV filluan punën pas orës 08:00.

Përbërja e Komisioneve të QV-ve

Komisionet e QV-ve paraqiteshin sipas numrit të anëtarëve:

- 28–34% kishin 7 anëtarë
- 18–19% kishin 6 anëtarë
- 29–30% kishin 5 anëtarë
- 19–22% kishin 4 anëtarë

Kapitulli 2

ZHVILLIMI I VOTIMIT

Me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve , u ngrit një strukturë e posaçme për monitorimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor. Kjo strukturë kishte për detyrë:

- Mbikëqyrjen e marrjes së informacionit dhe veprimtarisë së Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV);
- Sigurimin e koordinimit me KZAZ-të dhe KQV-të nga momenti i ngritjes së saj deri në shpalljen e rezultateve dhe dorëzimin e dokumentacionit zgjedhor në KQZ.

Gjatë ditës së votimit:

- U verifikuan dhe adresuan të gjitha shqetësimet e ngritura nga organet e medias;
- Çdo problem u zgjidh në kohë reale;
- Nuk u raportua asnjë shqetësim që të lidhej drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Bashkëpunimi me organet e sigurisë:

- U realizua koordinim i vazhdueshëm me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Çdo indicie problematike e përcjellë në KQZ, veçanërisht ato që lidhen me sjelljen e anëtarëve të KQV-ve, u trajtua me prioritet.

Vëzhguesit dhe fshehtësia e votës

- Në të gjitha QV-të, procesi u zhvillua në prani të vëzhguesve politikë.
- Fshehtësia e votës u respektua në 99–100% të rasteve.

Atmosfera gjatë procesit të votimit

- Në 93% të QV-ve ishin të pranishëm vëzhgues politikë.
- 98% e QV-ve nuk raportuan grumbullime të njerëzve në ambientet e jashtme.

Problematika teknike

Problematikat teknike ishin minimale dhe u adresuan menjëherë:

- 9 QV raportuan defekte në pajisjet PEI, të cilat u zëvendësuan.
- 5 QV përdorën gabimisht llojin e kutisë së votimit.
- 5 QV patën ndërprerje të shkurtra të energjisë elektrike ose vështirësi të shkaktuara nga reshjet e dendura.

Transmetimi i pjesëmarrjes

Për herë të parë, pjesëmarrja transmetohej në **kohë reale** për çdo qendër votimi në mënyrë absolute dhe jo me kampionim, në faqen e internetit të KQZ dhe për mediat.

Vëzhgime Përfundimtare

- Procesi i votimit u zhvillua në mënyrë të qetë dhe të rregullt.
- Në orët e pasdites u vëre rritje e lehtë e pjesëmarrjes, por niveli i përgjithshëm mbeti më i ulët krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.

Kapitulli 3

MBYLLJA E VOTIMIT

Pjesëmarrja e zgjedhësve

Pjesëmarrja mesatare në pesë bashki ishte 26.21%, me ndryshime të ndjeshme ndërmjet tyre:

- Vlorë: 12.59%
- Berat: 19.81%
- Cërrik: 24.81%
- Mat: 39.23%
- Tepelenë: 34.63%

Përfundim

Procesi zgjedhor u monitorua dhe mbikëqyra sipas standardeve të parashikuara, duke garantuar koordinim efektiv midis KQZ-së, KZAZ-ve, KQV-ve dhe Policisë së Shtetit. Nuk u raportuan problematika që të cenonin integritetin e procesit zgjedhor.

Kreu III

NXJERRJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR

Kapitulli 1

GRUPET E NUMËRIMIT

Me vendim të KSHZ u përcaktua gjithashtu e drejta e subjekteve politike për të propozuar anëtarë të Grupeve të Numërimit të Votave, konkretisht:

- **Partia Socialiste:** 2 anëtarë
- **Partia Demokratike:** 1 anëtar
- **Partia e Lirisë:** 1 anëtar

KQZ administroi të gjitha vendimet e lidhura me:

- emërimin e anëtarëve të KQV-ve,
- emërimin e anëtarëve të GNV-ve,
- emërimin e Koordinatorëve të Sigurisë,

të cilët u caktuan nga KZAZ-të sipas propozimeve zyrtare të paraqitura nga subjektet politike.

Kapitulli 2

NUMËRIMI, VLERËSIMI I VOTAVE DHE TABELIMI I REZULTATIT

Numërimi

Pas marrjes së dokumentacionit të plotë zgjedhor, KZAZ-të morën vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave. Procesi i numërimit u zhvillua pa ndërprerje nga të gjitha KZAZ-të, duke përfunduar për KZAZ-në e nëntë në orën 07:15, më datë 10.11.2025.

Dorëzimi i dokumentacionit zgjedhor u realizua më datë 11.11.2025, në përputhje me me kërkesat ligjore dhe koordinimin ndërmjet sektorëve të KQZ-së. Publikimi i rezultateve paraprake

Procesi zgjedhor i datës 9 nëntor nisi në orën 07:00, me hapjen e njëkohshme të të gjitha qendrave të votimit në pesë bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet. Operatorët e pajisjeve PEI raportuan pjesëmarrjen në fillim të çdo ore përmes aplikacionit të dedikuar të KQZ-së, duke skanuar kodet QR të gjeneruara nga shërbimi 'live vote'. Të dhënat e përfshira përpunoheshin në kohë reale dhe pasqyroheshin menjëherë në platformën e informacionit paraprak zgjedhor.

Njëkohësisht, sistemi i raportimit automatik të PEI gjeneronte të dhëna të përditësuara mbi pjesëmarrjen në çdo qendër votimi, të cilat transmetoheshin automatikisht në të njëjtën platformë raportimi. Ky proces raportimi dinamik vazhdoi deri në mbylljen e votimit, në orën 18:00.

Pas përfundimit të votimit, në orën 22:00 filloi procesi i përpunimit dhe publikimit të rezultateve paraprake. Rezultatet përditësoheshin në kohë reale në platformën e informacionit zgjedhor, ndërsa të dhënat shtesë të gjeneruara nga sistemi i inteligjencës artificiale kontribuan në rritjen e saktësisë dhe shpejtësisë së publikimit të informacionit.

Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi **dhënien e mandateve** për kandidatët fitues të shpallur Kryetar Bashkie në këto bashki:

- **Bashkia Vlorë**, Qarku Vlorë;
- **Bashkia Berat**, Qarku Berat;
- **Bashkia Cërrik**, Qarku Elbasan;
- **Bashkia Mat**, Qarku Dibër;
- **Bashkia Tepelenë**, Qarku Gjirokastrë.

Ky vendim garanoi formalizimin e rezultateve dhe kalimin në fazën e ushtrimit të mandateve nga kryetarët e rinj të zgjedhur.

Kapitulli 3

EKSPERIMENTI ME PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Tepelenë, procesi i numërimit të fletëve të votimit u shoqërua me përdorimin eksperimental të teknologjisë së Inteligjencës Artificiale (IA). Ky proces u realizua si test teknik me karakter eksperimental, pa synuar zëvendësimin e metodës tradicionale të numërimit manual të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Qëllimi i përdorimit të Inteligjencës Artificiale ishte të vlerësonte potencialin e saj teknologjik në procesin e numërimit të votave, në veçanti për:

- rritjen e saktësisë së numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit;
- rritjen e transparencës së procesit;
- përmirësimin e efikasitetit kohor;
- forcimin e integritetit dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor.

Përshkrimi i testit

Pamjet filmike të numërimit manual u përpunuan në kohë reale nga një sistem i bazuar në IA, i cili lexoi, interpretoi dhe vlerësoi fletët e votimit.

Gjetjet kryesore:

- Faqja ballore e fletës së votimit (me emrat e kandidatëve) u lexua **me saktësi të plotë (100%)**.
- U vërejtën pasaktësi të pjesshme në leximin e faqes së pasme të fletës së votimit, për shkak të pozicionimit të vulave.
- Rezultatet e IA përputheshin pothuajse plotësisht me ato të numërimit fizik.

Kuadri i testimit

Me vendimin nr. **1493, datë 7.11.2025**, të KSHZ, u përcaktua:

- **KZAZ/VNV nr. 80**, Bashkia Tepelenë (21 qendra votimi), si zona e testimit;
- Testimi i sistemit të numërimit të automatizuar me IA;
- Miratimi i Procedurës Standarde të Operimit (PSO) për rregullat teknike të procesit.

Rezultatet e plota

Tabela e rezultateve të numërimit të automatizuar – për kuti votimi

QV	FLETË VOTIMI TE PAVLEFSHME AI	FLETË VOTIMI TE VLEFSHME	NR. ZGJEDHËSISH VOT	FLETË VOTIMI TE PAVLEFSHME	FLETË VOTIMI TE VLEFSHME
4356/00	8	211	219	4	215
4359/00	2	205	207	2	205

4360/00	13	130	143	6	137
4362/00	2	177	179	1	178
4373/00	1	110	111	2	109
4375/00	6	160	166	5	161
4376/00	1	248	249	3	246
4377/00	1	132	133	1	132
4378/00	0	166	164	4	160
4380/00	3	123	126	3	123
4381/00	2	128	130	2	128
4383/00	8	247	255	8	247
4391/00	2	184	186	2	184
4391/01	6	161	167	4	163
4392/00	13	309	322	12	310
4393/00	11	235	246	7	239
4394/00	10	308	318	10	308
4395/00	4	175	179	4	175
4395/01	5	170	175	5	170
4396/00	12	358	370	12	358
4397/00	7	239	246	5	241

Tabela e rezultateve të numërimit të automatizuar – për kandidat

QV	NR.RENDOR KANDIDATI	VOTA TE VLEFSHME AI	VOTA TE VLEFSHME
4356/00	1	29	30
4356/00	2	182	185
4359/00	1	3	6
4359/00	2	202	199
4360/00	1	23	26
4360/00	2	107	111
4362/00	1	37	34
4362/00	2	140	144
4373/00	1	22	22
4373/00	2	88	87
4375/00	1	28	31

4375/00	2	132	130
4376/00	1	50	44
4376/00	2	198	202
4377/00	1	20	18
4377/00	2	112	114
4378/00	1	34	31
4378/00	2	132	129
4380/00	1	19	18
4380/00	2	104	105
4381/00	1	96	98
4381/00	2	32	30
4383/00	1	81	78
4383/00	2	166	169
4391/00	1	35	33
4391/00	2	149	151
4391/01	1	31	33
4391/01	2	130	130
4392/00	1	72	72
4392/00	2	237	238
4393/00	1	50	51
4393/00	2	185	188
4394/00	1	75	73
4394/00	2	233	235
4395/00	1	41	41
4395/00	2	134	134
4395/01	1	37	39
4395/01	2	133	131
4396/00	1	95	92
4396/00	2	263	266
4397/00	1	58	58
4397/00	2	181	183

Kapitulli 4

ANKIMET ZGJEDHORE

ANKIMET PARAZGJEDHORE

Kërkesat Ankimore të shqyrtuara nga KAS

Në KAS janë depozituar dy (2) kërkesa ankimore, të regjistruara me nr. 60 dhe 61:

1. Kërkesa Ankimore nr. 60

- o **Ankues:** Z. Gjergji Nika, kandidat për Kryetar Bashkie, i propozuar nga zgjedhësit, Bashkia Vlorë.
- o **Objekt:** Kundërshtim i vendimit nr. 1437, datë 26.10.2025, “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie”.
- o **Vendim KAS:** Rrëzim i kërkesës për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore për krijimin e Komitetit Nismëtar, sipas pikës 3, të nenit 70 të Kodit Zgjedhor.

2. Kërkesa Ankimore nr. 61

- o **Ankues:** Kryetari i Partisë Socialiste, Dega Mat.
- o **Objekt:** Kundërshtim i vendimit nr. 6, datë 24.10.2025 të KZAZ nr. 16, Bashkia Mat, për regjistrimin e kandidates së pavarur, Suzana Tahir Pasha.
- o **Vendim KAS:** Mospranimi për shqyrtim për shkak të mospërmbushjes së elementëve të parashikuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, për shkak të mungesës së legjitimitit dhe mosrespektimit të afateve ligjore.

Paditë e shqyrtuara nga Kolegji Zgjedhor

Në Kolegjin Zgjedhor janë depozituar dy (2) kërkesa padie:

1. Padia e Partisë Socialiste e Shqipërisë

- a. **Objekt:** Kundërshtim ndaj mosmarrjes së vendimit nga Komisioni Rregullator në KQZ për disa akte normative lidhur me zgjedhjet e pjesshme.
- b. **Vendim:** Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 32, datë 15.10.2025, vendosi pranimin e kërkesëpadiisë dhe miratoi projektvendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për:
 - Afatet procedurale për zgjedhjet e pjesshme në Bashkitë Berat, Tepelenë, Cerrik, Mat dhe Vlorë.
 - Karakteristikat teknike të fletës së votimit.
 - Përdorimin e pajisjeve të identifikimit elektronik dhe kamerave regjistruese për shfaqjen e fletëve të votimit.

2. Padia e z. Gjergji Nika (Bashkia Vlorë)

- a. **Objekt:** Kundërshtim ndaj vendimit nr. 109, datë 26.10.2025 të KAS.
- b. **Vendim:** Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 33, datë 30.10.2025, vendosi:

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 109 të KAS.
- Regjistrimin e z. Gjergji Nika si kandidat për Kryetar Bashkie, pa nevojën e krijimit të Komitetit Nismëtar.
- **Arsyetim:** Paditësi është anëtar i Këshillit Bashkiak Vlorë dhe, sipas ligjit, ka të drejtën për tu zgjedhur pa kërkuar nënshkrime mbështetëse. Kërkesa për krijimin e Komitetit Nismëtar përbën një kufizim shtesë që ligji nuk e parashikon, duke sjellë refuzim të paligjshëm të kandidimit.

ANKIMET PASZGJEDHORE

Vendimet e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor për miratimin e tabelave të rezultatit, vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve për bashkitë Vlorë dhe Berat, vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ndarjen e mandateve, vendimi i Komisionit Rregullator për miratimin e rezultatit përfundimtar nuk u ankimuan nga asnjë palë në proces.

Kapitulli 5

SHPLLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR

Në bazë të nenit 19, paragrafi 2 dhe shkronjës “n”, paragrafi 1, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ndau mandatet për kandidatët fitues në:

- Bashkinë Vlorë (Qarku Vlorë);
- Bashkinë Berat (Qarku Berat);
- Bashkinë Cërrik (Qarku Elbasan);
- Bashkinë Mat (Qarku Dibër);
- Bashkinë Tepelenë (Qarku Gjirokastrë);

Pas përfundimit të numërimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë, për tre njësi të qeverisjes vendore si dhe Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor miratoi Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë, për dy njësi të qeverisjes vendore.

Brenda afateve të përcaktuara ligjore asnjë prej 5 vendimeve të miratuara nuk u ankimua në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Pas dhënies së mandatit të Kryetarit të Bashkisë për 5 njësi të qeverisjes vendore nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor, Komisioni Rregullator me vendimin nr. **39**, datë 21.11.2025, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025”, vendosi të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme vendore për Kryetar Bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 9 nëntor 2025.

Të dhënat në format elektronik, mbi rezultatin e Zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore të datës 9 nëntor 2025 në format elektronik, konsultohen duke skanuar *quick response code-n* e mëposhtëm:



PJESA III

REKOMANDIME

Bazuar në analizën dhe vlerësimin e gjetjeve të përfituara nga praktikatat e deritanishme zgjedhore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rekomandon:

- Ndryshimin e mënyrës së përbërjes, organizimit dhe funksionimit të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë.
- Përbërja vetëm partiake e këtyre komisioneve tashmë qartësisht ka treguar se kjo mënyrë jo vetëm nuk siguron administrim profesional dhe eficient të procesit zgjedhor në këto nivele, por jo pak herë ka cënuar integritetin e këtij procesi.
- Duhet një formulë tjetër, e cila do të sanksionojë më shumë kompetenca dhe të drejta të KQZ-së në organizimin e këtyre komisioneve.
- Duhet një formulë tjetër që, gjithsesi nuk i përjashton tërësisht partitë politike nga pjesmarrja në administrim dhe/ose vëzhgim të drejtëpërdrejtë në këtë proces.

1. Rregullat për financimin e partive politike dhe të subjekteve zgjedhore

Ka nevojë për qartësi dhe plotshmëri në rregullat në lidhje me kush financon kë, kur, si. Nevojiten përmirësime dhe plotësime në lidhje me rregullat për raportimin financiar, fuqizim të kompetencave të KQZ-së, për shqyrtimin e raporteve financiare. Urdhërimi apo komisionimi nga KQZ i strukturave të tilla, si zyra e taksave, tatimeve, apo agjencive të ndryshme për kryerjen e këtyre verifikimeve.

2. Rregullat për financimin e palëve të treta në zgjedhje

Detyrimin e tyre për të raportuar për financimin kur angazhohen në fushatë zgjedhore.

3. Rregullat për fushatën elektorale në të gjitha llojet e mediave, përfshi internetin, median online si dhe rrjete sociale.

4. Rregullat për raportimin e veprimtarive të institucioneve publike në një periudhë të caktuar përpara ditës së zgjedhjeve

Bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e ODIHR, duhet të përcaktohet qartë kufiri midis qeverisë/shtetit dhe partisë që qeveris vendin.

5. Mënyra e votimit

- Çfarë do të bëhet me votimin elektronik? A do të vazhdojmë ta shtrijmë atë në të gjithë vendin, apo në disa njësi zgjedhore, apo do të heqim dorë nga kjo mënyrë votimi?

Në vlerësimin tonë do të ishte më racionale që në këtë fazë, votimi elektronik të mos shtrihej në të gjithë vendin, por të zbatohet në 4-6 njësitë zgjedhore me numër më të madh zgjedhësish.

6. Teknologjia e informacionit në proceset zgjedhore

Lidhur me votimin dhe numërimin elektronik rekomandojmë që kuadri rregullator ligjor të përcaktojë të drejtën dhe kompetencën e KQZ-së, për të aplikuar gjerësisht teknologjinë e informacionit në proceset zgjedhore.

Duhet të standartizohet përdorimi i teknologjive të reja, përfshirë Inteligjencën Artificiale si dhe të parashikohen rregullime ligjore për njohjen zyrtare të rezultateve të prodhuara prej tyre, duke garantuar transparencë, siguri dhe besueshmëri në procesin zgjedhor.

7. Numërimi

Do të vazhdojmë numërimin e votave kështu sikurse e kemi, përsa i përket vendit dhe procedurës, apo do t'i kthehemi numërimit në qendrën e votimit? Në secilin prej opsioneve, KQZ do të duhet të angazhojë burime njerëzore, trajnime, logjistikë, infrastrukturë dhe masa organizative të tjera, që garantojnë integritet të procesit, transparencë dhe efikasitet. Këto janë procese, ku do të duhet kohë për t'i adresuar.

8. Rregullat për shqyrtimin e ankimeve zgjedhore

Për një proces eficient, por që garanton gjithashtu integritetin e tij, do të duhet të përcaktohet qartë kush janë përgjegjësitet dhe procedura që ndjek çdo organ administrativ apo gjyqësor që do të jetë i përfshirë në shqyrtimin e ankimeve zgjedhore. Me rëndësi të dorës së parë ngelet çështja e pasjes apo jo, të Kolegjit Zgjedhor.

9. Organizimi dhe funksionimi i KQZ-së

Nëse do të ngelet formula aktuale do të duhet duhet të ketë një përcaktim më të qartë të kufijve të përgjegjësisë së secilit prej tre organeve përbërëse të KQZ-së: Komisionerit, Rregullatorit dhe KAS-it.

10. Rregullat për regjistrimin e subjekteve zgjedhore në zgjedhje

Këto rregulla kanë nevojë për përmirësim dhe/ose qartësim, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një parti politike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhore, regjistrimin e koalicioneve, kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit, etj.

11. Krijimi i mundësive alternative për të votuar

Krijimi i mundësive për të votuar për zgjedhësit, të cilët për arsye shëndetësore nuk mund të dalin nga shtëpia (por që në fakt gëzojnë zotësi juridike të plotë për të vepruar, pra, gëzojnë të drejtën e votës), si dhe për ata që në ditën e votimit për shkak të funksionit/detyrave që ushtrojnë (gazetarë, punonjës policie, etj) nuk mund të paraqiten në qendrën e votimit ku kanë emrin në listën e zgjedhësve.

12. Rregullat për votimin nga jashtë

Në aspektin rregullator, ka disa çështje, të cilat do të duhet të rikonsiderohen:

- A do ta ndryshojmë rregullin aktual për zonën zgjedhore për të cilën llogaritet rezultati i votave të votuesve nga jashtë?
- A do të llogaritet kjo votë në zonën zgjedhore (qarkun) ku votuesi nga jashtë ka gjendjen civile, apo do të ketë një zonë zgjedhore të posaçme për ta?

Duhet të ketë një përcaktim më të qartë për kushtet dhe kriteret e votuesve nga jashtë për të votuar.

- Në lidhje me mënyrën e votimit? A do të vazhdoj të jetë ajo me postë apo do të kemi një mënyrë tjetër, sikurse ajo nëpërmjet internetit, në përfaqësi diplomatike, në qendra votimi që ngrihen jashtë, apo një mënyrë tjetër?

13. Rregullat për organizimin e Referendumeve

Kuadri ligjor aktual për organizimin dhe funksionimin e referendumeve është i paqartë dhe jo i plotë. Me këtë kuadër nuk është bërë asnjë referendum, edhe pse ka pasur shumë iniciativa. Ky duhet të jetë prioritet.

14. Rishikimi i rregullave për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve dhe kohën e konstituimit, si të Kuvendit ashtu edhe të organeve të qeverisjes vendore.

15. Ligji për partitë politike

Është nevoja për të pasur rregulla të qarta dhe të plota për organizimin, funksionimin, financimin, pjesmarrjen në zgjedhje, penalitetet dhe sanksionet kundrejt partive, kur është rasti.

PJESA IV

ANEKSE

ANEKS 1: VOTIMI NGA JASHTË

1.1. PËRMBLEDHJE E AKTEVE NËNLIGJORE TË VOTIMIT NGA JASHTË

-Akte të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

1. Vendim KSHZ Nr. 193, datë 7.11.2024, "Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve nga jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të vitit 2025".
2. Vendim KSHZ Nr. 194, datë 7.11.2024 "Për rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet "PER"-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".
3. Udhëzim i Përbashkët me MB Nr. 01, datë 7.11.2024, "Për mënyrën e bashkëpunimit mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit".
4. Urdhër KSHZ Nr. 3, datë 07.01.2025, "Për miratimin e politikave të privatësisë të Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER) të zgjedhësve nga jashtë vendit, si dhe deklaratës së konfidencialitetit për ruajtjen e të dhënave personale".
5. Vendim KSHZ Nr. 15, datë 8.01.2025, "Për caktimin e detyrave dhe përgjegjësive të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e veprimeve të realizuara nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
6. Vendim KSHZ dhe NënKomisioner Nr. 3, datë 8.01.2025, "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
7. Vendim KSHZ Nr. 23, datë 9.01.2025, "Për miratimin e rregullores për shqyrtimin nëpërmjet 'PER' të kërkesave për regjistrim të zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025". (shiko Aneks 6)

8. Vendim KSHZ dhe NënKomisioner Nr. 12, datë 11.01.2025, "Për emërimin e ndihmësve të auditit teknikien, për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025".
9. Vendim KSHZ dhe Nënkomisioner Nr. 13, datë 13.01.2025 "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025".
10. Vendim KSHZ dhe Nënkomisioner Nr. 16, datë 14.01.2025, "Për emërimin e ndihmësve të auditit teknikien, për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
11. Vendim KSHZ dhe Nënkomisioner Nr. 29, datë 23.01.2025, "Për emërimin e ndihmësve të auditëve teknikienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve si dhe listave të zgjedhësve me banim jashtë vendit, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
12. Vendim KSHZ Nr. 45, datë 28.01.2025, "Mbi miratimin e modeleve të dokumentacionit zgjedhor që do të përdoret gjatë procesit të votimit nga jashtë vendit".
13. Vendim KSHZ Nr. 47, datë 28.01.2025, "Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit".
14. Vendim KSHZ Nr. 105, datë 17.02.2025, "Për miratimin e përmbajtjes së deklaratës tip për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
15. Vendim KSHZ Nr. 255, datë 11.03.2025, "Për korrigjimin e gabimeve materiale të adresës së deklaruar në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) të disa zgjedhësve nga jashtë vendit".
16. Vendim KSHZ Nr. 259, datë 11.03.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 255, datë 11.3.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për korrigjimin e gabimeve materiale të adresës së deklaruar në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) të disa zgjedhësve nga jashtë vendit".
17. Vendim KSHZ Nr. 260, datë 11.03.2025, "Për miratimin e listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025".
18. Vendim KSHZ Nr. 20, datë 13.03.2025, "Për një shtesë në vendimin nr.7, datë 14.2.2025, të Komisionit Rregullator "Për miratimin e karakteristikave teknike të fletës

së votimit për zgjedhësit me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11.5.2025”.

2. VKM nr. 152, date 06.03.2025 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025”, shkresa MF nr.4703/1, datë 17.03.2025
3. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025, miratimi i fondit të veçantë për KQZ 2025, shkresa MF nr. 2473/1, datë 10.02.2025
4. Akti Normativ Nr.10, datë 08.10.2025, shkresa MF nr.14505/54, date 30.10.2025
5. Rialokimet

Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar në fund të vitit 2025, në nivel programi dhe artikulli në mënyrë të detajuar paraqiten sipas datës së miratimit:

- i. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, me shkresën e Ministrisë së Financave nr.2473/1, datë 10.02.2025 “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2025” për KQZ u miratua shtesë fondi në shumën **250,000 lekë**, në llogarinë 606 “*Transferita për buxhetet familjare dhe individët*”, në programin “*Planifikim, menaxhim, administrim*”.
- ii. VKM nr. 47, date 22.01.2025 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej **2.5 miliardë lekë**, miratuar shpenzime buxhetore në programin “*Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale*”, me shkresën e Ministrisë së Financave nr.805/4, datë 24.01.2025.
- iii. VKM nr. 152, date 06.03.2025 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025” Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej **927,212,000 lekë**, miratuar shpenzime korrente në programin “*Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale*”, me shkresën e Ministrisë së Financave nr.4703/1, datë 17.03.2025.
- iv. Akti Normativ Nr.10, datë 08.10.2025, shkresa MF nr.14505/54, datë 30.10.2025. Mbështetur në Aktin Normativ Nr.10, datë 08.10.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” të ndryshuar, buxheti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka pësuar ndryshime për vitin 2025, konkretisht është rritur në shumën 12.8 milion lekë:

Për shpenzimet kapitale dhe korrente është kërkuar nga KQZ dhe është miratuar nga Ministria e Financave për vitin 2025 dy procedura rialokimi dhe paraqiten si më poshtë:

- Ministria e Financave me shkresën nr.3864/1, datë 26.02.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” miratoi transferimin e fondeve në programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore” 01620, për shumën 2,378,500 lekë).
- Ministria e Financave me shkresën tonë nr.3514, datë 30.04.2025 miratoi transferimin e fondeve në programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore” 01620, për Bashkitë në llog.602

në shumën 11,933,000 lekë fond i cili do të përdorej për kryerjen e transportit të bazës materiale nga KZAZ në QV, në funksion të zgjedhjeve të 11 Majit 2025.

- Numri i punonjësve buxhetorë i miratuar në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", për institucionin e KQZ-së është 95 punonjes, numri i rishikuar sipas miratimit të strukturës së re miratuar me Vendimin e Kuvendit nr.53/2025, datë 26.06.2025 është 93, teksa numri faktik i punonjësve për vitin 2025 është 89 punonjës.

Devijimi i numrit faktik nga ai i planifikuar vjen për shkak të mosplotësimit të vendeve vakante në KQZ dhe ristrukturimit edhe pse janë kryer dhe po zhvillohen të gjitha procedurat përkatëse për rekrutimin e punonjësve.

Plani fillestar i buxhetit, plani i rishikuar dhe realizimi faktik dhe pesha specifike për periudhën raportuese për vitin 2025, sipas programeve dhe total KQZ paraqiten si në tabelën e poshtme:

Në zbatim të ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", dhe në analizë të informacionit të paraqitur në mënyrë tabelare sa më sipër, rezulton se në nivel klasifikimi buxhetor, të dhënat e realizimit buxhetor për këtë periudhë vjetore 2025 janë:

3.1 Buxheti Fillestar

Buxheti fillestar për vitin 2025 ishte 532,107,000 lekë, i ndarë në:

- Shpenzime korrente: 384,707,000 lekë
- Shpenzime kapitale (financim i brendshëm): 135,500,000 lekë
- Shpenzime kapitale (financim i huaj): 11,900,000 lekë

3.2 Buxheti i Rishikuar

Gjatë vitit buxheti u rrit për shkak të:

- organizimit të zgjedhjeve parlamentare;
- zhvillimit të votimit nga jashtë vendit;
- nevojave shtesë logjistike dhe teknologjike;
- rialokimeve ndërmjet programeve.

Buxheti i rishikuar arriti në **3,972,369,000 lekë**

Rritja e konsiderueshme lidhet drejtpërdrejt me natyrën zgjedhore të vitit.

3.3 Realizimi Faktik

Realizimi për 12-mujorin 2025 rezulton **3,339,903,967 lekë** ose **84%** e planit të rishikuar.

Realizimi prej 84% konsiderohet në nivel optimal për një vit zgjedhor, pasi:

- një pjesë e fondeve janë planifikuar me karakter parashikues;
- disa zëra aktivizohen vetëm në rast nevoje;
- janë evidentuar kursime procedurale dhe diferenca kontraktuale kryesisht nga kontrata e shërbimit postar;
- janë shmangur angazhime të panevojshme financiare.

Niveli i realizimit reflekton një administrim financiar të qëndrueshëm, në përputhje me ritmin e aktiviteteve institucionale dhe zgjedhore gjatë vitit buxhetor.

III-1 Struktura e shpenzimeve

Në buxhetin fillestar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

- pjesën më të madhe të fondeve (73%) e zinte programi “Planifikim, menaxhim, administrim”, ku 72% ishin shpenzime korrente.
- Ndërsa 27% e buxhetit i përkiste programit “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, kryesisht për shpenzime kapitale (25%) me financim të brendshëm.

Struktura buxhetore ndryshoi ndjeshëm pas vendimeve të Këshillit të Ministrave, për shkak të fondeve shtesë të akorduara për organizimin e zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025.

Në buxhetin e rishikuar 2025, balanca u përmbys:

- 90% e fondeve (ose 3,561,212,000 lekë) i përkasin programit “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, ku 95% janë shpenzime korrente;
- Ndërsa 10% (ose 411,157,000 lekë) i takojnë programit “Planifikim, menaxhim, administrim”.

3.1-a Shpenzime Korrente

- o Plani vjetor i rishikuar: 3,784,969,000 lekë
- o Realizuar: 3,163,512,327 lekë
- o Realizuar: 84 %

Shpenzimet korrente përfshijnë:

- pagesat për komisionet zgjedhore;
- shërbimet logjistike;
- transportin dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore;
- shërbimet IT dhe mirëmbajtjen;
- shërbimet, materialet dhe detyrimet kontraktuale;

Në programin 01610 “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, realizimi është në nivelin 91%, çka tregon një disiplinë të mirë financiare në mbulimin e shpenzimeve administrative dhe funksionale të institucionit. Ndërkohë, në programin 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore”, realizimi i shpenzimeve korrente është 83%, duke reflektuar dinamikën reale të kostove zgjedhore dhe diferencat ndërmjet planifikimit paraprak dhe nevojave faktike gjatë procesit.

3.1-b Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm

- o Plani vjetor i rishikuar: 175,500,000 lekë
- o Realizuar në lekë: 164,491,640 lekë
- o Realizuar: 94 %

Shpenzimet kapitale paraqesin një realizim në nivelin 94%, nga 187,400,000 lekë të planifikuara janë realizuar 176,391,640 lekë. Ky tregues dëshmon një nivel të lartë zbatimi të

projekteve investuese, kryesisht në drejtim të pajisjeve teknologjike, infrastrukturës mbështetëse dhe sistemeve që shërbejnë administrimin zgjedhor.

Në programin 01620, investimet kanë një realizim prej 95%, duke reflektuar menaxhim efektiv të kontratave dhe procedurave të prokurimit. Ndërkohë, në programin 01610, realizimi i investimeve është 79%, çka lidhet me rishikimin e prioriteteve gjatë vitit buxhetor dhe optimizimin e shpenzimeve jo emergjente.

3.1-c Shpenzime Kapitale me Financim të Huaj

- o Plani vjetor i rishikuar: 11,900,000 lekë
- o Realizuar: 11,900,000 lekë
- o Realizuar: 100 %

Granti në kuadër të programit 01620 është realizuar në masën 100%, duke reflektuar përmbushjen e plotë të detyrimeve përkatëse financiare sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Në fund të vitit 2025, për KQZ situata e realizimit të shpenzimeve të buxhetit krahasuar me planin e vitit 2025 me ndryshime, sipas të dhënave të gjeneruara nga SIFQ (më 19 Shkurt 2025), paraqitet si më poshtë:

V- PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE

Në kuadër të një prej programeve të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë përcaktuar dhe monitoruar tregues kyç të performancës me bazë gjinore në nivel objektiv, konkretisht në objektivin “**Permirosimi dhe sigurimi i kushteve optimale të punës dhe rritje e kapaciteteve profesionale të punonjësve**”.

Këta tregues pasqyrojnë angazhimin institucional për promovimin e barazisë gjinore dhe për forcimin e një kulture organizative të bazuar në meritokraci, përfshirje dhe integritet.

Treguesit kryesorë janë si më poshtë:

a. Përfaqësimi i grave në poste drejtuese

Gratë përbëjnë **62% të totalit të posteve drejtuese** në institucion.

Ky nivel përfaqësimi dëshmon për një balancë të qëndrueshme gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe për një qasje të konsoliduar të institucionit ndaj fuqizimit të rolit të grave në menaxhim dhe drejtim strategjik.

b. Rastet e trajtuara të diskriminimit me bazë gjinore

Numri i rasteve të raportuara dhe të trajtuara të diskriminimit me bazë gjinore në institucion rezulton **0%**.

Ky tregues reflekton një mjedis pune profesional dhe të sigurt, ku respektohen standardet e barazisë, dinjitetit dhe trajtimit të drejtë për të gjithë punonjësit.

Vlerat e realizimit të këtyre treguesve, të paraqitura sipas programit përkatës, konfirmojnë përmbushjen e objektivave të vendosura dhe përforcojnë angazhimin institucional për integrimin e perspektivës gjinore në menaxhimin dhe administrimin publik.

Në tërësi, performanca e arritur evidenton një progres të qëndrueshëm në drejtim të barazisë gjinore dhe konsolidimit të praktikave të mira qeverisëse brenda institucionit. Top of Form

V- PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI

Një analizë më e detajuar e treguesve të monitorimit të buxhetit sipas programeve buxhetore paraqitet më poshtë:

V.1-a PERFORMANCA BUXHETORE E PROGRAMIT “PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM” 01610

Qëllimi i Politikës së Programit është:

“Përdorimi me efektivitet dhe efikasitet i burimeve njerëzore, mjeteve monetare me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira të punës për trupën e KQZ-së dhe administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Objektivi i Politikës së Programit është:

Përmirësimi dhe sigurimi i kushteve optimale të punës dhe rritje e kapaciteteve profesionale të punonjësve.

- Në shpenzimet buxhetore të programit 01610, plani i rishikuar 2025 ka një rritje prej 24,950,000 nga të cilat- 13,050,000 lekë shpenzime korrente:
 - o 250,000 lekë- fondi i veçantë për vitin 2025;
 - o 12,800,000 lekë- Transfera korrente të huaja 605 (partitë politike), AN nr.10
- Në shpenzimet kapitale të programit 01610, plani i rishikuar 2025 ka një rritje prej 11,900,000 lekë – AN nr.10

Ky program përbën 10 % të totalit të shpenzimeve të buxhetit të rishikuar të KQZ-së për vitin 2025 ($411,157,000/3,972,369,000 = 10\%$)

- Krahasimi i realizimit faktik për vitin 2024 dhe vitin 2025:

Analiza krahasimore e realizimit buxhetor për periudhën 12-mujore 2024 dhe 12-mujore 2025 evidenton një përmirësim të lehtë, por domethënës në nivelin e ekzekutimit të programit.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës (2024), realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2025 rezulton **0.8 pikë përqind më i lartë**, duke kaluar nga **90.4% në vitin 2024 në 91.2% në vitin 2025**. Ky progres tregon një përmirësim të qëndrueshëm në aftësinë e institucionit për të realizuar në kohë dhe me efikasitet fondet e planifikuara.

- Realizimi i shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Për vitin 2025, niveli i realizimit të shpenzimeve për këtë program, krahasuar me planin vjetor të rishikuar, rezulton në **91.2%**, duke reflektuar një performancë të kënaqshme në raport me objektivat financiarë të përcaktuar.

Struktura e realizimit sipas zërave kryesorë paraqitet si vijon:

- Shpenzime korente: 92%
- Shpenzime kapitale: 79%
- Totali i programit: 91.2%

Të dhënat tregojnë një nivel shumë të mirë realizimi në kategorinë e shpenzimeve korente, ndërkohë që shpenzimet kapitale paraqesin një nivel më të ulët ekzekutimi, e cila lidhet me faktorë procedural dhe dinamika të proceseve të prokurimit.

Në tërësi, performanca financiare për vitin 2025 paraqitet e qëndrueshme dhe në përmirësim krahasuar me vitin pararendës, duke dëshmuar për disiplinë buxhetore dhe menaxhim të kujdesshëm të burimeve publike.

Analizë e devijimeve nga plani buxhetor

Diferenca ndërmjet buxhetit të rishikuar dhe realizimit faktik për vitin 2025 lidhet kryesisht me kursime të realizuara në zbatimin e procedurave të prokurimit, menaxhim të kujdesshëm të shpenzimeve operative.

Pavarësisht diferencave, struktura e shpenzimeve ka garantuar funksionimin normal të administratës së KQZ-së, përmbushjen e detyrimeve ligjore (paga, sigurime dhe transfertat për partitë politike) dhe mbështetjen operative të institucionit, pa krijuar detyrime të prapambetura apo probleme në vazhdimësinë e shërbimit administrativ.

Ecuria e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik:

Nga analiza faktoriale sipas kategorisë së shpenzimeve të realizuara në nivel artikulli rezulton:

i. Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) – 2025

Shpenzimet përfshijnë pagat dhe sigurimet shoqërore për **93 punonjës të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, sipas organigramës dhe nivelit të pagave të miratuara. Këto fonde synojnë rritjen e performancës së administratës, realizimin e objektivave institucionale dhe krijimin e kushteve optimale për punonjësit.

- **Buxheti i rishikuar:** 176,007,000 lekë
- **Realizimi vjetor:** 165,820,457 lekë
- **Realizimi:** 94%

Ky nivel tregon menaxhim efikas të fondeve dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve për zhvillimin e kapaciteteve të administratës.

ii. Shpenzime për mallra dhe shërbime (602)

Shpenzimet përfshijnë blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin e Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke përfshirë: sigurinë fizike të ndërtesave, energjinë, karburantin, ujin, telefoninë, shërbimet për automjetet, mirëmbajtjen e ashensorit, udhëtimet dhe dietat brenda dhe jashtë vendit, si dhe licencimet e sistemeve IT.

Gjatë vitit 2025, janë realizuar disa procedura prokurimi për të garantuar veprimtarinë e institucionit, ku peshën kryesore zënë shërbimet e sigurisë, qiraja për magazina dhe licencimet e sistemeve (funksionalitet dhe siguri).

- **Buxheti i rishikuar:** 150,160,000 lekë

- **Realizimi:** 136,466,926 lekë
- **% e realizimit:** 91%

Realizimi i lartë dëshmon stabilitet administrativ dhe disiplinë buxhetore.

Programi ka garantuar funksionim normal institucional dhe përmbushje të detyrimeve ligjore.

Diferenca prej 9% lidhet kryesisht me:

- kursime në procedura prokurimi;

iii. Shpenzime për transferta korrente të brendshme (604 – Partitë Politike)

Këto transferta përfshijnë mbështetjen financiare për veprimtaritë e partive politike, të akorduara sipas Aktit Normativ nr.10.

- **Buxheti i rishikuar:** 12,800,000 lekë
- **Realizimi:** 12,756,458 lekë
- **% e realizimit:** 100%

iv. Shpenzime për transferta korrente të huaja (605)

Për vitin 2025, janë kryer pagesat për detyrimet e kuotës vjetore të anëtarësimit pranë Shoqatës Botërore të Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve (AËEB).

(Pagesa është kryer gabimisht nga zëri 602, prandaj në SIFQ zëri 605 rezulton zero).

- **Buxheti i rishikuar:** 1,000,000 lekë
- **Realizimi:** 1,000,000 lekë
- **% e realizimit:** 100%

v. Shpenzime për transferta – Buxhete Familjare & Individë (606)

Ky zë përfshin pagesat për:

1. Anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, sipas nenit 12 të Kodit Zgjedhor – realizim 49,323,000 lekë (85.3%).
 2. Pagesat për punonjës që dalin në pension ose raste fatkeqësie/sëmundjeje – 90,000 lekë (0.2%).
- **Buxheti i rishikuar:** 57,790,000 lekë
 - **Realizimi:** 49,412,726 lekë
 - **Realizimit:** 86%

vi. Shpenzime kapitale me financim të brendshëm (231)

Ky zë përfshin investimet kapitale për vitin 2025.

- **Buxheti i rishikuar:** 13,400,000 lekë
- **Realizimi:** 10,548,840 lekë
- **Realizimit:** 79%

Mosrealizimi i pjesëshëm i investimeve lidhet me rishikim prioritetesh dhe kohëzgjatje procedurash.

Performanca e shpenzimeve të programit sipas produkteve për 12 mujorin 2025:

në lekë

▪ **Produkti 97301AA – “Administratë profesionale”**

Realizimi financiar arriti **95%** të fondeve të planifikuara, ndërsa realizimi sasior ishte **96%**. Ky tregues reflekton përmirësimin e kapaciteteve profesionale të administratës.

- **Produkti 97301AB – “Ambiente pune të mirëmbajtura”**
Realizimi financiar arriti **90%**, ndërsa realizimi sasior ishte **100%**. Ky tregues tregon se ambientet dhe shërbimet operative janë mbajtur në standarde të larta, duke siguruar funksionimin efikas të institucionit dhe përmbushjen e detyrimeve operative. Për më tepër, realizimi sasior 100% dëshmon për përmbushje të plotë të objektivave në terma të aktiviteteve dhe shërbimeve operative.
- **Produkti 97301AC – “Akte nënligjore të miratuara dhe ankime të trajtuara”**
Realizimi financiar ishte **86%**, ndërsa realizimi sasior arriti **100%**, duke dëshmuar për përmbushje të plotë të objektivave të procedurave administrative dhe ligjore.
- **Produkti 18AC301 – “Pajisje informatike dhe zyrash”**
Ky produkt nuk është realizuar për vitin 2025, me realizim financiar dhe sasior **0%**, duke reflektuar vonesa apo rinjohje të projekteve për këtë zë.
Mosrealizimi lidhet me rishikimin e prioriteteve gjatë vitit buxhetor dhe optimizimin e shpenzimeve jo emergjente.
- **Produkti 21AB306 – “Rikonstruktion i sallës së serverave dhe rrjetit network të KQZ, dysheme teknologjike dhe sistem kondicionimi”**
Realizimi financiar arriti **89%**, ndërsa realizimi sasior është **100%**. Ky tregues reflekton se punimet për rikonstruktionin e sallës së serverave dhe rrjetit, përfshirë dyshemetë teknologjike dhe sistemin e kondicionimit, janë përfunduar sipas planit të aktivitetit, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe infrastrukturë teknologjike të standardeve të larta për institucionin.

V-2-a Performanca jo-financiare

Niveli i realizimit financiar mbështet drejtpërdrejt arritjen e objektivave jo-financiare të programit, konkretisht:

- Programi ka garantuar funksionimin administrativ të institucionit në mënyrë të qëndrueshme;
- Përpunimin e procedurave brenda afateve;
- Zbatimin e standardeve administrative dhe ligjore;
- Përmbushjen e detyrimeve ligjore ndaj palëve të treta (partitë politike);
- Ruajtjen e stabilitetit organizativ dhe institucional.

Në tërësi, niveli i realizimit prej 91% nuk ka ndikuar negativisht në performancën funksionale të programit, por reflekton menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike dhe optimizim të shpenzimeve, si dhe dëshmon një menaxhim të kujdesshëm të burimeve dhe stabilitet operacional të programit “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, duke siguruar mbështetje administrative efektive për ushtrimin e funksioneve të KQZ-së gjatë vitit 2025.

V.1-b PERFORMANCA BUXHETORE E PROGRAMIT “ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME DHE VENDORE” 01620

1. Përgatitja për zgjedhjet parlamentare të datës 11 maj 2025

Përgatitja për zgjedhjet për Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të caktuara me dekretin nr.

399, datë 05.12.2024, përfshiu angazhimin e plotë të KQZ-së në organizimin e procesit zgjedhor, duke përfshirë:

- Hartimin e akteve rregullatore;
- Planifikimin e buxhetit zgjedhor;
- Përmirësimin e infrastrukturës teknologjike për identifikimin elektronik të votuesve;
- Menaxhimin e votimit nga jashtë vendit, për të cilin për herë të parë u ndërmorën hapa konkretë për të mundësuar votimin elektronik të qytetarëve jashtë vendit, duke synuar një pjesëmarrje më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në procesin zgjedhor.

Gjithashtu, aspekt kyç i veprimtarisë së KQZ-së gjatë vitit 2025 ishte **edukimi zgjedhor**, duke informuar publikun mbi të drejtat dhe detyrimet si zgjedhës, dhe duke forcuar transparencën dhe besimin në procesin zgjedhor. Në këtë kuadër, u reformuan dhe implementuan **sisteme të reja digjitalizimi** të proceseve të punës së KQZ-së, për përmirësimin dhe efikasitetin e administrimit zgjedhor.

2. Mbështetje për zgjedhjet e pjesshme vendore Vendimi i Gjykatës Kushtetuese datë 09.10.2025

Mbështetur në **Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 09.10.2025**, për pezullimin e Dekretit të Presidentit nr. 350, datë 01.10.2025, për pjesën që cakton datën e zgjedhjeve vendore në Bashkinë e Tiranës, KQZ menjëherë ristrukturoi shpenzimet buxhetore në funksion të këtyre zgjedhjeve, duke përllogaritur të gjitha fondet e nevojshme për Zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të cilat u zhvilluan në 5 bashki: Vlorë, Berat, Mat, Tepelenë dhe Cërrik, në datën 9 Nëntor 2025.

3.Rekrutimi i Personelit Shtesë

Për të mbështetur administrimin e zgjedhjeve, KQZ ka kërkuar miratimin e **393** punonjësve shtesë, përfshirë specialistë, operatorë dhe teknikë, për periudhën e zgjedhjeve të pranverës 2025.

4.Monitorimi i Medias dhe Fushatës Zgjedhore

KQZ ka fokusuar vëmendjen në monitorimin e medias gjatë fushatës zgjedhore dhe forcimin e bashkëpunimit me median për të siguruar një proces zgjedhor transparent.

5.Parandalimi i Shkeljeve Zgjedhore

KQZ ka organizuar tryeza për rritjen e rolit të organeve ligjzbatuese kundër shitblerjes së votës dhe shkeljeve të tjera zgjedhore.

Në zbatim të ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", plani i buxhetit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u miratua në shumën **134 milion lekë** për programin "zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale" vetëm për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe **11.9 milion lekë** financim i huaj konkretisht për projektin Grant "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së".

Ky program gjatë vitit pësoi ndryshime në zbatim të:

1. VKM nr. 47, date 22.01.2025 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej **2.5 miliardë lekë**, miratuar shpenzime buxhetore në programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale", me shkresën e Ministrisë së Financave nr.805/4, datë 24.01.2025.
2. VKM nr. 152, date 06.03.2025 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2025, miratuar për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025" Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është akorduar fondi prej **927,212,000 lekë**, miratuar shpenzime korrente në programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale", me shkresën e Ministrisë së Financave nr.4703/1, datë 17.03.2025.
3. Akti Normativ Nr.10, datë 08.10.2025, shkresa MF nr.14505/54, datë 30.10.2025. Mbështetur në Aktin Normativ Nr.10, datë 08.10.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025" të ndryshuar, buxheti i programit "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore" ka pësuar ndryshime për vitin 2025, konkretisht u pakesuan shpenzimet kapitale në shumën 11,9 milion lekë.

- Ecuria e shpenzimeve të programit 01620 "Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Vendore" sipas klasifikimit ekonomik:

Në këtë program në shpenzimet korrente (600-602) përfshihen fondet të cilat u akorduan për KQZ për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

KQZ duke mirëadministruar fondet buxhetore, me keto fonde përballoi dhe organizoi edhe procesin e Zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të cilat u zhvilluan në 5 bashki: Vlorë, Berat, Mat, Tepelenë dhe Cërrik, në datën 9 Nëntor 2025.

Konkretisht për programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore"

<i>Plani fillestar vjetor</i>	<i>= 145,900,000 lekë (shpz kapitale 231 01+02- Grant)</i>
<i>Plani i rishikuar vjetor</i>	<i>= 3,561,212,000 lekë</i>
<i>Realizimi buxhetor për 12 M 2025</i>	<i>= 2,964,898,560 lekë</i>
<i>Realizimi buxhetor në %</i>	<i>= 83%</i>

Nga të cilat planifikuar dhe realizuar në % ndaj fondeve të planifikuara sipas natyrës së shpenzimeve:

- Shpenzime korrente planifikuar 3,387,212,000 lekë dhe realizuar në masën 83 % ose 2,799,055,760 lekë
- Shpenzime kapitale me financim të brendshëm planifikuar në shumën 162,100,000 lekë dhe realizuar në masën 95 % ose 153,942,800 lekë.
- Shpenzime kapitale me financim të huaj planifikuar dhe realizuar në shumën 11,900,000 lekë dhe realizuar në masën 100 %

- Ecuria e shpenzimeve të programit sipas klasifikimit ekonomik:

a. *Shpenzime personeli* në këtë program për vitin 2025:

Përfshin pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e përkohshëm, 475 punonjës në zbatim të vendimit nr.103/2024, dhe nr.23/2025 të Kuvendit të Shqipërisë.

✓ buxheti i rishikuar është	299,343,160 lekë
✓ realizimi i buxhetit për 12 M 2025	275,788,379 lekë
✓ realizimi në %	92 %

b. Shpenzime mallra dhe shërbime 602 për vitin 2025:

Aktiviteti i i KQZ-së për realizimin dhe administrimin e gjithë procesit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 Maj 2025, si dhe të zgjedhjeve të pjesshme për 5 Bashki të datës 9 Nëntor, është mbështetur nga buxheti i shtetit në llogarinë e shpenzimeve për mallra e shërbimeve ku plani i rishikuar për këtë zë është në shumën 3,087,212,000 lekë ose 90% e buxhetit të KQZ-së 2025, dhe 95% të fondeve buxhetore të programit 01620.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëri përpjekjet maksimale për të siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Këto zgjedhje jetësuan për herë të parë në këto 35 vite demokraci, votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe banojnë jashtë vendit tonë, direkt nga vëndet ju jetojnë, proces i njohur ndryshe si vota e diasporës.

Ky proces u përmbush nëpërmjet shërbimit postar i cili zuri 36% të fondeve të planifikuara në zërin 602 – mallra e shërbime të këtij programi.

Për zërin “**Shërbimi Postar për zgjedhësit nga jashtë vendit**”:

- **Buxheti i planifikuar:** 1,210,000,000 lekë
- **Vlera e kontratës së lidhur:** 912,679,991 lekë
- **Realizimi faktik për vitin 2025:** 699,516,320 lekë

a) Diferenca midis planifikimit dhe kontraktimit

Diferenca:

$$1,210,000,000 - 912,679,991 = \mathbf{297,320,009 \text{ lekë}}$$

Diferenca prej 297,320,009 lekë ndërmjet planifikimit dhe kontraktimit tregon një kursim buxhetor të krijuar si rezultat i procedurës së prokurimit dhe ofertës më të ulët se fondi limit.

b) Diferenca midis kontratës dhe realizimit faktik

$$912,679,991 - 699,516,320 = \mathbf{213,163,671 \text{ lekë}}$$

Ndërkohë, diferenca prej 213,163,671 lekë ndërmjet kontratës dhe realizimit faktik lidhet me realizimin jo të plotë të volumit të parashikuar të shërbimit postar gjatë vitit 2025, duke qenë se pagesat janë kryer mbi bazën e shërbimit realisht të ofruar.

Si rrjedhojë, fondet e papërdorura në total ndaj planifikimit fillestar rezultojnë në shumën 510,483,680 lekë, situatë e cila ka ardhur si pasojë e kombinimit të kursimit nga prokurimi dhe realizimit më të ulët të volumit faktik të shërbimit krahasuar me parashikimet fillestare.

Për këtë program shpenzimet e kryera për të cilat janë përdorur fondet e planifikuara, i referohen kryesisht mallrave dhe shërbimeve sipas shpenzimeve dhe planifikimit në regjistrin për procedurat e prokurimit, për të cilat janë bërë ndryshimet përkatëse në Regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit (njoftuar Dega e Thesarit rast pas rasti).

✓ buxheti i rishikuar është	3,387,212,000 lekë
✓ realizimi i buxhetit për 12 M 2025	2,799,055,760 lekë
✓ realizimi në %	83 %

c. **Shpenzime kapitale me financim të brendshëm** për 12 mujorin 2025:

✓ buxheti i rishikuar është	162,100,000 lekë
✓ realizimi i buxhetit për 12 M 2025	153,942,800 lekë
✓ realizimi në %	95 %

d. **Shpenzime kapitale me financim të huaj** për 12 mujorin 2025:

Projekti Grant i qeverisë zviceriane "Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së"

✓ buxheti i rishikuar është	11,900,000 lekë
✓ realizimi i buxhetit për 12 M 2025	11,900,000 lekë
✓ realizimi në %	100 %

Ky fond u përdor në kuadër të fushatës edukim – informim me qëllim ndërgjegjësimitin e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e votimit nga jashtë vendit për vitin 2025 me miratim të ambasadës Zviceriane.

- *Performanca e shpenzimeve të programit sipas produkteve për 12 mujorin 2025:*

Kodi Produktit	Kodi Produktit	Buxheti Fillestar 2025	Buxheti i Rishikuar 2025	Realizimi Faktik 12 M 2025	Realizimi ne % 12 M 2026
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit "Zgjedhjet e pergjithshme dhe vendore"					
97302AA	Proces zgjedhor i realizuar	0	3,387,212,000	2,799,055,760	83%
24AE601	Platforma elektronike per regjistrimin e zgjedhesve nga jashte vendit	5,322,100	45,322,100	44,740,400	99%
24AI201	Sistemi per indeksimin dhe kerkimin e pamjeve filmike	3,000,000	300,000	270,240	90%
24AI202	Shtimi i kapaciteteve per ruajten e pamjeve filmike	40,000,000	38,460,000	38,453,760	100%
24AE602	Përshtatje e qendrës së thirrjeve për mbështetje/asistence per votuesit - Extension per votimin nga jashte	2,000,000	2,000,000	0	0%
24AI103	Sistem trametimi Live on-line aktivitetete te KQZ (Hardëare + Soft+Audio	4,000,000	4,000,000	0	0%
24AI101	Pajisje IT dhe komunikimi me mediat (ledëall)	7,000,000	5,679,000	5,678,400	100%
24AI102	Telepromter	3,000,000	1,531,000	0	0%
24AI301	ERP - SOFTËARE per menaxhimin e proceseve, logjistikes, inventar etj	34,561,000	28,807,900	28,800,000	100%
24AI302	Moduli i Hartave te Qendrave te Votimit dhe facilite te tjera	19,495,400	18,000,000	18,000,000	100%
24AI303	Moduli e administrata	15,621,500	18,000,000	18,000,000	100%

Realizimi i produkteve për vitin 2025

- **Produkti 97302AA – “Proces zgjedhor i realizuar”**
Realizimi financiar arriti **83%** të fondeve të rishikuara (2,799,055,760 lekë nga 3,387,212,000 lekë), duke reflektuar përmbushjen e pjesës kryesore të aktiviteteve të procesit zgjedhor dhe menaxhimin efikas të shpenzimeve të programit.
- **Produkti 24AE601 – “Platforma elektronike për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit”**
Realizimi financiar është **99%** (44,740,400 lekë nga 45,322,100 lekë), duke treguar implementim të suksesshëm të platformës dhe mundësim të votimit elektronik nga jashtë vendit.
- **Produkti 24AI201 – “Sistemi për indeksimin dhe kërkimin e pamjeve filmike”**
Realizimi financiar arriti **90%**, duke garantuar akses të shpejtë dhe të strukturuar në materialet filmike për monitorimin dhe dokumentimin e procesit zgjedhor.
- **Produkti 24AI202 – “Shtimi i kapaciteteve për ruajtjen e pamjeve filmike”**
Realizimi është **100%**, duke siguruar ruajtjen e plotë dhe të sigurt të pamjeve filmike për nevoja arkivore dhe monitorimi të procesit zgjedhor.
- **Produkti 24AE602 – “Përshtatje e qendrës së thirrjeve për mbështetje/asistencë për votuesit – Extension për votimin nga jashtë”**
Ky produkt nuk u realizua për vitin 2025, me **0% realizim**.
- **Produkti 24AI103 – “Sistem transmetimi Live on-line i aktiviteteve të KQZ (Hardëare + Softëare + Audio)”**
Realizimi është **0%**, duke treguar se ky sistem nuk u implementua gjatë vitit 2025.
- **Produkti 24AI101 – “Pajisje IT dhe komunikimi me mediat (LED ëall)”**
Realizimi financiar është **100%**, duke siguruar pajisjet e nevojshme për transmetimin dhe komunikimin vizual me mediat gjatë aktiviteteve zgjedhore.
- **Produkti 24AI102 – “Teleprompter”**
Ky produkt nuk u realizua për vitin 2025 (**0% realizim**).
- **Produkti 24AI301 – “ERP – SOFTËARE për menaxhimin e proceseve, logjistikës dhe inventarit”**
Realizimi financiar është **100%**, duke siguruar funksionimin efikas dhe menaxhimin të centralizuar të proceseve administrative dhe logjistike të KQZ-së.
- **Produkti 24AI302 – “Moduli i hartave të Qendrave të Votimit dhe faciliteteve të tjera”**
Realizimi financiar është **100%**, duke mundësuar përgatitjen dhe koordinimin të qendrave të votimit dhe lehtësive logjistike të nevojshme për zgjedhjet.
- **Produkti 24AI303 – “Moduli e administrata”**
Realizimi financiar është **100%**, duke përmirësuar menaxhimin administrativ dhe monitorimin e të gjithë proceseve zgjedhore.

Sa më sipër realizimi i produkteve 2025

Shumica e produkteve të programit “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore” u realizuan

plotësisht ose **83% të buxhetit të rishikuar**, duke garantuar funksionim efikas të proceseve zgjedhore, avancim të kapaciteteve teknologjike dhe administrative.

V.1-b Performancës jo-financiare e programit 01620

Niveli i realizimit financiar të këtij programi mbështet në mënyrë të drejtpërdrejtë arritjen e objektivave jo-financiare, duke mundësuar:

- Organizimin dhe përfundimin e procesit zgjedhor në përputhje me afatet dhe standardet ligjore;
- Implementimin e moduleve teknologjike dhe sistemeve operative për menaxhimin efikas të votimit, përfshirë votimin elektronik nga jashtë vendit;
- Menaxhim të kujdesshëm të fondeve publike;
- Përdorim racional të burimeve gjatë proceseve zgjedhore;
- Përbushje të plotë të detyrimeve ligjore dhe kontraktuale

Në tërësi, realizimi financiar i programit ka kontribuar në përbushjen e objektivave jo-financiare në masën e lartë, duke garantuar një proces zgjedhor transparent, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

V-2 PERFORMANCA JO-FINANCIARE E KQZ-SË – VITI 2025

Gjatë vitit 2025, KQZ ka garantuar funksionimin e plotë institucional dhe administrativ, duke siguruar organizimin dhe menaxhimin e proceseve zgjedhore, zbatimin e detyrimeve ligjore ndaj subjekteve zgjedhore dhe palëve të treta, si dhe përbushjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të institucionit.

Rritja e ndjeshme e buxhetit gjatë vitit lidhet me zhvillimin e proceseve zgjedhore, për të cilat janë mobilizuar burime njerëzore, logjistike dhe teknike. Institucioni ka arritur të:

- organizojë dhe administrojë proceset zgjedhore sipas afateve ligjore;
- sigurojë financimin publik të partive politike;
- mbështesë funksionimin e administratës zgjedhore në të gjitha nivelet;
- realizojë investime në infrastrukturë dhe pajisje zgjedhore;
- menaxhojë fondet publike me eficiencë dhe pa krijuar detyrime të prapambetura.

Niveli i realizimit financiar prej 84% nuk ka ndikuar negativisht në përbushjen e objektivave funksionale, pasi diferencat nga plani lidhen kryesisht me kursime dhe mosaktivizim të plotë të disa fondeve të parashikuara.

V-3 VEPRIMET VIJUESE NË NIVELIN E PROGRAMEVE BUXHETORE

Mbështetur në analizën e përdorimit të fondeve buxhetore gjatë vitit 2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka identifikuar disa fusha prioritare për forcimin e menaxhimit financiar dhe rritjen e performancës në nivel programesh buxhetore dhe gjatë vitit 2026 do të ndër marrë këto masa:

- përmirësimi i procesit të planifikimit buxhetor, në përputhje më të ngushtë me nevojat reale dhe afatet e zbatimit të programeve;

- forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të shpenzimeve, me fokus në realizimin sipas objektivave dhe treguesve të performancës;
- rritja e transparencës dhe cilësisë së raportimit financiar;
- ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të specializuara;
- zgjerimi i përdorimit të teknologjisë për mbikëqyrje dhe menaxhim më efikas të fondeve.

Këto veprime synojnë rritjen e efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës në administrimin e fondeve buxhetore të KQZ-së, duke siguruar realizimin e programeve prioritare në përputhje me objektivat e përcaktuara për vitin 2026.

VI. PROJEKTET KAPITALE

Tavani buxhetor për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në total për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përbën 4.4 % të totalit të buxhetit të rishikuar të KQZ -së për vitin 2025.

- ✓ Tavani buxhetor për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në programin "Planifikim Menaxhim Administrim", sipas strukturës buxhetore përbën 0.34 % të totalit të buxhetit të rishikuar të KQZ -së për vitin 2025.
- ✓ Tavani buxhetor për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm në programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore", sipas strukturës buxhetore përbën 4.08 % të totalit të buxhetit të rishikuar të KQZ -së për vitin 2025.
- ✓ Tavani i programi buxhetor për shpenzimet kapitale me financim të huaj "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale " përbën 0.30% të totalit të buxhetit të rishikuar të KQZ -së, në shumën 11,900,000 lekë.

A. NDRYSHIMET NË BUXHET

Gjatë vitit 2025, ekzekutimi i buxhetit ka qenë kryesisht në përputhje me parashikimet, me disa ndryshime të shkaktuara nga shpenzime të paplanifikuara, përfshirë organizimin e procesit të votimit nga jashtë, dhe kostot operative. Këto ndryshime kanë ndikuar në menaxhimin e fondeve, dhe kanë përmbushur realizimin e objektivave kryesore të KQZ-së, pasi proceset zgjedhore u realizuan me sukses.

B. PËRFUNDIME

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është angazhuar maksimalisht në realizimin e buxhetit të vitit 2025.

Ekzekutimi i buxhetit 2025 ka qenë në përputhje me parashikimet, objektivat e KQZ-së u realizuan me sukses, dhe për vitet e ardhshme është përcaktuar si prioritet përforcimi i planifikimit dhe monitorimit financiar.

Viti 2025 përbën një vit me intensitet të lartë financiar dhe organizativ për KQZ.

Realizimi prej 84% reflekton:

- disiplinë fiskale;

- përdorim të kujdesshëm të fondeve publike;
- eficiencë operative;
- përmbushje të plotë të funksioneve kushtetuese.

Programi i Transparencës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në zbatim të detyrimeve ligjore për informimin e publikut, garanton transparencën e veprimtarisë së tij përmes publikimit të raporteve përfundimtare, njoftimeve për shtyp, vendimmarrjeve, si dhe çdo informacioni tjetër me interes publik, sipas përcaktimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Transparenca realizohet gjithashtu përmes përditësimit të vazhdueshëm të faqes zyrtare, komunikimit me median dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera, me qëllim rritjen e besimit publik dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.

Paraqitja e informacionit si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit janë në përputhje me përcaktimet të bëra në Udhëzimin nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, dhe anekseve të përcaktuara në këtë udhëzim të cilat i gjeni bashkëngjitur:

Raporti është hartuar në përputhje me Udhëzimin nr. 14/2023 dhe është gati për dorëzim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Të dhënat përputhen me sistemin SIFQ për periudhën Janar–Dhjetor 2025.



RAPORT

MBI PUNËN E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2025

© Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Të gjitha të drejtat e rezervuara.